AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

BOTIME TË VEÇANTA CXV
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
Libri 46

NORBERT JOKL

STUDIME PËR ETIMOLOGJINË DHE FJALËFORMIMIN SHQIP

*

STUDIEN ZUR ALBANESISCHEN ETYMOLOGIE UND WORTBILDUNG

Në 100-vjetorin e botimit të parë.
On the ocasion of one hundred years of the first edition.

PRISHTINË
2011

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

SPECIAL EDITIONS CXV
SECTION OF LANGUAGE AND LITERATURE
Book 46

NORBERT JOKL

STUDIME PËR ETIMOLOGJINË DHE FJALËFORMIMIN SHQIP

*

STUDIEN ZUR ALBANESISCHEN ETYMOLOGIE UND WORTBILDUNG

Translation: Eqrem ÇABEJ

Prepared and forwarded by: Academician Rexhep Ismajli
Editorial board: Academician Rexhep Ismajli
Academician Besim Bokshi
Academician Idriz Ajeti
Profesor Dr. Heiner Eichner

Editor: Academician Mehmet Kraja, Secretary of the Section for Linguistics and Literature



PRISHTINA
2011

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

BOTIME TË VEÇANTA CXV
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
Libri 46

NORBERT JOKL

STUDIME PËR ETIMOLOGJINË DHE FJALËFORMIMIN SHQIP

*

STUDIEN ZUR ALBANESISCHEN ETYMOLOGIE UND WORTBILDUNG

Përktheu: Eqrem ÇABEJ


Përgatitja dhe Parathënia: akademik Rexhep Ismajli
Redaksia: Akademik Rexhep Ismajli
Akademik Besim Bokshi
Akademik Idriz Ajeti
Profesor Dr. Heiner Eichner

Redaktor: Akademik Mehmet Kraja, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë

PRISHTINË
2011

Nga origjinali:
Norbert Jokl: **Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung.**
Kais. Akademie der Wissenschaften, Philosophisch-Historische Klasse
168. Band, 1 Abhandlung, Wien 1911.





PARATHËNIE

Në historinë e albanistikës, posaçërisht në studimet për gjuhën shqipe, vepra e dijetarit austriak Norbert Jokl zë një vend krejtësisht të veçantë. Eqrem Çabej, duke folur për veprën albanistike dhe për figurën e profesorit të tij me rastin e 30-vjetorit të shuarjes, nuk kishte ngurruar të shprehte dhe një mendim më të përgjithshëm për hierarkizimin e vlerave të albanistikës, me ç'rast Jokl-in e vendoste në radhën e atëherëmë historikisht të rëndësishëmve F. Miklosich - G. Meyer – H. Pedersen – N. Jokl. Dhe e kishte bërë këtë duke shquar atë si mjeshtër të vërtetë të këtyre studimeve, që po sillte një frymë të re, gjerësi në metodën e hulumtimit, thellim qenësor në njohjen shkencore të shqipes. Jo vetëm Çabej, po të gjithë studiuesit e atij brezi e të mëvonë të shqipes kanë vërejtur se, megjithë rezultatet e shënueshme, vepra e Norbert Jokl-it nuk mund të konsiderohet e mbyllur, madje ajo ishte ndërprerë në mënyrën më tagjike të mundshme me vrasjen e tij nga nazistët më 1942, pikërisht në kohën kur pritej që ai t'i sintetizonte rezultatet e punës së tij në një shkallë më të lartë, për të na dhënë dhe një fjalor të madh etimologjik të shqipes e një gramatikë referente krahasuese të saj. Për një punë të tillë ai kishte bërë plane për të cilat diçka mund të mësohet nga letërkëmbimi i tij me Aleksandër Xhuvanin, një tjetër albanolog i shquar i kohës.

Norbert Jokl lindi më 25 shkurt 1877 në Bisenz (Bzenec, Moravi Jugore), ndërsa shumë herët u shpërngul në Vjenë, ku vijoi shkollimin dhe studimet. Fillimisht studioi për jurisprudencë dhe u doktorua në këto shkenca më 1901, për të punuar për një kohë jo shumë të gjatë në praktikën juridike. Në moshën 25-vjeçare iu kthye studimeve të rregullta për gjuhësi të krahasuar indoeuropiane dhe sllave, gjermanike, romane, tek autoritetet e mëdha të kohës: P. Kretschmer, V. Jagić, W. Meyer-Lübke, N. Vondrák, L. V. Schröder. Nga viti 1903 deri më 1923 punoi si bibliotekar kryesor në Universitetin e Vjenës dhe paralelisht zhvilloi studime e mësimdhënie

sidomos për fushat e gjuhësisë fino-ugriane dhe të filologjisë sllave-baltike-shqiptare, fillimisht si privat-docent (1913), ndërsa nga viti 1923 si profesor inordinar. Më 1929 u zgjodh anëtar i Akademisë Rumune të Shkencave, ndërsa më 1936, në kohën kur indoeuropeisti dhe albanologu i shquar Holger Pedersen ishte kryetar i Akademisë Daneze të Shkencave, u zgjodh anëtar i saj. Më 1937 Mbreti Zog i dha Urdhnin e Skënderbeut.

Si specialist për studimet e krahasuara, sidomos për gjuhët sllave, baltike e shqipe, Jokl-i kishte nisur hulumtimin për gradën doktor i shkencave me titull "Një ligj lashto(para)sllav i denazalizimit", të mbrojtur më 1907, ndërsa për habilitim më 1912 kishte pasur veprën që po botojmë tani: "Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes". Në komisione kishin qenë autoritetet e njohura të kohës në Vjenë. Për aspektet e ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë së Norbert Jokl-it tani kemi një monografi të tërë të hartuar nga gjuhëtari shkodran dr. Petrit Kotrri dhe të botuar gjermanisht te Dukagjini.[1]

Në studimet për shqipen Jokl-i ishte mbështetur në dokumentimet tashmë ekzistuese për shumë të folme të saj, si për Shkodrën me rrethinë, për Arbneshin e Zarës, për të folmen e Elbasanit, për çamërishten nga Pedersen-i, për të folmet arëbreshe, për të folmen e Korçës, etj., por i mungonin njohuritë dhe shënimet për të folmet e gegnishtes aktuale verilindore, ndërsa çka mund të gjendej në dokumente të botuara si Cuneus Prophetarum e P. Bogdanit, ai tashmë e kishte përfshirë në punën e tij. Për njohje më të sakta të të folmeve gege verilindore e lindore kishte bërë hulumtime vetë përmes kontakteve me shqiptarët nga Tetova e Gostivari, që kishte ndeshur në Vjenë. Posaçërisht të frytshme kanë qenë hulumtimet e tij në bazë të kontakteve me një shqiptar nga Rapshishti i Gostivarit në Hungarinë e Jugut, për çka ishte dashur të merrte leje të veçantë përmes Akademisë Austriake.

Më 1916 Jokl-i kishte nisur të bashkëpunonte në Vjetarin indoeuropian (Indogermanisches Jahrbuch), ku mbulonte gjuhën shqipe. Këtë detyrë më herët e kishte pasur A. Thumb-i i njohur për studimin e greqizmave të lashtë në shqipen. Në seksionin VII të njoftimeve për botimet Jokl-i jep-

[1] Kotrri (2003), ff. 191.

te shënime të begatshme e të gjera bibliografike me qëndrime objektive e kritike për botimet për shqipen. Këtë punë ai e bëri për 23 vjet me radhë, derisa nuk iu ndalua me ligj të botonte në një revistë gjermane.[2] Ndihmesa e tij në këtë punë ishte çmuar shumë në qarqet albanologjike e indoeuropianiste, për çka flisnin dhe C. Tagliavini, G. Stadtmüller, E. Çabej e të tjerë.[3]

Më 1942, në valën e përndjekjeve naziste të ebreitëve në Vjenë, Norbert Jokl-i ishte vënë në pozitë të vështirë. Përpjekjet e miqve dhe të kolegëve austriakë, italianë e shqiptarë dhe të zyrtarëve shqiptarë nuk kishin qenë të mjaftueshme për ta shpëtuar albanologun dhe mikun e madh të botës shqiptare nga kthetrat naziste. Siç shihet nga raportimet e Tagliavini-t, të Stadtmüller-it, të Koliqit dhe tash nga sistemimi e përmbledhjet e Kotrrit, përveç Koliqit, nga bota zyrtare shqiptare, përfshirë dhe Kryeministrin, shumë i angazhuar për gjetjen e rrugës për ta shpëtuar Jokl-in kishte qenë konsulli shqiptar në Vjenë Nikolla Rotta, i cili dëshprueshëm njoftonte:

> *"... nga Berlini nuk erdhi asnjë vendim dhe më 4 mars 1942 në orën 8 të mbrëmjes në banesën e tij në Vjenë, VII, Neustiftig. 65, Norbert Jokl-i u burgos nga dy zyrtarë të Gestapos ndërsa banesa e tij u dyllos. Ai u çua në Llogorin e grumbullimit në Vjenë II, Castellezgasse 2 dhe më 8 maj të po atij viti ai u detyrua të shkonte në Poloni me transportim. Në momentin e fundit ai nuk iu bashkua grupit, por u vendos në Rossauer Kaserne dhe atje, për pasojë keqtrajtimesh, si rrahje etj., vdiq. Një njoftim nga bashkësia fetare ebraike tregon se ai nuk ishte varrosur në Vjenë" (përkth. R. I.).[4]*

Për rrethanat e zhdukjes së Jokl-it, ashtu si dhe për jetën e për veprat e Norbert Jokl-it dhe ndihmesat e tij për studimet shqiptare ka shkruar edhe historiani i shquar Georg Stadtmüller.[5] Sipas profesorit gjerman, besohet se më 6, apo ndoshta më 8 maj 1942 me një transportim ebreitësh austriakë ai do të jetë nisur për Minsk. Versioni i dytë është ai që u citua nga Rotta, ndër-

---

[2] Kotrri (2003); Tagliavini (1949).

[3] Tagliavini (1949), ff. 296-301; Stadtmüller (1971), 46-61. Për punën e Jokl-it si bibliotekar, po edhe për biografinë e tij shënime të rëndësishme ka lënë dhe Zwanziger (1982), ff. 243-250.

[4] Sipas Kotrri, Petrit: **Norbert Jokl und seine Studien zur albanische Sprache**, Dukagjini Balkan Books, Dukagjini, Pejë, 2003, f. 33

[5] Stadtmüller (1971), 46-61.

sa të tjerë mendojnë se ai do t'i ketë dhënë fund jetës së tij vetë, apo ndoshta do të jetë shpënë në llogor në Riga. Ballkanologu dhe nxënësi i Jokl-it Georg Renatus Solta tërë çështjen e linte të errët:

> *"çështja nëse Jokl-i kishte vdekur qysh në Vjenë nga keqtrajtimet apo më parë ishte transportuar për Minsk dhe atje zhdukur, do të mbetet përgjithmonë e errët"(përkthimi R.I.).*[6]

Afërsisht këtë e thoshin edhe njohës të tjerë seriozë si Eqrem Çabej në Innsbruck, në konferencën ndërkombëtare për Jokl-in që u organizua nga albanologu H. Ölberg më 1972.

Të gjithë ata që e kanë njohur Norbert Jokl-in, miq e kolegë të shquar, i kanë theksuar tiparet e tij prej shkencëtari serioz, kritik, objektiv dhe kërkestar, njeriu të butë dhe të afrueshëm. Le të shkëpusim për këtë pak fjalë të nxënësit të tij Eqrem Çabej:

> *"Norbert Jokli ishte njeri i parimeve dhe me karakter. Një mik i natyrës dhe i kafshëve, në jetën e përditshme me kolegët dhe nxënësit ai ishte gjithnjë dashamirës dhe i gatshëm për ndihmë dhe me korrektesë të madhe... Në kritikën shkencore ai ndiqte parimisht rregullin 'suaviter in modo, fortiter in re'" (përkthimi R. I.).*[7]

Norbert Jokl-i nuk ishte i martuar dhe nuk kishte trashëgimtar. Kishte bibliotekë shumë të pasur dhe, sipas shënimeve që kanë lënë të njohur të tij, e kishte të vështirë ta merrte me mend jetën pa të.

Gjatë jetës së tij Norbert Jokl-i ka botuar dy vepra të veçanta: ***Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung.*** *Sitzungsberichte der philosophisch-historische Klasse der Akademie der Wissenschaften, Wien, 168 (1911) 1. Abh., 1-121 dhe* ***Linguistisch- kluturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen****, Walter de Gruyter & Co. Berlin und Leipzig, 1923, 366 ff. Pas vdekjes së tij Oskar E. Pfeiffer nga dorëshkrimet e mbetura botoi si vëllim më vete* ***Sprachliche Beiträge zur Paläo-ethonologie der Balkanhalbinsel*** *(Zur Frage der ältesten griechisch-albanischebn Beziehungen), mit einem Vorwort von Georg R. Solta, Österreichische akademie*

---

[6] Jokl (1984), f. 6.
[7] Çabej (1972), f. 19.

der Wissenschaften, Wien, 1984, ff. 47. Ka lënë dhe një varg studimesh të çmuara nëpër revista të specializuara si Indogermanische Forschungen, Wörter und Sachen, Zeitschrift für slawische Philologie, nëpër botime homazhesh për studiues të shquar, në tekste themelore studimesh të fushës apo në leksikonë të mëdhenj, etj.

Norbert Jokli studimet për shqipen i bëri objekt kryesor të punës hulumtuese të tërë jetës së tij. Sipas Çabejtë, ky mjeshtër solli një frymë të re në këto studime në raport me paraardhësit e tij të mëdhenj, solli gjerësinë e vështrimeve, solli risi në metodën e hulumtimit, e thelloi qenësisht njohjen e gjuhës shqipe, sado që, sipas fjalëve të vetë Jokl-it, në pjesën e parë të sh. XX shqipja kishte mbetur ende fëmijë jetim i gjuhësisë krahasuese indoeuriopiane, ndërsa sipas E. P. Hamp-it, ky vlerësim i Jokl-it mund të njehej i saktë dhe në vitet '60 të sh. XX.

Vepra e parë e madhe e Jokl-it ishte kjo që botojmë tani – ***Studime për etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes****. Qysh në atë vepër ai kishte inauguruar vështrimin etimologjik që merrte parasysh tërësinë e zhvillimeve të leksikut. Kishte privilegjuar etimologjinë dhe historinë e fjalës, por burimin etimologjik të fjalës synonte ta mbështeste në një pamje sa më të plotë të saj, të formimit dhe të historisë së fjalës në të gjitha zhvillimet. Çabej syzimet e tilla nuk ngurronte t'i quante njëlloj traktati monografik për fjalët, çka gjithsesi do t'i shkonte në masë edhe më të plotë vetë praktikës që kishte ndjekur Çabej. Studimet etimologjike të Jokl-it i shquan, pos thellësisë, shqyrtimit të gjithanshëm, edhe shoshitja e elementeve të kulturës materiale. Jokl-i, siç e kanë vënë në dukje shumë autorë, ishte ndjekës i drejtimit studiues të njohur me emrin "Fjalët dhe sendet" në vijën e Rudolf Meringer-it. Ai madje edhe botonte në revistën "Wörter und Sachen". Ky orientim erdhi e u bë më i theksuar sidomos në kryeveprën e tij* ***Linguistisch-kulturhistorische Untesuchungen aus dem Bereiche des Albanischen****, 1923. Duke vepruar kështu ai ishte i detyruar të merrej me shumë aspekte të studimit të realieve, sidomos të etnografisë, për çka shpesh i hynte në punë dhe dija e tij juridike, sidomos në fushën e së drejtës zakonore, të kanunit dhe të marrëdhënieve farefisnore. Për këto nevoja ai shpesh i drejtohej diskutimit me mikun e tij, etnologun e shquar dhe njohësin e botës shqiptare, baron Franz Nopcsa.*

Në një aspekt më të përgjithshëm, as në një vlerësim kështu të shkurtë nuk mund të harrohet se Norbert Jokl-i në studimet e tij kishte bërë kthesën e madhe që shqipen ta shihte në radhë të parë nga brenda dhe jo më në radhë të parë nga aspekti i raporteve të saj me gjuhët e tjera. Ky vështrim i solli një sërë rezultatesh parimore, ndër to edhe vlerësimin se përmasat e huazimeve dhe të elementeve të huaja në shqipen ishin ndjeshëm më të vogla se ato që ishin thënë në studimet e mëparme. Kjo lidhet sidomos me Gustav Meyer-in dhe konceptin e tij për shqipen si gjuhë që ka aq shumë elemente romane, sa mund të quhet dhe një gjuhë gjysmë-romane. Ai kishte theksuar madje se ndikimet romane shiheshin jo vetëm në leksik, po edhe në gramatikën e shqipes. Ishte Holger Pedersen ai që i mori në shqyrtim pohimet e tilla dhe menjëherë në dekadën vijuese ia doli të përtregonte se në fakt ndikimi latino-roman në gramatikën e shqipes nuk mund të ishte ashtu i gjerë sa supozonte Meyer-i, madje se ai mund të reduktohej në fushën e strukturës së gjuhës në disa prapashtesa dhe se, sipas fjalëve të tij, në fushën e strukturës gramatikore ishte baraz me zero. Pa dashur të përqendrohemi në diskutime të tilla, le të themi se Jokl-i në këto çështje ishte në vijën e Pedersen-it, duke sjellë madje shpesh etimologji shqipe për fjalë që nga Meyer-i ishin trajtuar si romane. Në të njëjtën kohë ai ishte studiuesi që solli ndihmesa të reja sa u përket huazimeve latine të shqipes, qoftë në fushën e interpretimit të përshtatjes dhe të zhvillimit të tyre brenda shqipes, qoftë si fjalë që më parë nuk ishin njohur të tilla.

Në vështrimet e përgjithshme sa i përket vendosjes së shqipes në kuadër të gjuhëve indoeuropiane, siç thoshte dhe Çabej, Norbert Jokl-i mund të shihet si një pasardhës i mirëfilltë i G. Meyer-it, i cili shqipen e kishte përcaktuar si gjuhë IE satem dhe veriore. Jokl-i në këtë aspekt solli dhe njohje të reja, sidomos sa u përket raporteve të shqipes me gjuhët baltike, çka nuk ka mbetur pa u theksuar e vlerësuar nga studiues të shquar të mëvonë si E. P. Hamp, A. V. Desnickaja, etj. Në një periudhë të hershme, parardhësit e shqiptarëve, duke zbritur nga veriu erdhën e u vendosën në brigjet e Mesdheut.

Siç e ka përmbledhur Çabej, për pyetjen se nga doli shqipja, në atë kohë ishin në qarkullim dy përgjigje themelore: 1. nga ilirishtja, tezë kjo e përkrahur nga J. Thunmann, Diefenbach, Fallmerayer, G. Von Hahn,

Niebuhr, Benfey, F. Miklosich, G. Meyer, P. Kretschmer, F. Ribezzo; 2. nga trakishtja (në këtë kompleks shqyrtoheshin dhe raportet me rumanishten), tezë kjo e përkrahur nga Hirt, G. Weigand, J. Whatmough, H. Barić. Njohjet shumë të kufizuara të materialeve të gjuhëve të lashta ballaknike bënin që në shqyrtimin e këtyre çështjeve të merrnin peshë elemente të jashtme, si historia, gjeografia, etnologjia, etj. Jokl-i solli këtu dhe argumente me rëndësi si shqyrtimet onomastike, raportet e shqipes së lashtë me gjuhët greke e latine, etj. Në vijim të shqyrtimeve të atilla, Jokl-i kishte arritur të nxirrte përfundimin e tretë, që shqipja ishte pasardhëse e ilirishtes, po me një komponent të trakishtes, që Çabej e quante sintezë të dy tezave të mëparme. Më tej Jokl-i, madje, djepin e hershëm të shqipes e shihte më parë në Dardani, çka jepte mundësi edhe për shpjegimin e elementit të supozuar trakas dhe të relacioneve me rumanishten. Sipas Çabejtë, teza e Jokl-it në thelb ishte e drejtë, sepse fondi themeltar i shqipes ishte ilir, ndërsa trakas kishte pasur dhe në Adriatik. Në veprën që u botua pas vdekjes së tij, ***Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel****, Jokl-i kishte nxjerrë këtë përfundidm:*

> *"Po të përmbledhim atë që del nga materiali leksikor i shqyrtuar këtu, del se, shqipja është gjuha e një populli që qysh në Lashtë-si, dhe gjithsesi në kohët pararomake ashtu si në kohët romake, kishte shkëmbim gjuhësor me greqishten, se më tej shqipja dhe ilirishtja përkasin bashkë" (përkthimi R. I.).*[8]

Në këtë pikë ai mbi bazë analizash të të dhënave gjuhësore i kundërshtonte qëndrimet e studiuesve rumunë që i përjashtonin shqiptarët nga rrethi i popujve vendës në Ballkan qysh në lashtësi. Konkretisht i kundërshtonte idetë e A. Philippide-s që vendin e hershëm të shqiptarëve e shihte në periferinë e jashtme të Orbis Romanus, mbase në Panoni, dhe të V. Pârvan-it, i cili shkonte edhe më larg dhe shqiptarët i shihte të ardhur në kohën e dyndjes së popujve si paraprijës të serbëve nga Karpatet në Ballkan. Dhe aty nxirrte përfundimin tjetër:

> *"Kontaktet gjuhësore të shqyrtuara këtu të shqipes me greqishten dhe latinishten, siç mund të besoj unë, u japin fund të gjitha hipotezave të këtij lloji. Objekt i studimeve të ardhme do të jetë të përcaktojnë se cilit prej dy popujve të*

[8] Jokl (1984), f. 46.

Siujdhesës Ballkanike - shqiptarëve dhe grekëve – i përket e drejta e të parit" (përktheu R. I.).[9]

Vepra albanologjike e Norbert Jokl-it nuk është e mbyllur, në kuptimin që ajo nuk ishte përfunduar. Vetë Jokl-i mendonte të përfundonte një gramatikë historike-krahasuese të shqipes dhe një fjalor të madh etimologjik, për çka kishte bindjen se tashmë i kishte bërë parapërgatitjet. Mendohet se në një kopje të Fjalorit etimologjik të Meyer-it ai kishte vënë shumë shënime për projektin e tij të fjalorit etimologjik, disa madje thonë se ai këtë tashmë e kishte përmbledhur, por ajo kopje nuk është ruajtur. Sido që të jetë, ndihmesa e Jokl-it për studimet shqiptare është shumë e madhe në një radhë fushash studimi: në studimet e fonetikës historike dhe të vendosjes së kronologjive relative të ndryshimeve fonetike, në studimet e morfologjisë historike, në fushën e historisë së fjalëve dhe të etimologjisë; interesimet e tij ishin në rritje dhe për aspektet e gjuhës së shkruar dhe të gjuhës së sotme, pra në tërësi për gjithëçka që lidhet me shqipen. Është vërejtur se ndihmesat e tij në fushën e sintaksës janë më të pakta. Sido që të jetë, as diskutimet për to nuk mungojnë. Posaçërisht me vlerë janë edhe sot studimet e tij për raportet e shqipes me gjuhët fqinje, me latinitetin ballkanik, me rumanishten e gjuhët romane, me gjuhët sllave të jugut, me greqishten e vjetër e të re. Studimet e tij për gjuhët e lashta të Ballkanit, për trakishten e për ilirishten, dhe për raportet e tyre me shqipen shpesh kanë vlerë edhe sot.

Këtë paraqitje të veprës dhe të figurës së Jokl-it do të doja ta përmbyllja me një fjalë të peshuar dhe të matur që njohësi më i mirë i veprës së tij, Eqrem Çabej, e kishte shqiptuar me rastin e 30-vjetorit të vdekjes së tij:

> *"Me këtë dijetar albanistika humbet një përfaqësues të madh, atë që e pat zgjedhur studimin e shqipes për mision të jetës së tij. Përtej caqeve të dijes, populli shqiptar humbet një burrë, i cili, duke rrahur me frymë objektive ravën shkencore, u bë njëkohësisht dhe indirekt një mbrojtës i të drejtave tona nacionale".*[10]

Deri sot vepra e Norbert Jokl-it nuk është botuar e përmbledhur në një sërë, as gjermanisht, as shqip. Nëpër revista janë botuar studime të veçanta të

---

[9] Aty, f. 47.
[10] Çabej (1972a), rimarrë në Çabej (1975), ff. 204-207, këtu f. 207.

tij shqip, ndërsa në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë ruhet një numër përkthimesh interne të veprave të tij, që janë bërë kryesisht për të qenë në shërbim të studiuesve të atij instituti. Në këtë Insttitut ruhet edhe përkthimi i veprës që po botojmë sot i bërë nga albanologu më i madh i kohës, Eqrem Çabej. Për botim në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës me rastin e 100-vjetorit të botimit të parë të veprës dhe në fillim të serisë së veprave të Jokl-it, nga Qendra e Studimeve Shqiptare në Tiranë, në kuadër të së cilës është Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, kërkuam të na bëhej e mundshme të merrnim një kopje nga ky përkthim. Prof. dr. Ardian Marashi, drejtor i Qendrës qe shumë i vëmendshëm për kërkesën tonë dhe na la në dispozicion kopjen e përkthimit të kësaj vepre të Jokl-it nga Çabej, ashtu si dhe kopjen e veprave të tjera të përkthyera të Jokl-it nga të tjerë studiues e përkthyesmerret vesh, me zotimin që ASHAK t'i përmbushë detyrimet sipas rregullores së saj. Me këtë rast i shprehim falënderimin tonë Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe drejtorit të saj prof. dr. Ardian Marashi për mirëkuptimin.

Tekstin shqip nga dorëshkrimi i shkruar me makinë dhe pa shenja të veçanta, të radhitur nga shërbimi i ASHAK-ut, e kontrolluam vetë, duke u kujdesur sidomos për shenjat diakritike jashtëzakonisht të shumta të përdorura nga Jokl-i. Përkthimi nga Çabej është bërë në shqipen e atëhershme (mbase nga fundi i viteve '50), pra, në toskërishten e atëhershme letrare, por brenda edhe me forma të veçanta të geg. së atëhershme letrare, apo edhe të vetë gjuhëtarit të madh. Jemi përpjekur ta ruajmë në tërësi dhe në detaje gjuhën dhe shkrimin e Çabejtë.

Meqenëse ASHAK kishte vendosur të niste serinë e botimit të veprave të Jokl-it në disa vëllime të përkthyera shqip dhe në origjinalin e tyre gjermanisht, meqenëse shumë prej botimeve të veprës së Jokl-it, sidomos ato që janë shpërndarë nëpër revista e botime homazhesh, tashmë janë bërë të rralla dhe nuk gjenden me lehtësi, ne vendosëm që krahas përkthimit shqip, të vëmë botimin gjermanisht në formë fototipike - të skanuar, për dy arsye: kështu evitonim çdo mundësi gabimesh të reja në tekstin e Jokl-it gjatë radhitjes dhe njëherësh jepej mundësi që këto tekste të referoheshin sipas origjinalit dhe faqosjes së tij burimore.

Për të siguruar kopjet e veprave të Jokl-it të shpërndara nëpër revista e botime të ndryshme gëzuam ndihmën e pakursyer të profesor dr. Heiner Eichner nga Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Vjenës, kopmaratistit që në qarkun e interesave të tij gjithnjë e mban shqipen dhe që ka merita për studimet albanistike në këtë Institut. Profesor Eichner na ndihmoi të siguronim një fotokopje të ksomblës së botimit të veprës Studien zur albanesische Etymologie und Wortbildung në të cilën vetë Jokl-i kishte shënuar në faqen përbri plotësime dhe vërejtje të ndryshme për zërat e veçantë të veprës së tij. Shënimet e Jokl-it të shumtën e rasteve lexohen qartë, por ka raste kur për ne leximi ishte i vështirë. Kjo ishte arsyeja pse ne vendosëm që, krahas faqes së skanuar të botimit ashtu si ka dalë nga shtypi, ku janë vënë dhe indiciet për shënimet në faqen përbri, të vëmë po ashtu faqet me shënime me dorë të Jokl-it. Përfitojmë nga rasti që Profesor Eichner-it t'i shprehim falënderimet tona të përzemërta për këtë ndihmë të veçantë.

Prishtinë, maj 2011 *Rexhep Ismajli*

Shënime bibliografike

Ky shënim është hartuar në bazë të disa shkrimeve themelore për jetën dhe veprën e Norbert Jokl-it. Ndër autorët që janë marrë me figurën, personalitetin dhe vepërn e Norbert Jokl-it ka studiues të brezit të tij dhe sidomos të brezit pas tij, ndër ta edhe ish-studentë ose vijues studimesh gjuhësore në frymën e qerthujve ku sillej Jokl-i. ***Janë posaçërisht me interes shkrimet dhe vlerësimet e autorëve si Eqrem Çabej, Carlo Tagliavini, Georg Stadtmüller, Aleksandër Xhuvani, Georg Renatus Solta, Gerhad Grimm, Mahir Domi, Eric P. Hamp, Hermann Ölberg****, e të tjerë. Më poshtë është vënë lista e përzgjedhur e shkrimeve të përdorura. për këtë rast.*

Çabej (1972), Eqrem: Das albanologische Werk Norbert Jokls. In: Hermann M. Ölberg (ed.), Akten des Internnationalen Albanologischen Kolloquiums, Innsbruck 1972. Zum Gedächtnis an Norbert Jokl, Innsbruck 1977, 3-22.

Çabej (1977), Eqrem: Në tridhjetëvjetorin e vdekjes së Norbert Joklit. In: Mësuesi, 25. 10. 1972, 8., sowie in: Studime gjuhësore 5 (Prishtinë) 1977, 204-208.

Dodić (1972), Lazar: Die Beziehung Norbert Jokls zu den zeitgenossischen Albanologen und albanischen Schriftstellern anhand seines Nachlasses, në Ölberg, Hermann (ed.): Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972, zum Gedächtniss an Norbert Jokl, Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft 41, Innsbruck, 1977, ff.

Domi (1972), Mahir: Norbert Jokl (1877-1942). In: Revista Pedagogjike 6 (1972) 152-162.

Grimm (1965), Gerhard: Norbert Jokl. In: Österreichisches Biographisches Lexikon 1815-1950, 3 (Graz-Köln) 1965, 128.

Kastrati (1973), Jup: Dr. Prof. Norbert Jokl – albanolog i shquar, Buletin shkencor, ILP, Shkodër, 1973, ff. 167-203.

Kotrri (2003), Petrit : Norbert Jokl und seine Studien zur albanische Sprache,

Dukagjini Balkan Books, Pejë, 2003, ff. 191.
Ölberg (1977), M. Hermann: Schriftenverzeichnis von Norbert Jokl, në Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972, zum Gedächtniss an Norbert Jokl, Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft 41, Innsbruck, 1977, ff. 67-74.
Seliger (1960), Kurt: Ein österreichisches Gelehrtenschicksal. In: Volksstimme 2 (Wien) 3.1.1960, 9-10.
Solta (1974), Georg R.: Norbert Jokl. Indogermanist, Albanologe. In: Neue Deutsche Biographie 10. 1974, 585.
Solta (1984), Georg R.: Vorwort. In: N. Jokl Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel (Zur Frage der ältesten griechisch-albanischen Beziehungen), Wien 1984. (Postum).
Stadtmüller (1971), Georg: Norbert Jokl und sein Beitrag zur Albanienforschung. In: Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen Orients XIII, "Dissertationes Albanicae" (München) 1971, 46-61.
Tagliavini (1949), Carlo: Norbert Jokl (1877-1942). In: Indogermanisches Jahrbuch 28 (1949) 296-301.
Xhuvani (1937), Aleksandër: Gjashtëdhjetvjetori i Prof. Joklit. In: Përpjekja shqiptare 1 (März 1937) 226-229.
Zwanziger (1982), Ronald: Norbert Jokl – Albanologe und Bibliothekar. Zur 40. Wiederkehr seines Todestages. In: Österreichische Zeitschrift für Buch-und Bibliothekswesen 31 (Wien) 1982, 243-250.

BIBLIOGRAFI E BOTIMEVE TË NORBERT JOKL-IT[11]

Ein urslavisches Entnasalierungsgesetz. *Archiv für slavische Philologie 28 (1906) 1-17.*
Ein urslavische Entnasalierungsgesetz. Antikritik und Nachträge. *Archiv für slavische Philologie 29 (1907) 11-49.*
Etymologisches. Gem.-sl. proso, r. prjáda, prudítь, prudъ, aksl. prądъ, slov. prọd. *Zbornik u slavu V. Jagića, Berlin 1908, 481-485.*
Über "Etymologische Anarchie" und ihre Bekämpfung. *Indogermanische Forschungen 27 (1941) 297-324.*
Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung. *Sitz.-Ber. der phil.-hist. Kl. d. Akademie d. Wiss. Wien, 168 (1911) 1. Abh., 1-121.*
Beiträge zur albanesischen Grammatik. (1) Zur Geschichte des alb. ts in Erbwörtern. (2) Vertretung des uralb. zd aus idg. sd(h), zd(h). *Indogermanische Forschungen 30 (1912) 192-210.*
Katun. Zur Geschichte eines Balkanwortes. *Indogermanische Forschungen 33 (1913/14) 420-433.*
Eine albanesisch-neugriechische Wortparallele. *Mitteilungen des Romanischen Instituts Wien, 1. Band, Heidelberg 1914, 298-308.*

[11] *Sipas Kotrri (2003)*

Wachsplattenaufnahme des Märchens "Die Stute und der Wolf", aufgesprochen von Mustafa Abdül aus Rapsist bei Gostivar. Aufnahme im Phonogrammarchiv Wien am 4.4.1914. Transkribiert und übersetzt von N. Jokl. Platte Nr. 2351, 2352.

Vorläufiger Bericht über die im Auftrag der Balkankommission der K. Akademie der Wissenschaften in Wien durchgeführten nordostgegischen Dialektstudien. *Anzeiger der Akademie der Wissenschaften Wien, phil.-hist. Klasse, Band 52 (1915) Nr. XIII, 68-74.*

Beiträge zur albanischen Grammatik. (3) Der Akkusativ-Nominativ und der Geschlechtswechsel im Albanischen. *Indogermanische Forschungen 36 (1916) 98-164.*

Beiträge zur albanischen Grammatik. (4) Die Verbreitung der Dehnstufenbildungen im Albanischen. *Indogermanische Forschungen 37 (1916/17) 90-122.*

Albanisch *Grundriss der indogermanischen Sprach- und Altertumskunde 3, Geschichte der indogermanischen Sprachwissenschaft seit ihrer Begründung durch Franz Bopp II, Die Erforschung der indogermanischen Sprachen III, Straßburg 1917, 109-151.*

Miszellen. (1) poln. jata, cech. jatka, südsl. pojata. (2) bulg. gracmul "Speiseröhre, Schlund". (3) Alb. tosk. ndene?, nene, geg. ndân, nâ'n, na'n "unter, unterhalb". *AslPh 37 (1920) 542-547.*

Vulgärlateinisches im Albanischen. Alb. boŀe "grosse Schlange". *Zeitschrift für Romanische Philologie 41 (1921) 228-233.*

Das Finnisch-ugrische als Erkenntnisquelle für die ältere indogermanische Sprachgeschichte (Vorläufige Mitteilungen aus einer größeren Arbeit). *Prace lingwistyczne ofiarowane Janowi Baudouinowi de Courtenay dla uczczenia jego działności naukowej 1868-1921, Cracow 1921, 97-112.*

Vuks albanische Liedersammlung, herausgegeben und mit sprachwissen-schaftlich-sachlichen Erläuterungen versehen. *Zbornik filoloških i lingvističkih studija A. Beliću povodom 25-godišnjice njegova naučnog rada posvećuju njegovi prijatelji i učenici, Beograd 1921, 33-86.*

Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen. *Berlin und Leipzig 1923.*

Zur albanischen Sprachgeschichte. I. Intern Albanisches. II. Zur Kenntnis der alb.-lt. und alb.-rom. Beziehungen. III. Zu den älteren alb.-slav. Beziehungen. *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju 1 (1923) 34-46.*

Albaner. B. Sprache, *Eberts Reallexikon der Vorgeschichte 1 (1924) 84-93.*

Thrakisches, *Streitberg Festgabe, Leipzig 1924, 173-181.*

Naim Be Frashëri e Pasunimi i gjuhës Shqipe. *Naim Frashërit! Vjershetorit dhe edukatorit kombetar. Graz 1925, 84-97.*

Bemerkungen Jokls zu alb. buzem, buzmi "Julblock". *E. Schneeweis, Die Weihnachtsbräuche der Serbokroaten. Erg.-Bd. 15 zur Wiener Zeitschrift für Volkskunde, 1925, 176.*

Illyrier. B. Sprache. *Eberts Reallexikon der Vorgeschichte 6 (1926) 33-48.*

Zum Erbwortschatz des Albanischen. *Indogermanische Forschungen 43 (1926) 47-64.*

Griechisch-albanische Studien. *Festschrift Paul Kretschmer, Wien-Leipzig, New-York 1926, 78-95.*

Die Bektaschis von Naim Be Frashëri, herausgegeben und übersetzt von Norbert Jokl. *Balkan-Archiv 2 (1926) 226-256.*

Altmakedonisch-Griechisch-Albanisches. *Indogermanische Forschungen 44 (1927) 13-70.*

Die magyarischen Bestandteile des albanischen Wortschatzes. (Wortge-schichtliche Studien aus den südosteuropäischen Sprachen) *Ungarische Jahrbücher 7 (1927) 46-84.*

Kelten und Albaner (Eine Untersuchung ihrer Isoglossen) *Symbolae Grammaticae in honorem Ioannis Rozwadowski, I, Cracoviae 1927, 235-250.*

Albanisch-iranische Berührungen. Wiener Zeitschrift für die Kunde des Morgenlandes (WZKM) 34 (1927) 30-50.
Phryger. A. Sprache. Eberts Reallexikon der Vorgeschichte 10 (1927/ 28) 141-153.
Balkanlateinische Studien. Balkan-Archiv 4 (1928) 195-217.
Rumänisches im Albanischen. Revista filologicA, Cernăuţi 2 (1928) 246-267.
Mërkosh. Eine Entgegnung. Revista filologică, Cernăuţi 2 (1929) 359-361.
Thraker. B. Sprache. Eberts Reallexikon der Vorgeschichte 13 (1929) 278-298.
Zur Vorgeschichte des Albanischen und der Albaner. Wörter und Sachen 12 (1929) 63-91.
Balkangermanisches und Germanisches im Albanischen. Festschrift der 57. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner, in Salzburg 1929, 105-137.
Nji studim i Prof. Dr. Norbert Jokl (Përreth librit të Buzukut). Hylli i Dritës 6 (Shkodër 1930) 145-154.
Zur Geschichte des alb. Diphthongs -ua-,-ue-. Indogermanische Forschungen 49 (1931) 274-300.
Zur Geschichte des alb. Diphtongs -ua-,-ue-. Indogermanische Forschungen 50 (1932) 33-58.
Südslavische Wortstratographie und albanische Lehnwortkunde. Sbornik Miletič, Sofia 1933, 118-146, 659-660.
Zur Ortsnamenkunde Albaniens. ZONF 10 (1934) 181-206.
Zur Lehre von den alb.-griech. Teilgleichungen. RIEB 1 (1934) 46-64.
Balkanlateinische Untersuchungen. 1. Lat. sagitta auf der Balkanhalbinsel, 2. Lat. retina auf der Balkanhalbinsel, 3. Lat. subterraneum und die Frage der balkanlat. Schicksale von -pt-, -ct-, 4. Das Balkanlt. als Vorlage für das alb. Übersetzungslehnwort. RIEB 1/3 (1936) 44-82.
Zu den lateinischen Elementen des albanischen Wortschatzes. Glotta 25 (1936) 121-134.
Ein Beitrag zur Lehre von der alb. Vertretung der idg. Labiovelare. Mélanges linguistiques offerts à Holger Pedersen, København 1937, 127-161. (= Acta Jutlandica 9).
Dijtunija europjane e gjuha shqype. Cirka 2 (Shkodër 1937) 283-285.
Albanologische Beiträge zur Kenntnis des Balkanlateins. Vox Romanica 6 (1941/42) 207-232.
Zur Frage der vorrömischen Bestandteile der alpinlombardischen und räto-romanischen Mundarten. Vox Romanica 8 (1945/56) 147-215.
Shënime vjetore për literaturën për shqipen në Indogermanischen Jahrbuch, Sektion VII, von Bd. 4, 1916 (1917) bis Bd. 24, 1940.

PUNIME TË BOTUARA PAS VDEKJES

Die Verwantschaftsverhältnisse des Albanischen zu den übrigen indogermanischen Sprachen. (Verfaßt ca. 1920-1925). Die Sprache 9 (1963) 113-156;
Sprachliche Bemerkungen zur älteren Geschichte der Albaner. (Hartuar shqip ca. 1933-1934). Studia Albanica 1 (1964) 47-50 (gjermanisht nga E. Çabej).
Rumänisches aus Albanien. (hartuar rreth 1925). Studia Albanica 2 (1964) 75-79.
Disa fjalë të shqipes si dëshmi të historisë së kulturës shqiptare. (hartuar rreth 1934-1937). Studime filologjike 3 (1964) 3-13. (përktheu E. Çabej).
Albanische Wörter als Zeugen albanischer Kulturgeschichte. (hartuar rreth 1934-1937) Studia Albanica 1 (1964) 51-60.
Shënime gjuhësore për historinë e lashtë të shqiptarëve. (hartuar rreth 1933-1934). Studime filologjike 2 (1964) 3-6.

Populli shqiptar dhe gjuha e tij. *(Nga libri "Die Erforschung der indogermanischen Sprachen"). Shkëndija 5 (1943) 5-7; 6 (1943) 8-13; 7 (1943) 1-5; 8-9 (1943) 11-12; 10 (1943) 15-16; 11 (1943)4-7; Hylli i Dritës 9-12 (1943) 325-334; 6-7 (1944) 53-62.*

Gjykime mbi At Gjergj Fishtën e veprën e tij. *Bd. A. Gjergj Fishta (1871-1940) Shkodër 1943, 486-490.*

Sprachliche Beiträge zur Paläo-Ethnologie der Balkanhalbinsel (Zur Frage der ältesten griechisch-albanischen Beziehungen). *Aus dem Nachlaß herausgegeben von Oskar E. Pfeiffer. Mit einem Vorwort von Georg R. Solta. Schriften der Balkankommission, Linguistische Abteilung XIX, Verlag der Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien 1984.*

RECENSIONE DHE ARTIKUJ RECENSUES

Recension *për: G. Pekmezi, Grammatik der albanischen Sprache (Laut- und Formenlehre), Wien 1908. Archiv für slavische Philologie 31 (1909) 237-242.*

Recension *për M. Lambertz und G. Pekmezi, Lehr- und Lesebuch des Albanischen, Wien und Leipzig [1913]. Archiv für slavische Philologie 35 (1914) 594-598.*

Recension *për Endzelin, Slavjano-baltijskie etjudy, Charьskovъ 1911 (Slavisch-baltische Studien, angez. v. Jokl). Archiv für slavische Philologie 35 (1914) 307-317.*

12. Recension *për G. Weigand, Albanesisch-deutsches und deutsch-albanesisches Wörterbuch, Leipzig 1914. Indogermanische Forschungen 35 (1915) 32-38.*

Recension *për H. Krahe, Die alten balkanillyrischen geographischen Namen auf Grund von Autoren und Inschriften bearbeitet, Heidelberg 1925. ZONF 2 (1926/27) 238-245.*

Rezension *von Kr. Sandfeld, Balkanfilologien, Kpbenhavn 1926. Litteris 4 (1927) 191-210.*

Recension *von Balkan-Archiv 1-3, Leipzig 1925-1927. Indogermanische Forschungen 46 (1928) 379-385.*

Rezension *von A. Baldacci, Studi speciali albanesi I., Rom 1932. Petermanns Mitteilungen 79 (1933) 162.*

Recension *për M. Roques, Le dictionnaire albanais de 1635, Paris 1932. OLZ 37/7 (1934) 406-409.*

Slaven und Albaner. *(Artikull recensues për A. M. Seliscev, Slavjanskoe naselenie v Albanii , Sofia 1931). Slavia 13 (1934) 281-325, 609-645.Rez. A. Vaillant, RESI 15 (1935) 237.*

Zur Erforschung der albanischen Mundart von Borgo Erizzo in Dalmazien. *(Artikull recensues për C. Tagliavini L'Albanese di Dalmazia, Firenze 1937). Archivum Romanicum 24 (1940) 101-137.*

Norbert Jokl

STUDIME PËR ETIMOLOGJINË DHE FJALËFORMIMIN SHQIP

Nga gjermanishtja **Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung** shqip e përktheu Eqrem Çabej.

Marrë nga Arkivi i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Përgatiti për botim Rexhep Ismajli.

Prishtinë, 2011

I.

STUDIME MBI ETIMOLOGJINË DHE FJALËFORMIMIN E SHQIPES

(parashtruar në mbledhjen e 14 dhjetorit 1910)

Leksiku i shqipes i paraqet etimologut edhe sot një tok problemesh interesante. G. Meyer çmonte se numri i fjalëve që ai nuk shpjegoi është nja 730 (Fj. et. f. IX). Po të mendojmë që Fjalori etimologjik i Meyer-it, si e para vepër e këtij lloji, dhe mund të themi, si i pari fjalor i madh që përfshin njëkohësisht disa nga dialektet e gjuhës, është larg së përfshiri gjithë thesarin e gjuhës, atëherë mund ta marrim me mend se sa punë mbetet për të kryer në fushën e interpretimit etimologjik të fjalëve. Është e vërtetë se ankimi i Pedersen-it (K.Z. 36, 308) që shqipen nuk e njohim akoma në mënyrë të plotë vlen edhe për sot e gjithë ditën. Po, megjithatë, njohja e leksikut të kësaj gjuhe në kohët e fundit ka shkuar mjaft përpara. Dy fjalorë të mëdhenj, ai i Kristoforidhit (Athinë 1904) dhe ai që botoi më 1908 Shoqënia Bashkimi në Shkodër, kanë shumë fjalë që do t'i kërkonim më kot në glosarët e gjertanishëm. Në qoftë se nga këto dy vepra e dyta ka një pasuri fjalësh më të madhe, fjalori i Kristoforidhit ka këtë dobi që fjalët na i paraqet në trajtën e tyre dialektore dhe shënon edhe proveniencën e tyre, dobi kjo, që për punën e etimologjisë ka vlerë shumë të madhe. Literatura, që po punohet në një rreth vërtet modest, po të gjallë patriotësh shqiptarë, pasuron shumë edhe kjo njohjen tonë të gjuhës: libra shqip me brendi didaktike, dëfryese ose morale-fetare dhe shënime me karakter folkloristik na japin kontribute të reja për një njohje më të mirë të visarit të gjuhës popullore (duke lënë mënjanë neologjizmat e

shumta, që s'kanë ndonjë interes për ne nga pikëpamja e etimologjisë). Po edhe një lexim i saktë i teksteve të moçme na nxjerr në shesh një material që gjer më sot kish mbetur i pazbuluar. Kështu na gjejmë që te Bogdani një burim fjalësh, të cilat gjenden dhe në fjalorët ma të rinj që përmendëm më lart dhe janë interesante për punë të etimologjisë. Në kërkimet që po paraqesim më poshtë autori është munduar të shfrytëzojë të gjitha këto mjete e burime që thamë. Në këtë punë ai formoi bindjen gjithmonë e më shumë që G. Meyer-i ka shkuar tepër larg në pranimin e huazimeve. Për autorin ka qenë një gëzim që në këtë pikë ai pajtohet me mendimin e dijetarëve të tillë siç janë G. Meyer (khs. Grundriss der rom. Philologie, bot. i dytë I, f. 1041) e H. Pedersen (Jahresber. f. rom. Philol. 9, I, 203). Le të shënojmë edhe që kërkimet që po rreshtohen në këto fletë trajtojnë kryesisht vetëm probleme thjesht etimologjike, dhe çështje të gramatikës rrihen aq sa hyjnë në punën e shpjegimit të fjalëvet. Etimologjitë, që mund të diskutohen vetëm në kuadrin e gjerë të një pjese të fonetikës, i kemi evituar pothuajse krejt dhe rezervohemi t'i trajtojmë në një studim më të vonë. Përkundrazi, disa çështje të morfologjisë janë pothuajse gjithmonë të pandara nga çdo lloj kërkimi etimologjik. Dhe më shumë se në gjuhët e tjera, tamam në shqipet, së cilës morfologjinë ia dimë kaq pak, na u desh të hyjmë më thellë në punën e formimit të fjalëvet, me rastin e kërkimeve të etimologjisë. Këtë drejtim kërkimesh autorit iu duk me udhë që ta shprehte edhe në titullin e këtij studimi. Po meqenëse morfologjia s'kish sesi të merrej parasysh njësoj në të gjitha fjalët e trajtuara dhe ma nuk mund të paraqitte një kriter racional për një ndarje të gjithë monografisë, autori për të theksuar të njëjtat elemente të morfologjisë ndoqi këtë rrugë: që në artikujt e trajtuar i shënoi me gisht këto elemente qoftë ato që ishin cekur më sipër, qoftë ato që vijonin më poshtë. Për përsëritjet që kanë rrjedhur nganjëherë nevojisht nga kjo mënyrë pune autori kërkon ndjesë nga lexuesi.

I LEKSIKU I TRASHËGUAR

a m ë z ë erë, erë e mirë; shijë e idhët

Kristoforidhi, Fjalori f. 4, jep këto kuptime: l. *ὀσμή, πικρὰ γεῦσις;* Bashkimi[1] s.v. *amez* (f. 22) sjell vetëm kuptimin e dytë. Kjo fjalë hyn në grup me lat. *odor* erë, gr. *ὀδμή* erë e mirë, lit. *ūdžiu*, i marr erë. Paraqet të njëjtin sufiks si gr. *ὀδμή. -zë* është sufiks deminutiv i zakonshëm i shqipes. Kuptimin e dyfishtë erë, shije e gjejmë dhe në gjerm. e vj. të lartë *smecken* shijoj, përkundër gjerm. së mes. të l. *smecken* mbaj erë, mbaj erë të mirë. Sot dialekte të gjermanishtes (bavarishtja, alemanishtja, hesishtja) përdorin foljen *schmecken* shijoj me kuptimin i marr erë (Weigand, Deutsches Wört. 5 II, shtylla 745; Kluge, E.W.[7] 405). Si fjala *schmecken* në dialektet gjermane me kuptimin e dytë nga ata që u thanë, në gegërishtet (Bashkimi l. c.) kuptimi shije zuri kryet e vëndit. Trajta bazë **od-mā* që del për shqipen paraqet një asimilim të *d-* me *m-*, që është analog me atë të *d-* me *n-* (*punë* nga **spud-nā:* gr. *σπεύδω*, *shtynj* nga **stūd-n̥jō,* G. Meyer, A. St. 3, 28, Brugmann, Gr. I[2]*,* 664).

a n ë f. *e n ë*

Meyer, E.W.12, këtë fjalë e bashkon me dyshime me *anë*. Mendoj se shkon me ind. e vj. *ukhá-n̥, ukhā́* enë, vorbë, lat. *aulla* vorbë, kuth (khs. deminutivin *auxilla,* nga **auxla,* Walde, E.W. 55, 275), got. *auhns* sobë, stufë (tigan për të ngrohur) angl. e vj. *ofnet* enë e vogël (Meringer, I.F. 21, 292; Fick. 3[4], 29; Feist, E.W. 37). Baza e fjalës shqipe **auq^{u}-nā,* me asimilim të labiovelares me *n*, siç zhduken të tjera guturale përpara *n*-së: khs. *ndynj* nga **dhūg-n̥jō*: gjerm. e vj. e l. *tūhhan* (Meyer, E.W. 302, A. St. 3).[2]

---

[1] Fjaluer i Rii i Shcypés Përbâm Préie Shocniiét t'Bashkimit ([Shkoder 1908]).

[2] Sa për shumësin tosk. *ena* geg. *ên* (Pekmezi, Gr. 231) khs. shumësin e tosk. *netë*, geg. *nèt,*

a v a r í bashkë, së bashku

Përveç se te Jarnik-u e te Meyer-i (E.W. 20), këtë fjalë e gjejmë tani dhe te Jungg, Fjal.,[3] f. 2 e te Bashkimi f. 29. Jungg-u këtë fjalë e quan huazim nga turqishtja, por të këtij mendimi nuk janë Meyer-i e Bashkimi. Në të vërtetë, *avarí* është fjalë e përngjitur që mund të shpjegohet fare mirë me mjetet e shqipes. *a*-ja është po ai prepozicion që e gjejmë dhe në kompozita të tjera: *arrotulla* rreth e përqark (Meyer, E.W. 375), *avis* afroj (sh. më poshtë), *afër* (sh. më poshtë). Kjo *a*- do të jetë marrë prej lat. ad. *var-ī́*: gr. *ἀείρω* ngjit, bashkoj, *συνᾱ́ορος* i ngjitur, i lidhur ngushtë, i shoqi, e shoqja; *παρᾱ́ορος* i ngjitur përkrah, i bashkuar, *ἀπᾱ́ορος* i shqitur, i shkëputur, i largët, let. *weŕu, wērt* radhit, qëndis, qep, *rvirtene* (për *wir-tne*) e shkruar varg, një varg, lit. *vorà* radhë, rus. *svora* zinxhir, sll. e vj. kisht. *sъvora* fibula, çek. *vor* argsh, run. *vereníca* radhë e gjatë, e pakëputur, ku hyn *verénъka* tubë, vandak, një krah dru (khs. Për këtë varg fjalësh Solmsen, Unters. 290 v., Zubatý, Arch. F.sh. Phil. 16, 418). Sufiksi -*ī* është i njëjti si në *njerí, kallí* (Meyer E.W. 313) *dorbërí* kope, tufë (sh. më poshtë), *zí* (sh. më poshtë). Më afër do ta trajtojmë këtë sufiks te fjala *zī.* Pra te *avarí* kemi të bëjmë po ashtu me një substantiv të ngurosur (ngjitje, bashkim, të vënët varg) si dhe te sinonimi i saj *bashkë,* ajo qëndron ndaj rus. *verénъka* vandak, një krah dru ashtu sikundër *bashkë* qëndron ndaj lat. *fascis* tubë, vandak thuprash (G. Meyer, I. F. 6, 106).

a v i s, a v i t e m; a v i t i n j (Bogdani) sjell, bie mbledh afroj

Trajtën aktive *avis,* që s'e ka Meyer-i, e shënon Kristoforidhi, Fj. f. l me Bashkimin f. 29. Bogdani në Cuneus Proph. I. 81, 10 *avitinj* e përdor për lat. *cingregare* dhe pak më tutje për *aferre tue u avitunë* (aty I., 87, 6) për ital. *accostandosi*. Meyer-i në E.W. 20 këtë fjalë e paraqet, po me dyshime, si huazim nga serbokr. *obići* me vizitue, me

---

dhe vrejejtjet që bën për këtë shumës Pekmezi f. 94. Edhe kuantiteti i *ẽn* është në gegërishtet po ai që ka edhe fjala *nèt. anë* shkon pra me analogji me fjalët si *natë.* Njëjësi *enë* që ndeshim në toskërishtet krahas me *anë* u sajua pas shumësit.

[3] Fialuur i voghel scъp e ltinisct. N'Sckoder 1895.

provue, po ky shpjegim çalon disi nga ana e kuptimit. Edhe më pak shkon kjo etimologji nga pikpamja fonetike. Sepse sll. *b* na paraqitet në shqipet përhera si *b* në trup dhe në ballë të fjalës (*robinjë* shklave, *bisedoj,* emri topik *Berat* nga *Bělъgradъ* etj.). Në të vërtetë *avis* na paraqet një verbum compositum: *a-* është prepozicioni që trajtuam te *avari; vis* është identike me vis vënd, kështu që kjo përbërje e fjalës i përgjigjet mirë kuptimit "afroj, sjell, bie, mbledh" (në të vërtetë "grumbulloj për vete, fut në xhep"). Forma *avitinj* që ka Bogdani është e sajuar si *mundinj* (Bogd. l. c. I, 26, 42, *apinj* ibid.15, 14, *mbushinj* ibid. 43, 12). Ky verb, me *t-* radikale, na jep në dorë dhe çelësin për të shpjeguar fjalën *vis* m. vënd, geg. *anvise* zonjë shtëpie, nikoqire, *s-* të së cilës edhe Pedersen-i, K.Z. 36, 338 e konsideroi si refleks të *k̂*-së indoeuropiane, refleks i shkaktuar nga *v-*ja që ndodhej në ballë të fjalës. Mendoj se nuk është e domosdoshme që *vis* të shqipes ta lidhim me lat. *vicus,* sll. e vj. kisht. *vьsь* fshat, got. *weihs* fshat, katund etj. siç është bërë vazhdimisht që nga Meyer-i, E.W. 473 e tej (Pedersen, l.c.; Brugmann, Gr. 12, 557; Walde, E.W. 313; Fick 3^4, 409). Fonetikisht e semantikisht shq. *vis* mund ta afrojmë me lit. *vẽtà* vënd, vise, let. *wita* vënd, sll. e vj. kisht. *vitati* me banue, me ndejë (nëpër burime më të pastajme edhe "hyj në një shtëpi"), serb.-sll. kisht. *vitalište* banesë, rus. *privitátь* me ndejë, me banue. Si shqipja e sllavishtja, edhe lituanishtja, përveç kuptimit të përgjithshëm të "vëndit", ka edhe kuptimin e veçantë të "banimit". Kjo gjë na del nga kompozita si *vënvẽte* banesë e përbashkët e disa personave (Nesselmann, f. 72); *pavẽtis* godinë anekse, ballkon, lëndë. Baza e fjalës shqipe: **veit-i̯o-* ose *vit-i̯o*. Për mënyrën si është formuar fjala khs. gr. *οἰκίον*, *οἰκία* shtëpi, konak: *οἶκος* shtëpi.

b a g ë t ḗ, geg. *b a k t ḗ*

Meyer-i, E.W. 22 jep kuptimin gjë e gjallë, kafshë barre (sipas Hahn, A. St. 3l 11); kuptimin e dytë e merr hipotetikisht për kuptimin bazë dhe mendon që kjo fjalë mund të ketë të bëjë me frëngj. e vj. *bague* vandak, lombard. *bergam,* venec. *baga* rëshik vere, span. *baga* tërkuzë barre etj. (prej nga vjen dhe *bagage*), veçse fjalorët e rinj (Kristoforidhi 39, Bashkimi 33) na japin vetëm kuptimin *bagëti*. Gjithashtu

Kullurioti, *Ἀλφ* f. 56 ka *bagëtí* = gr. e re *κτῆνος*. Një dokument më i lashtë, Bogdani, Cun. Proph. I, 90, 20 e 21 e përkthen këtë fjalë vetëm me armenti. Po ashtu edhe në shkrimin: *Fe-rɛ̄fejɛs e mɛsime müslimane* prej J. H. M., Elbasan 1909, f. 19 kjo fjalë është përdorur me kuptimin gjë e gjallë, bagëti. Për këto arsye zor që në shpjegimin e kësaj fjale të mund të nisemi nga kuptimi kafshë barre. Posaçërisht duhet pasur parasysh që sufiksi -*ëtí* (sh. më poshtë) i jep fjalës rrënjë një kuptim kolektiv ose abstrakt, prandaj nga një *baga* e gjuhëvet rom. do të kish dalë vetëm kuptimi barrë, ngarkesë, jo kafshë barre. Pos kësaj, neve na del përpara vetvetiu një tjetër afrim: sllav. *bogъ,* në çek. *zboží,* nga *sъbožьje* mall, pasuri, luzac. e posh. sorb. *zbóžo* bagëti, pol. *zboźe,* dikur pasuri, sot drithë, ukr. *zb'íže* drithë, plaçka, tesha, ind. e vj. *bhága-ḥ* m. mall, të mirat, *bhájati* ndan etj. (shih Berneker, E.W. 67).4 Për ilirin blegtor malli, pasuria konsiston në bagëtinë e tij. Nga pikëpamja semantike, përveç fjalëve sllave që u përmëndnë më lart, që duan të thonë pjesërisht mall, pasuri, pjesërisht drithë, pjesërisht bagëti, le të krahasojmë dhe raportin që ekziston midis sllovak. *statek* e çek. *statek*. Këtu kjo fjalë do të thotë mall, pasuri, në sllovak. bagëti. Gjithashtu kemi: çek. *dobytek,* dikur mall, pronë, pare, bagëti, kafshë shtëpiake, shtazë, sot bagëti, gjedh; serbokr. *blago* visar, pare, bagëti, bullg. *blago* mall, pasuri, pronë. Morfologjikisht kësaj fjale i përgjigjet: *ngushtëtí, madhështí, dhuntí, trektí* (Meyer, Alb. St. I. 73), *shprëgëtī* (Bugge, BB 18, 185), pastaj fjala *limontí* të ndejturit pa punë, otium, për *bagëtí* duhet të nisemi nga një bazë mashkullore **bag[as]*, e cila në gjini puqet me ind. evj. *bhága-ḥ* m. mall, lumtëri, sllav. *bogъ* në *u-bogъ, ne-bogъ,* dhe *bogъ* zot (Berneker, l.c.).

Geg. *b a n e b a n e s ë*, ndejë, shtëpi e rrënuar; banoj, botë, dhe, truall, njerëz

Që te Bogdani, Cun. Proph. I. 95, 36 gjejmë pluralin *tè baana* = it. Habitationi (sic). Nga fjalorët këtë emër e ka vetëm Bashkimi f. 33. Foljen e përdor revista Tomori (që del në Elbasan që në mars 1910)

[4] Lidhjen e rom. *baga* me familjen e përmendur të fjalëve indoeur. Më vonë e pranoi dhe Meyer-i, I.F. 6, 116, sado që me qëndrimin për huazimin e fjalës shqipe dhe me kuptimin themelor 'bagëti'.

nr. 13, f. 4 dhe shën. 5; aty gjejmë edhe të tjera dëshmi për përdorimin e kësaj fjale: Elçija i zemrës J. Krishtit (botuar prej kolegjit të jezuitëve në Shkodër) 5, fash. 2, 53, 59. Fjala i përket rrënjës indoeuropiane *bheu̯ā-* (në shq. *bûj* banoj, jap me qira, shkoj natën, ind. e vj. *bhavanam* banesë, shtëpi, got. *bauan* me banue, gjerm. e vj. e lartë *būan* me banue, me lavrue, lit. *búti* me qenë, *bùtas* shtëpi, sll. e vj. kishtare *byti* me qenë, lat. *fui* etj.). Më afër nga të gjitha qëndron ind. e vj. *bhavana-* që ka të njëjtin kuptim. Baza e fjalës shqipe **bhou̯ona.* Pas pasazhit të cituar të Bogdanit kemi të bëjmë me një formë participale të përdorur si një abstrakt, ashtu si p.sh. te *tè daletè* (Bogdani, l.c. I. 95, 33), kurse Bashkimi fjalën e paraqet si subtantiv të thjeshtë. Këtu duhet shënuar që sufiksi *-eno-, -ono-* shërben me të vërtetë edhe në gjuhë të tjera (cf. Brugmann, gr. 2/12, f. 267 vv.) lit. *lẽkanas* mbetur, tepruar, *lėkana* mbeturinë, relike, sll. e vj. kishtare *zabъvenъ* harruar, lit. *dovanà* dhuratë, saks. e vj. *lugina* rrenë, ind. e vj. *hávana-m* të thirrurit. Me shq. *banë* nga **bhou̯onā* mund të krahasonim morfologjikisht nga lëma e shqipes vetë edhe tosk. *zë*-ri, geg. *zâ-ni,* nga **ĝhu̯ono-* sll. e vj. *zvonъ* kumbim, tingull, në qoftë se subtantivin e shqipes e të sllavishtes do ta marrim, me Brugmann-in, Gr. 2/12, 268, si një formacion më *-ono-* dhe do ta afrojmë me sll. e vj. kisht. *zovǫ,* ind. e vj. *havatē.* Veçse këto substantive, në bazë të dëshmisë që na japin të tjerat fjalë të afërme nga gjuhët sllave (f. Kruzhoski, Prace fillog. I, 101; Bloomfield, I. F. 4, 76; Osthoff BB 24, 177 v.), mund t'i ngjitim te një rrënjë më vete *ĝhu̯en-.*

Sikundër që rrënjës **bheu̯ā-*, **bheu̯ē-* me qënë, me u ba, që u trajtua këtu (cf. Hirt, Ablaut 105, Brugmann. Kurze v. Gram. 142, Grundriss 2/12, 398), i përket dhe ind. e vj. *bhū́mi-ḥ* dhe, tokë (Brugmann, gr. I.2, 112, Walde, E.W. 253, 2325), këtu duhet të hyjë edhe fjala *botë* që gjer më sot nuk ka gjetur vëndin që i përket. Baza e saj është **bhu̯ā-tā* ose **bhu̯e-tā.* Kjo fjalë e shqipes na paraqet një substantiv me formant *-tā*, i cili në shqipet si në gjuhët të afërme shërben për të sajuar abstrakta verbale ose cilësie si dhe konkreta që kanë dalë prej tyre: cf. shq. *ndjetë* urrejtje (sh. më poshtë), *latë* sëpatë e vogël, naxhake e vogël (sh. më poshtë te fjala *lapë*), *vathë* (sh. më poshtë), pastaj gr. *ἀήτη* të fryrët, *κοίτη* shtrat, lat. *subsessa* pusi, gjerm. e vj. e lartë *slahta* vrasje, therje, luftë, nga *slahan* me rrahë, me i ra, lit. *jūsta* brez, nga *jūsumi* ngjesh

(brezin), sll. e vj. kisht. *vrъsta* gjëndje, kondita: ind. e vj. *vr̥ttáḥ* (Brugmann, gr. 2/12, 414 vv.). Në shkallën apofonike të rrënjës, *botës* i përgjigjet gr. *φυή* shtat, lat. *amabam* nga **bu̯ām* (Hirt, l.c.). Në këtë mes, për nga ana e vokalizmit, me *botë* mund të krahasohen, si fjalë me trajtë të afërme, pos gr. *ἀήτη* që u përmend më lart, pasivet *ndotem* (sh. më poshtë të *ndejtë*) dhe *vdorem* prishem, humbas: djerr prish, shkatëroj (Meyer E. W. 70). Këto dy trajta pasive na shpien në participe më vokale të zgjedhur *ndotem* posaçërisht të një participi më to. Në pikëpamje semantike etimologjike, përveç ind. vj. *bhū́mi-ḥ* mund të afrojmë për krahasim edhe lat. *fundus* gjerm. e vj. të lartë *bodam*, gjerm. e sotme *Boden* truall, etj. (vëndi i rritjes: rrënja e këtyre fjalëve është **bheu̯ā*, **bhū*, Walde, E.W. 253, 3226). Meyer-i, E.W. 43 *botë*-n e krahason, po me dyshime, me ital. *motta* lym, frëngj. *motte* lym, frgj. *motta* plis dhe zvol, po ky shpjegim, për shkak të *b*-së në ballë të fjalës, që e ka shqipja mbarë, mbetet i dyshimtë.[5]

blozë

Meyer-i, E.W. 40 jep vetëm kuptimin e blozës, kurse Kristoforidhi f. 48 sjell për Përmet dhe kuptimin "pështymë" (gr. e re *φτύσμον*). Këto dy kuptime, që duket sikur janë mjaft larg nga njëri-tjetri, bashkohen fort mirë, po ta afrojmë këtë fjalë me ind. e vj. *maliná-ḥ* i ndyrë, i papastër, i zi, ku ka të gjarë se hyjnë edhe gr. *μέλας* i zi, let. *melns* i zi etj.6 (rrënja *melē* Hirt, Ablaut f. 90). Sa për kuptimin khs. më një anë lat. *suāsum* njollë e zezë mbi një petk, nga *suarssom: sordes* ndërpësi, got. *svarts*, gjerm. e vj. e lartë *svarz,* gjerm. e sotme *schvarz* (Walde, E.W. 585, 2726), më anë tjetër, lat. *saliva* pështymë: gjerm. e vj. e lartë *salp* i mbyllët, i ndyrë, anglos. *salovig* me ngjyrë të ndyrë, rus *solovój* bojë isabel (Walde, E.W. 540 v.,

[5] Edhe Helbig, Elem ital. në gju. shq. f. 88 v. (Jb. d. Inst. f. rum. Spr. 10) si refleksin normal të ital. *m* në ballë të fjalës janë që paraqesin një *b* për ital. *m.* Veçse edhe te këto *b*-ja iniciale e shqipes nuk shpjegohet me mjete thjesht fonetike. Te fjala *bociel, bucel* gllavinë e rrotës, nga it. *mozzello,* sipas Helbigut ka influencuar fjala *bucelë,* nga it. *bozzello.* Shëmbëlli i dytë që sjell Helbig-u: kal. *bështjer* arë, punët e bujkut, nga it. *mestiere* art, zanat, nuk para ta mbush menden nga ana e kuptimit, dhe po ta pranojmë mund të mendojmë që *b*-ja fillestare të jetë shkaktuar nga ndikimi që mund të ketë ushtruar fjala *bashtinë.*

[6] Më shumë për këtë shih më poshtë, te fjala *zi*, ku ka edhe tjetër literaturë.

2672). Pra, nga një kuptim i parë "ndyrësi" dalin të dy kuptimet e fjalës. Duhet shënuar që *pështymë, pështimë* nëpër dialekte do të thotë "blozë" (Meyer, E.W. 336). Në *blozë* duhet ndarë si element sufiksal *-zë*, që e ndeshim dhe në *buzë, gjizë*, pastaj në *njerëz*, *njerëzit,* e së fundi në disa fjalë si *njerëzí, njerëzí.* Ky sufiks ka kryesisht funksion kolektiv, siç na tregon qartë fjala *trizë* gjë trish, (Pedersen, alb. Texte f. 199, Reinhold, Noctes, Antolog. f. 25, 26, nr. 4) dhe mund të afrohet me gjerm. perëndimore *-t̨ia,* nga indoeur. *-d̨ia* (gjerm. e mesme e ulët *gebēnete,* gjerm. e mesme e lartë *gebeinze* eshtra, gjerm. e mesme e lartë *gesteinze, getierze, gevogelze* (Brugmann, Gr. 2/12, 648, 472). Nga kuptimi kolektiv u zhvillua kollaj kuptimi abstrakt. Këtë *-d-* përbrenda shqipes e gjejmë dhe në fjalën *lapër-dh-í* (më poshtë); për lidhjen që kanë *-zë, -zí, -dh-í* midis tyre do të flasin më mirë më poshtë, kur të trajtojmë fjalën *zi.*

b r e s ë radhiqe

Bashkimi f. 50 bie si kuptim të kësaj fjale radice amara, Meyer E.W. 47 Cichoria, radhiqe. Edhe në gr. e re radhiqja (*πικραλίδα*) e ka marrë emrin nga të idhëtit e saj. Kjo fjalë e shqipes është një rrënjë me geg. *brêj*, tosk. *brënj* brej, grindem (kuptimi i fundit pas Kristoforidhi 50) lat. *ferio* i bie, e shpoj, forare shpoj, gjerm e vj. e lartë *baron,* gjerm. e sotme *bohren* etj. (Meyer, E.W. 37, Walde E.W. 217, ^{2}283). "E idhët", pra, është në të vërtetë "që pret, që ther, që shpon, e mprehtë", po ashtu sikundër që sllov. *bridak* i idhët, edhe kjo hyn në të njëjtën rrënjë (Berneker, E.W. 86), e zhvilloi kuptimin që ka sot nga një më i parë "i mprehtë, që pret". Një zhvillim analog të kuptimit ne e gjejmë në gjerm. *bitter* i idhët: *beissen, g*ot. *beitan,* lat. *findere* (Kluge, E.W.7, 56, Walde, E.W. 224 v.), pastaj në gr. *πικρός* therës, i mprehtë, i idhët, ind. e vj. *pi̯šati* gdhënd, pret, laton (Prellwitz, E.W.2, 369; Walde, E.W. 467, 2584). Sufiksi që gjejmë në *bresë* është ai që do të trajtojmë në *gërrusë, gërresë, kmesë, lusë, resë,* ef. Edhe geg. *maise* mbështesë, ledh (Bashkimi 248): geg. *maj* (*mbaj*) (ibidem). Këtu kemi të bëjmë me një sufiks *-ti* të zgjeruar: *t̨ia.*[7] Është e vërtetë që Pedersen-i, K.Z. 36, 308,

[7] Nga gjuhët motra mbase mund të krahasojmë lituan *-czia, -te* (p.sh. *nekoczia* lopatë për të

nuk pranon një zgjerim të tillë, po megjithatë ai nuk përjashton mundësinë e egzistencës së një sufiksi të tillë. Me fjalët që u qeknë këtu sqarohet dhe trajta e sufiksit në huazime latine si *martesë, vlesë, fejesë.* Pedersen-i K.Z. 36, 308 *esë-n* e kish nxjerrë nga lat. *-atio* (*maritatio, velatio*), dhe në Rom. Jahresber. 9, I 212 ai këtë mendim e plotësoi në këtë mënyrë që sipas tij ndodhi një transformim i lat. *-ti̯o* në *-tjā.* Si u trajtua në shqipet lat. *-ti̯o, -ōnis,* këtë na e tregon fjala *arësye* f., *arësen* m., nga lat. *ratio* (Meyer, E.W. 15). Po në qoftë se ka ndodhur një shndrrim i *-ti̯o-*në *-tjā-* dhe kjo gjë do të ketë ndodhur në ato fjalë që ndiheshin si abstrakte, duhej të ekzistonte një model vëndi për këtë gjë. Po një model i tillë kanë qënë fjalët që u përmendë më lart. Megjithatë ka mundësi që trajta si *martesë, kërkesë* të mos rrjedhin drejtpërdrejt nga **maritatio, *circatio,* po të kenë dalë nga foljet përkatëse *martonj, kërkonj*, pas modeleve që u ceknë më lart. khs. sidomos *gërresë,* që ekziston krahas me *gërrusë.*

byk

Kjo grafi, pas Bashkimit 59, Kristoforidhit 53, Jungg-ut 14, Meyer-i E.W. 58 shkruan *byḱ;* po *ḱ*-ja do të jetë sigurisht ndonjë lapsus, meqë Meyer-i vetë në A. St. I, 22 e përmënd këtë fjalë ndër temat që mbarojnë më *k.* Te kjo fjalë kemi të bëjmë me një refleks të rrënjës **bhū-, bheu̯ā* rritem, mbij. Krahaso slloven. *bił* kallm, serbokr. *bîljka* idem, rus. *bylína* bimëzë, fill bar (Berneker, E.W.112). Fjala e shqipes, përkundrejt sufiksit *-l-* të gjuhëvet sllave, paraqet një sufiks *-k-* si dhe fjalët *penk,* dhe *ujkth* bashkë, lërkurë megjithë lesh, dhe sll. *znakъ* shënjë: *znati,* gjerm. e vj. e lartë *luog* shpellë, shtrofkë: lat. *lateo* (Brugmann, Gr. $2/1^2$, 477). Raporti semantik midis *byk* kashtë, hedhe, dhe slloven. *bił* është i njëjtë me raportin që kanë sllav. e vj. kishtare etj. *slama,* rus. *solóma* kashtë etj. dhe lat. *culmus* kallin, gjerm. *Halm* midis tyre (ef. Walde, E.W. /156, ^{2}208).

---

hedhur grurin në lëmë: *nekóti, kapoté* shkop për të luar me top: *kapóti; taikõczia* shkrepsë: *taikoti, nãszczini* shkop për të mbajtur enët e ujit: *nėszti* (Zubatý; I.F. 3, 140, Leskien, Bildung. Nom. 539).

b u r m ë i pjekur fare (për fiq kur janë bërë gati për të tharë)

Shpjegimi i Meyer-it (E.W. 55) që venec. *maduro, mauro* paskësh dhënë së pari **mæuro, *muro,* dhe me shtesë të *-më*-së **murmɛ, burmɛ,* s'ta mbush mënden as nga pikpamja fonetike as nga pikëpamja e formës. Përsa i përket *b*-së iniciale, le të kemi parasysh ç'u tha më lart në lidhje me krahasimin *botë* - ital. *motta.* Fjala *burmë* i përket rrënjës indoeur. **bhreu̯ā* valon, zien, të cilën e gjejmë edhe në lat. *ferveo* ziej, valoj, *defrŭtum*[8] musht i zier, island e vj. anglos. *brođ* lëng mishi, gjerm. e vj. e lartë *briunvan,* gjerm. e sotme *brauen,* irl. *bruith* me zie etj. (Walde, E.W. 168, 219, [2]225, 286; Persson, Wurzelerweit. 126, Fick 3[4], 263) *-ur* u zhvillua nga *ɣ* në pozicion përpara labialit (Pedersen, K.Z. 36 319). Sufiksi është ai që është i zakonshëm në participe (Pekmezi, Gr. f. 194). Khs. dhe më poshtë te fjala *jerm.* Zhvillimi i kuptimit pajtohet plotësisht me atë që ndeshim në tosk. *pjekur,* geg. *pjekun* (i bërë) (në të vërtetë "i pjekur, i zier"), ind. e vj. *pakvá-ḥ* i zier, i pjekur, i bërë (ku hyn edhe gr. *πέπων* i pjekur) i bërë. *brum* m., *brumë* f. është gjini me *burmë,* janë të një rrënje (cf. Meyer, E.W. 49, Walde, E.W. 217, [2]284).

b u z ë gojë buzë e gojës; majë, anë, sqep, dialekt

Meyer-i, i cili në E.W. 57 shënon vetëm kuptimet "buzë, maje, anë" etj., këtë fjalë e afron me lat. *bucca;* baza *bus-zë* me *s* nga *k̂.* Kjo etimologji bie, meqë lat. *bucca* ka *k* velare; prandaj Walde E.W. 74, 2 100 këtë me të drejtë nuk e pranon. Një rrugë për shpjegimin etimologjik të kësaj fjalë na e çel kuptimi gojë që na dëshmon për çamërishte, Pedersen-i, Alb. Texte f. 114; fjala është afëri me lit. *burnà gojë,* arm. *beran*[9] gojë, lat. *forāmen* etj. (cf. Fick 2[4], 168; Bugge, K.Z. 32, f. 4; Persson, ibidem 33, 292). Baza e fjalës shqipe **bɣzɛ,* me *-ɣ-* që u bë *-ur-* pas labialit, ashtu si në *burmë*. *r-ja* shpeshherë bie, përpara spirantesh dhe afrikatash, cf. *qeth*, lit. *kertù* ind. e vj. *kartarī* gërshërë (Meyer, E.W. 221, A. St. 3, 36), *këthenj* nga lat. *convertere* (Meyer,

---

[8] Pas shëmbëllit të G. Meyer-it A. St. 1, 2 dhe të botimeve të tjera albanologjike gjatësitë e latinishtes si rregull i kam shënuar vetëm atëherë kur ato delnin relevante për etimologjinë shqipe. Në këtë punë kisha sidomos vështirësi tipografike.

[9] Arm. *beran* është mirë ta mbajmë veç nga lit. *burnà* etj., dyshohet si huazim nga ‚rrethi gjuhësor jafetik'. Shih tash N. Marr, Bull. Acad. St. Petersbourg, 6 Ser., t. 4, 1910, f. 149.

E.W. 185), *përputh* ndrag, fëlliq (Pedersen, Alb. Texte 117; Hahn, Tekste 141): *pjerth,* krahas me të dhe *përpurth* (Meyer, E.W. 342), geg. *përzâj* i thëras (*zâ-ni,* Meyer, E.W. 483, me formatin *për-);* përveç këtyre edhe *gacë, gjizë, vathë,* të cilat do t'i trajtojmë më poshtë. Përmbi sufiksin *-zë* shih më sipër te *blozë*.[10] Zhvillimi i mëtejshëm i kuptimevet "gojë, buzë, majë, anë" etj. është analog me zhvillimin e kuptimevet që ka pësuar fjala *anë*: anë, skanj, breg (uji), fund, lat. *ōra,* gr. *ὤα* anë, skanj, zgrip: lat. *ōs* gojë, ind. e vj. *ṓṣṭha-ḥ buzë:* lat. *ōs* (Meyer, E.W. 11, Walde, E.W. 438, ^{2}548). Për shtektimin e shqipes *buzë* në gjuhë të tjera khs. Meyer E.W. 57.

d a l l o j shquaj, ndaj

Kjo fjalë mungon te Meyer-i, e ka Kristoforidhi, f. 91. Edhe fjala *padalluarshme = ἄκριτος* e pashquar mirë, fjalë që përdor Dokë Sula, sigurisht si një neologjizëm, në përkthimin e Piros së Plutark-ut; kap. 17 (Tomorri, nr. 9 f. 4 shtylla 1) lidhet me foljen tonë. Kjo fjalë është e afërt me ind. e vj. *dalayati, dālayati,* çan*, dálam* copë, pjesë, gjysmë, lit. *dalìs* pjesë, *dalyjù* ndaj, rus. *dolja* pjesë, fat, lat. *dolo* përpunoj, gdhënd, etj. cf. për këtë familje fjalësh Walde, E.W. 181, 329; Boisacq, Dict. ét. 161; Berneker, E.W. 209).

Geg. *d a n ë,* tosk. *d a r ë*

Bashkimi f. 80 shkruan *daan*, pl. *daana*, Jungg f. 20 *dan,* pl. *dena;* Kristoforidhi në f. 92 shënon për gegërishten *dânë,* pl. *dânëtë,* për toskërishten *darë* pl. *darëtë,* për shkodranishten *denë,* pl. *dënëtë* (kjo e fundit do të jetë një gabim shtypi për *denëtë*, duke u shtypur *ę* për *ε*: cf. fjalorët e tjerë). Kjo fjalë hyn në grupin e fjalëve: nord. e vj. *tǫng,* anglos. *tange,* gjerm. e vj. e lartë *zanga,* gjerm. e re *zange* të gjitha "darë", gr. *δάκνω,* ind. e vj. *dáśati* kafshon (Boisacq, Dict. ét. 163). Format e fjalës shqipe rrjedhin

[10] Puşcariu, Jb. D. Inst. F. Rum. Spr. 11, 48, 49, pa e pasë vendosur si të sigurt këtë kuptim, e mban *buzë* për refleks të një rrënje të ndeshur qysh në rom. e lashtë *bud-*, që me derivimin me *-i̯* do të ketë dhënë në rum. *buză*, arum. *budză*, dhe mbështetet kështu në përhapjen e rrënjës në romanishten. Ndryshe ka provuar t'i sqarojë format romane perëndimore Ascoli, Arch. Gl. 7, 517. Megjithatë në asnjërin prej këtyre sqarimeve fjalët romane perëndimore dhe lindore që tingëllojnë ngjashëm dhe kanë kuptim të afërt nuk bashkohen në një formë bazë. (Cf. Sidomos Puşcariu, l. C. F. 49; G. Meyer, E.W. 57.).

nga **daḱ-nā.* Pra, shënimi i Meyer-it (E.W. 61): "fakt që *a-ja* përpara *r-së* = geg. *n* nuk u ndrua, tregon që përpara *n* ka rënë një tingull" mbetet i drejtë. Trajtimi i grupit *-ḱn-* në formën e toskërishtes është po ai i në *parë* shikuar: ind. vj. *páśyati* sheh, rrënja **paḱ-*: d.m.th. që në vënd të *n*-së që pritej, hyn *r-ja,* duke shkuar pas modelit të trajtave participiale. Këtu duhen vënë në dukje dhe format e gegërishtes. Derisa fjalorët e shkodranishtes së thjeshtë nuk e shënojnë nazalizimin e *a*-së, Kristoforidhi shënon për gegërishten trajtën *dânë.* Kjo nuk do të jetë gjë tjetër veçse një grafi fonetikisht pak më besnike; kështu edhe Pekmezi në gramatikën e tij f. 231 shkruan për gegërishten *ą́n,* kurse Jungg (f. 4) me Meyer-in (f. 11) e shkruajnë këtë fjalë me *a* jonazale.

d e l l

Meyer E.W. 63 krahason lit. *gýsla* dell, sllav. e vj. kishtare *žila* dell, po ai vetë bën ca objeksione kundër këtij shpjegimi: ndryshimi i tingujve në ballë të fjalës (*gh* në lituanishtet e në sllavishtet, *ĝh* në shqipet; etj. dhe Hirt, B B 24, 256), pastaj ndryshimi që ekziston në vokalizëm. Po të njëjtat vështirësi na dalin edhe te shpjegimi që jep Pedersen-i (I. F. 5, 68), i cili e afron me lat. *filum;* ndryshimin e tingujvet në ballë të fjalës e ve në dukje Pedersen-i loc. cit. Kështu që në K.Z. 36, 326 ai vetë hoqi dorë nga shpjegimi i tij i mëparshëm. Këtyre vështirësive që qekmë këtu u shpëtojmë, po ta afrojmë këtë fjalë me gr. *δέω, δίδημι lidh*, ind. e vj. *dyati* lidh, *dāman* – lidhë. Kjo familje fjalësh ka në shqipet edhe një tjetër përfaqësonjës *duai* demet: indoeur. **de-* lidh: cf. Boisacq, Dict. ét. 180; Walde, E.W. 518; G. Meyer, E.W. 76, *dell*, nga *dō-lo-,* emër mjeti me sufiksin *-lo* (cf. dhe më poshtë te fjala *pillë*), pra kuptimi në thelb është "mjet lidhës, lidhë". Sa për sufiksin khs. gjerm. e vj. të lartë *seil,* gjerm. e re *Seil* tërkuzë, sll. kisht. *greblo* lugatë, lopatë, barkë, lat. *caelum* daltë (Brugmann, gr. 2/ 12, 362 vv.). Në pikëpamje të shkallës së apofonisë, *dell* nga **dō-lo* qëndron ndaj *duai* nga **dē-n* po ashtu si lituan *ãp-valkalas* kostum, ndaj sllav. së vj. kishtare *oblěklo,* nga **ob-velklo* veshje, si lit. *àtsailė* dru që lidh dërrasën e parme të qerres me bosht, ndaj lit. *àtseilis* hekuri që shkon nga trari tërthor i qerres te boshti (Brugmann, l.c. 364, 365). Zhvillimi i supozuar i kuptimit "lidhe, dell" është siç e gjejmë me të vërtetë në ind. e vj. *snāyu-ḥ, snāyu* lidhë, dell.

d e r t h, pës. *d e r d h e m* hidhem, lëshohem

Kuptimin e trajtës pasive që sapo cituan këtu e ka Kristoforidhi, Fjalori f. 213 s.v. *lum.* Afrimin e kësaj fjale me sllav. e vj. kishtare *drъzъ* guximtar, siç e gjejmë te Meyer-i (E.W. 64), e hodhi poshtë me të drejtë Pedersen-i në K. Z 36, 32; dhe me të vërtetë ai krahasim nuk ta mbush mënden nga ana e kuptimit. Po Pedersen-i edhe nga një krahasim që kish bërë vetë: me ind. e vj. *sr̥játi* derdh, e lë të rrjedhë (BB 20, 238), është gati (K.Z. 36, 289) të heqë dorë. Kështu që fjala do marrë si e pashpjeguar gjer më sot. Ajo është e afërt me ind. e vj. *dhā́rā* lumë, derdhje, *rreze*, *dhārayú-ḥ* që derdhet, që rrjedh, *dhāryam* ujë11 kuptime këto që pajtohen mirë me kuptimet e fjalës sonë. *-dh-* në *derth, derdhem* është *-d-* ose *-dh-* indoeur. që për ndërtime prezentesh (lit. *vérdu* sll. e vj. kisht. *idǫ, jadǫ* [*-d-* ose *-dh-*]; gr. *ἔλδομαι,* lat. *Cudo,* got. *giutan* [*d*], gr. *πύθω*, *γήθομαι* [*dh*] cf. Brugmann, K.G.V.G. 521). *dh-* e shqipes (δ) ka dalë nga *d(h)* pas *r*-së, siç ndodh zakonisht në këtë gjuhë.

d ē t, sic., kal. *d e i t,* sic. *d e j ë t*

Bugge, B B 18, 165 e lidh këtë fjalë me *dal, dalë lungë,* gr. *θάλλω,* ku pas mendimit të tij hyn edhe *θάλασσα* si "e fryra", dhe si paralele semantike nord e vje. *haf* det: *hefja* me ngritë. Sado që Meyeri, A. Stud. 4, 54, e miraton këtë etimologji të Bugge-s, ajo megjithatë nuk para ecën nga ana e fonetikës. Sepse një interpretim i këtillë presupozon një bazë **delt,* të cilën e kish propozuar vete Meyer-i në E.W. 64. Po të qe kjo trajta e lashtë e fjalës, ajo do të ishte ruajtur me siguri në shqipen e Greqisë: ky dialekt ka *përpjelta* përpjetë, sh. Kullurioti, Ἀλφ 164; Pedersen, K.Z. 33, 548 (të njëjtën trajtë e ka edhe arbërishtja e Siqelisë: Marchiano, Canti pop. alt. (f. 10). Mirëpo në shqipen e Greqisë kësaj fjale nuk i thonë **delt,* po *dēt* si gjetkë (Meyer, A. st. 5, 29). Fakti që në tërë shqipen e Ballkanit, jo vetëm nëpër disa dialekte, të cilat thonë p.sh. *uk* për *ujk* (cf. Pekmezi gr. 278), fjala shqiptohet *det,* vetëm ky

[11] Për sqarimin e mëtejmë lidhur me rrënjën e fjalës së ind. së vjetër khs. Uhlenbeck, Ai. Et. Wörterbuch, f. 135, 136 (ved. *dhávante* rrjedh, lëviz, gr. *θέω* eci, rrjedh).

fakt na çel rrugën për të gjykuar drejt dhe sic. *deit, dejët* (përkth. i ungjillit në dialektin e Piana dei Grecit, Matheu 5, 18). Është e vërtetë se po të nisemi nga një trajtë *delt,* mund të kuptonim trajtën *dejët; ë-ja* atëherë mund të ishte një vokal svarabhakti siç e gjejmë p. sh. në *këjic* kyç (te Rada, krahas me *klyç, qyç,* nga sllav. *ključъ).* Veçse për t'i ujdisur punët në këtë mënyrë duhej të ish siguruar ekzistenca e *l-së* në trajtën *delt:* po shq. e Greqisë na dëshmon të kundërtën. Edhe po të pranojmë një bazë dyrrokëshe që të ishte në lidhje me *dal* të themi një trajtë **dalit,*delit, as* kjo nuk na e zgjidh çështjen, sepse atëherë *l*-ja intervokalike duhej të na paraqitej si një *ll* (velare). Prandaj sic. *dejët,* bashkë me trajtën *det* të shqipes së Ballkanit, na imponon tjetër interpretim të kësaj fjale. Por të sjellim ndër mënd që siç ka treguar Pedersen, Festskrift til Vill. Thomsen, f. 247 v., *j*-ja është tingull që zhduk hiatin, atëherë në këtë fjalë do të pranojmë ekzistencën e një grupi vokalesh, i cili duket qartë që u sajua nga zhdukja e sonores interdentale *dejët,* pra, është forma e pakontrolluar, më e vjetra, dhe nga kjo duhet të nisemi në shpjegimin e fjalës. Përveç kësaj duhet vënë re kjo që *e*-ja nuk është palatalizuar, prandej ka të ngjarë që kjo të ketë dalë nga një diftong. Kjo fjalë lidhet me got. *diups,* gjerm. e vj. e lartë *tiuf;* gjerm. e sotme *tref* i thellë, lit. *dubiis* i thellë.

Si bazë na del: **deub-eto-*, e cila dha rregullisht **deët*, dhe, me një *j* që zhduk hiatin, *dejët,* trajtë që e gjejmë me të vërtetë te arbëreshët e Siqelisë. Në shqipen e gadishullit të Ballkanit *dēt* ka kudo *ē* (cf. përveç Meyer-it, E.W 64, Bogdanin, Cun. proph. 2, 4, 11: *deet*, pastaj Pekmezin Gr. 236; Pedersen, Alb. T.116). Gjatësia e *e*-së i detyrohet, pra, një kontraksioni, po ashtu si p. sh. gjatësia e *u*-së në *kūt* nga lat. *cubitus,* nëpërmjet **kuët.* Kështu deti edhe në shqipet është "i thelli, thellësira", ashtu si edhe anglos. *lagu* det, saks. e vj. *lagu* – liqen, det, lat. *lacus* liqen në themel duan të thonë "të thellët" (Fick 34, 358; Walde, E.W. 318, 2406). Sufiksi është ai që ndeshim në derivate adjektivash të lat., si p.sh. në *libertus,* falisk. *loferta,* nga një trajtë italike bazë **laufero-to* ose *louferto* (Sommer, I.F. 11, 227, Brugmann, Gr. 2/12, 404). Formacione analoge janë abstraktat femërore të cilësisë më *-tā,* siç janë p.sh ind. e vj. *pūrnāta* të plotët, got. *diupiþa* të thellët, lat. *vīta*, nga një **vī- vitā,* sllav. e vj. kisht. *dobrota* miqësi. Dhe me të vërtetë, Bashkimi f. 84 ka dhe formën *dete.* Veçse në këtë mes është

zor të thuhet nëse për shqipen *det* duhet të nisemi nga një mashkullore **deub-eto,* ose nga një femërore **deub-etā:* sepse, siç dihet, mashkullorja dhe femërorja në shqipet rrojnë shpeshherë krahas me njeratjetrën te i njëjti substantiv; cf. p.sh. *brum* m., *brumë.* Krahaso, përveç kësaj, femëroren *degë* me zanoren intervokalike, në vënd të një **deg,* të supozuar (Meyer, A. St. 3 g), si edhe substantivat *labë, shëlligë*, që do t'i trajtojmë më poshtë. Pekmezi, Gr. 236; Jungg 21, 22; Bashkimi 81 na dëshmojnë për gegërishten përveç *det* edhe trajtën *ded. d*-ja këtu u përftua sekundarisht në mbarim të fjalës, sigurisht pas analogjisë së atyre fjalëve, ku alternanca e *t*-së fundore me *d*-në në trup të fjalës kishte arsye etimologjike. Cf. geg. *sod* përbri *sot* (Jungg 142, 143; Bashkimi 402).

djathë, në Greqi edhe *dithë*

Trajtën *dithë* e gjejmë në Greqi në shprehjen *java e(n)dithit* (Meyer, A. St. 5, 72 v.). Kjo fjalë ka të bëjë në radhë të parë me ind. e vj. *dádhi* dhallë e pastaj me ind. e vj. *dhāya-ḥ* që ushqen, që rrit, prus. e vj. *dadan* qumësht, gr. *θήνιον* qumësht *τιθήνη* vajë, dadë, lat. *fēlo* e mënd, i jap qumësht (Walde, E.W. 215, 2. 280 v.). Raporti kuptimor që ekziston midis shqipes *djathë* dhe ind. së vj. *dadhi* dhallë pajtohet shumë mirë me ato që thotë Schrader-i, Reallexikon 409 v., sipas të cilave djathi në kohë të lashta fare s'ka qënë gjë tjetër veçse lac coagulatum, qumësht i thartë, dhallë. Gjuha shqipe ka ruajtur, pra, një kuptim të këtij trajtimi të moçëm të djathit. Edhe morfologjikisht shqipja *djathë* dhe ind. e vj. *dadhi* pajtojnë me njera tjetrën. Sepse, sikundër që kjo e fundit është një formë me reduplikacion: *da-dh-i (*cf. Walde l.c.; Brugmann, Gr. 2/1^2, 174), po ashtu është dhe *djathë,* e cila ka dalë nga **de-dh; djathë* paraqet, pra, vokalin e reduplikacionit *e* (tipi *τέτανος*, Brugmann, Gr. 2/1, 2 129). Në këtë bazë *e*-ja u bë -*ia* si në *mjaltë*: *μέλι, djathtë:* lat. *dexter*, gr. *δεξιός* (Pekmezi, Gr. 22). Trajta *dithë* e shqipes së Greqisë qëndron ndaj *djathë* ashtu si *vit* ndaj *vjet*. (Një tjetër formim me reduplikacion në gjuhën shqipe sh. te fjalët *gogëlë* dhe *popëlë.* Në lidhje me këtë etimologji që u shtrua këtu, një vështirësi fonetike të duket sikur e përbën *th*-ja e trungut të fjalës që paraqitet si refleksi i *d-h*-së së supozuar. Këtu duhet shënuar se për *ë*-

në fundore të *djathë-it,* fjalë që është dhe mashkullore dhe neutre, duhet pranuar që ky tingull u përftua po ashtu sikurse e tregoi Pedersen-i (K.Z. 36, 339) për -*ë*-në e fjalës *ujë*: *ë*-ja në këto fjala erdhi e u ngul për t'i bërë këto baras me neutrat e tjerë. Kështu, pra, *d-h-ja* në **de-dh* u ndodh në fund të fjalës dhe kështu u bë *th.* Dhe që ne duhet të nisemi me të vërtetë nga **de-dh,* këtë na e tregojnë fjalët *asht, elp:* sepse ashtu si *dadhi* lakohet në ind. e vjetër edhe *ásthi* asht, së cilës në shqipet i përgjigjet mashk. *asht* krahas me fem. *ashtë.* Kështu, pra, përsa i përket mbaresës, ind. e vj. *da-dhi* qëndron ndaj këtij **djath* që sypozuam këtu, ose relativisht ndaj *djathë,* ashtu si ind. e vj. *áshti* asht ndaj shq. *asht,* ose relativisht ndaj *ashtë.* Të njëjtin trajtim të mbaresës së **djath* përkundrejt ind. së vj. *dadhi,* e gjejmë dhe në shq. *elp* m. Përkundrejt gr. *ἄλφι* (cf. përmbi të tjera forma të kësaj fjale Pedersen-i, K.Z. 34, 287). Fakti që *djathë* mbeti një emër neutër, kjo sigurisht do të ketë të bëjë me këtë që kjo fjalë është emri i një lënde.

d o r b ë r í́ f. kope, tufë

Meyer-i E.W. 71 mendon se mos vjen nga it. *turba,* mirëpo në këtë rasë nuk shpjegohet as fillimi i fjalës as sufiksi. Këtu kemi të bëjmë me një kompozitë të moçme, që duhet zbërthyer në *dor-bërí. dor-*: gr. *θήρ*, sll. e vj. kisht. *zvěrь,* lit. *žvėris,* lat. *ferus* (Walde, E.W. 29, [2]286), nga **ĝu̯ēr-* me zhdukje të *v*-së pas *dh*-së, *d*-së në shq., ashtu si në *degë* nga **dvaig-*: gjerm. *Zweig* degë, në *derë* nga **d(h)verā,* sll. e vj. kisht. *dvьrь, dvorъ. -bërí:* lit. *buris* tok, grumbull tufë (= *bu-ri-s,* Osthoff, Etym. Parergra I, 9; Brugmann, Gr. 2/1 2, 355), let. *būra* tok, grumbull, shumicë, ind. e vj. *bhū́ri-ḥ* boll, plot (hyjnë te rrënja indoeur. **bheu̯ā* rritem, bëhem). Analiza etimologjike jep si kuptim bazë "grumbull shtazësh, tok shtazësh, tufë". Për sufiksin shih te fjala *zī.*

d o s ë

Kjo fjalë duhet lidhur tek emri indoeuropian i derrit, duke mbështetur në ndrimin fonetik *su.* shq. *d* përpara një vokali të theksuar, ndrim

që konstatoi Pedersen-i, K.Z. 36, 286. Baza është **sụ̄tị̄ā. S*ufiksi është ai që e gjejmë edhe në një tjetër emër shtaze: *bretkosë,* përbri *bretëk* (përmbi këtë fjalë flet Thumb, I. F. 26, 12). Te ky sufiks kemi të bëjmë me një formant *-t-* që ka dalë pikësëpari nga temat vokalike, e që përdoret për të sajuar kolektiva dhe abstrakta dhe kur konglutinohet me *-i* nga *ijā* (sh. më poshtë te fjala *zi*), na del në fjalë si *parësí*: *parë*, *malësí*, geg. *malcī*: *mal.* Khs. lit. *pilnatis* plotësi, të plotët, *pirmatis* principatus. Ashtu, pra, sikundër që gjerm. *Stute* pelë në ballë do të thoshte "një tufë harmëshorësh" dhe pastaj më vonë u bë emri i pelës, kështu edhe *dosa* së pari do të ketë pasur kuptimin "tufë derrash". Për këtë zhvillim të kuptimit në drejtim të një kolektivi khs. edhe gjerm. *Kamerad* shok, *Frauenzimmer* grua (dikur "grari"). *o*-ja në *dosë* shpjegohet nga rasat, ku sufiksi iu ngjit një *ā*-je që gjëndej në ballë të radikalit.[12]

d r e t h, rrënja *d r e d h*

Meyer-i në E.W. 73 këtë fjalë e ka lënë pa shpjeguar. Në Alb. St. 3,1 8 e lidh me gr. *τρέχω* vrapoj, rend, ind. e vj. *dhrájati* fërkon, rrëshqet, nord. e vj. *draga,* anglos. *dragan* tërheq, nduk. Kuptimi bazë, sipas tij, ishte "tërheq, nduk". Mirëpo verbi i ind. së vjetër dhe farefisi i tij nga lëma e gjuhëvet gjermanike, fjalë këto, të cilat pa dyshim janë afëri midis tyre (sh. Fick 3, 210), nuk i përgjigjen dhe aq mirë shqipes *dreth* për nga ana e kuptimit. Verbin e greqishtes për arsye fonetike nuk mund ta afrojmë këtu, sepse ai largohet nga puna e guturalit (gh); sh. Brugmann, Gr. 1 2, 690; Prellwitz, E.W. 467; Feist, E.W. 278. Verbi i shqipes ka të bëjë me këto fjalë: gjerm. e vj. e lartë *drāen* me dredhë, gr. *τόρνος* kompas, torno, *τερω* shpoj, punoj me torno, lat. *tero* fërkoj (Kluge, E.W. 7, 99; Walde, E.W. 624) si një *tre-d(h)* me *d* ose *d-h* që sajon prezente. Ajo *dr*-ja iniciale në vënd të *tr*-së shpjegohet me anën e anticipimit të mënyrës së artikulimit, nga mbarimi i fjalës në fillim të saj. Eshtë i njëjti proces si dhe në sllav. e përbashkët *drozdъ* mullibardhë përkundrejt prus. së vj. *tresde,* lit. *strãzdas,* island. e vj.

[12] Pedersen-i, K.Z. 36, 393 mendon për një afrim të dosës me derr, derk, dirk. Baza sipas tij mund të ishte *dērq*^{u} + vokal palatal. Mirëpo, me këtë shpjegim mbetet e errët lidhja e mëtejshme e këtij grupi.

þrǫstr etj. (Solmsen, K.Z. 37, 579: Berneker, E.W. 227). Të tjera shëmbëlla si këto gjen te Solmsen, loc. cit., dhe E. Schröder, Anz. f. d. Alt. 24, 19. Sa për kuptimin "tjerr, dredh lesh" që e ka fjala *dreth* edhe këtë, khs. gjerm. e vj. të lartë gjerm. e mesme të lartë *drāt,* gjerm. e sotme *Draht* = fill i dredhun. Këtu hyn dhe geg. (shkodr). *mrizë* shpërgaj, pelena (Bashkimi 306). Kjo formë kështu e dëshmuar e ndreq trajtën që jep Rossi i cili e shkruan këtë fjalë me *s: ndrisa* një trajtë që e mori dhe Meyer-i, E.W. 301. Baza është afërsisht **n-dred-zë* (më fort kështu sesa **n-dr̥d-i̯a*). Sa për kuptimin khs. gjerm. *Windel* ndriza: *Winden* për *dreth*, *dridhem,* të cilën Meyer-i, E.W. 73 (por jo në A. St. loc. cit.) e bashkon me *dreth,* ka tjetër burim, dhe këtë do ta trajtojmë gjetiu.

d u k e m

Kuptimi "dukem" gjëndet p.sh. që te Bogdani, Cun. proph. I. 12, 2; kuptimi "dal në dritë, bie në sy" (eluscere) ibidem 70, 3; po në atë vënd 81, 10 *duketė* është përdorur për ital. *si vede* "shihet". Bugge, BB 18, 189 e konsideroi këtë fjalë një huazim nga gr. *δοκεῖ* po këtë Thumb-i I. F. 26 2 e hedh poshtë për arsye fonetike meqë në këtë rasë duhej presupozuar që *o-ja* e gërqishtes të kish dhënë në shqipet *u.* Të gjitha kuptimet që shënuam këtu për këtë fjalë, shpjegohen, po ta afrojmë këtë me lit. *žvãkė* dritë, gr. *διαφάσσειν διαφαίνειν* te Heziku, lat. *fax* pishë (rrënja indoeur. *ĝhu̯ōq^{u}-, ĝhu̯əq^{u}-* Brugmann (Gr. 1^{2}, 312; Walde, E.W. 202, ^{2}265, Osthoff, Arch. Religionswiss. 8, 20). Verbi i shqipes paraqet shkallën zero.

d h u n ë 1. helm, hidhpril, mujshi, punë e keqe, e dëmshme; 2. turp, fyemje; *d e r ë* i idhët

Kuptimet e fjalës *dhunë* që i përmblodhmë në 1. janë sipas Kristoforidhit, Fjalori f. 89; kuptimet nën Nr. 2 i ka Bashkimi, f. 100, dhe ato piqen në themel me ato që ka Meyer-i, E.W. 87: "turp, njollë, shkandull". Veçse kuptimi "mujshi", që ka Kristoforidhi, del edhe nga

shprehja *për dhunḯ* me pahir, me zor, që shënojnë Meyer-i me Jarnik-un. Te Tomorri nr. 8, f. 1 shtylla 3 gjejmë *për dhunë,* me pahir, me zor. Meyer-i ka dhe *dhunonj* shaj; *dhun* i idhët (këtë të fundit pas Rossi-t), veçse ndonjë shpjegim të këtij grupi nuk jep. Kristoforidhi, loc. cit. *dhunë* e shënon si fjalë gege, kurse Meyer-i nuk shprehet mbi këtë se cilit nga të dy kryedialektet i përket ky substantiv, po në këtë mes atyre u ka shpëtuar që fjala *dhunurë,* me kuptimin "çnderuar, turpëruar" gjëndet te de Rada, Raps. 104. Nga kjo dëshmi dhe nga *dhunë* e dialektevet të Greqisë (Meyer, A. St. 5, 75) *n*-ja intervokalike është e siguruar dhe për tosk., prandaj kjo *n* nuk mund të jetë origjinale, po produkt i një asimilimi. Më anë tjetër, kjo fjalë i përgjigjet nga pikëpamja e kuptimit plotësisht ind. së vj. *dū-* vuajtje, helm, hidhërim, *du-nōti* e përpi, e mundon, e djeg, ku hyn edhe gr. *δαίω* ndez (Prellwitz, E.W.2 104; Boisacq, Dict. ét. 163). Pra, si bazë e fjalës së shqipes duhet vendosur një **dus-n-*, qoftë që *dus-* ta bashkojmë nga pikëpamja formale, drejtpërdrejt me ind. e vj. *duṣ-yati* prish, shkatërron, duke e përforcuar kështu nga ana e gjuhës shqipe mendimin e Persson-it (Wurzelereweit. f. 81) që *duṣ-yati* është një zgjerim i *du-nōti, dū,* gr. *δαίω* me anë të *s*-së*,* qoftë që *s*-në që u presupozua në *dus*-n- ta konsiderojmë si mbeturinë të një teme më *-s,* e cila gjëndet në atik. *δανός* i djegshëm, i thatë prej **δαϝεσ-νος* (Schueze, Quaest. ep. 167, n. 5). Edhe *dhuna* e shqipes këtu hyn. Sa për kuptimin "digjet – i idhët", khs. sllav. *gorьkъ* i idhët: *gorěti* me u djegë. Analiza që dhamë këtu për këtë grup fjalësh gjen vërtetimin e saj në tosk. *derë* i idhët, një fjalë që Meyer-i, E.W. 79 e shtie në grupin e *dhunës,* veçse pak si me dyshim. Afëria e rrënjëve të fjalëve *dhunë* dhe *derë* s'ka sesi të mohohet; *n*-ja intervokalike e toskërishtes të shpie te një *n* (pra, pa ndonjë *s* të mëparme), dhe *ë*-në e *derës* e ka nxjerrë vetë Meyer-i nga një *eu.* Për vokalizmin e një baze **deu-no* që supozojmë kështu për fjalën *derë,* prapë na japin paralele afërie gjuhët gjermanike; saks. e vj. *tiono* një e keqe, padrejtësi, armiqësi (le të kemi parasysh edhe sa i afrohet kjo fjalë *dhunës* së shqipes në kuptim), anglos. *tēona* padrejtësi, vuajtje, fyemje, grindje (baza e fjalëvet gjermanike: **teuna,* Fick 34,165).

thep m. shkëmb me majë, *thepis* e bëj me majë

Këtë grup fjalësh nga fjalorët e deritanishëm e ka vetëm Bashkimi (f. 473). Khs. Fishta, Pika voeset (Zara 1909) f. 39, v.5. *Mal mii mal, ky ravës s'thepisme.* Etimologjikisht ky grup afrohet me lat. *cippus* shtyllë me majë e drunjtë ose e gurtë, në fillim "hu, tru", ind. e vj. *śḗpa-ḥ* penis.[13] Mbi përhapjen e këtij grupi fjalësh nëpër gjuhët motra sh. Walde E.W. 121, 2 163; khs. Brugmann, gr. 12, 726, 801. Pra, si bazë na del: **k̂oipo-*. Kështu, pra, fjala e shqipes puthitet me fjalën e indishtes së vjetër edhe në shkallën e vokalit, kurse nga kuptimi i afrohet më fort latinishtja.

thërrás, thërrés, thirr

Meyer-i, E.W. 90 vendos alternativisht një temë *therr* ose *thirr,* po nuk shprehet për burimin e fjalës. Etimologjia e kësaj tregon që e drejtë është pjesa e parë e alternativës: fjala lidhet te baza indoeuropiane **k̂or-* nga e cila rrjedhin rus. *soróka,* çek. *straka* lit. *szárka* let. *sarke* laraskë (Walde, E. W. 143, 2/93). Një trajtë e vjetër, paralele, që fillon me *sṷ* e që e kanë dhe gjuhët sllave (sll. e vj. kisht. *svraka*) edhe kjo ekziston në gjuhën shqipe: *sorrë* (Meyer, E.W. 390, Pedersen, K.Z. 36, 337). Pra, tema prezenciale e verbit *thirr* të shqipes qëndron ndaj *sorrë* ashtu si rus. *soróka* çek. *straka* ndaj sllav. së vj. kishtare *svraka*. Sa për zhvillimin që ka pësuar verbi ynë në kuptim ("me krrokë, me thirrë") khs. gr. *κραζω* thërras: *κρώζω* krrok. Fleksionin origjinal të prezentit e ruan trajta *thirr* që e ka Bashkimi f. 475 (Bashkimi, sipas përdorimit të asaj krahine, e shkruan *thirri,* cf. *rriedhi* f. 381 = deivare, trare l'origine). Khs. edhe imperativin *thirr*; te Pedersen-i, Alb. Texte 13. Këtu do të kemi të bëjmë në themel pa tjetër me një prezent më *-n,* të llojit *marr* (ibidem f. 12). Pra, *rr*-ja ka dalë nga *rn, i*-ja ka dalë nga një *e,* përpara konsonantit të dyfishtë. Meqenëse *n*-ja në fillim qe me vënd vetëm në prezent, shpjegohen edhe format me *r*, si p.sh. e *thirmeja* (te Meyer-i, E.W. 90).

---

[13] Për këtë familje khs. tash edhe vrojtimet e Endzelin-it, K.Z. 44, f. 58, i cili let. *sipsna* 'shkop i fortë', lit. *szipulys* 'copë druri'i krahason me lat. *cippus*, ind. e vj. *śḗpa-ḥ.*

e r r m. *e r r ë* f. *t e r r*, errësirë, *u-e r r* u ngrys

Të tjerat fjalë që hyjnë në këtë grup i ka Meyer-i, E.W. 96. Mashk. *err* që mungon te Meyer-i, na e dëshmon Bashkimi 103. Krahas me *errë, err* ka dhe *terrë* (Meyer, loc. cit), *terr* (Bashkimi 454;) Jungg 156; Pekmezi, Gr. 276). Grafia *tęrr* me *e* hundake që e gjejmë te Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss [2], I, 1049, nuk gjëndet gjëkundi në glosarët gegë në fjalë. Kjo do të thotë se mbetet gjë e dyshimtë ta nxjerrësh fjalën *terr* nga lat. *tenebrae* (kështu Meyer-Lübke, loc. cit. Pekmezi, Gr. 43, shën. 6), dhe mendimi i G. Meyer-it që trajtat me *t* kanë dalë me anë të një *t*-je të ngjitur duket se është me vënd. Tani puna është se si duhet shpjeguar fjala *err* etj. Unë e lidh me gr. *ἔρεβος*, got. *riqis* errëzinë. Baza; **erg*$^{\mu}$-, me ndrim të *rg*$^{\mu}$- në *rr*, ashtu siç u bë *rk*-ja *rr* (p.sh. në fjalën *sorrë*; Pedersen, K.Z. 36, 337). Raportet e ablautit u përgjegjnë atyre që gjejmë në gr. *ὄρφνη* errësirë, terr, nga *org*$^{\mu}$*-sn-* (kështu Hirt, I.F. 12, 226; Scheftelowitz, BB 29, 17), në qoftë se kjo fjalë hyn me të vërtetë këtu. Tjetër shpjegim të fjalës *ὄρφνη* ka së fundi Petersson-i I.F.24; 273.

g a c ë thingjill i ndezur

Kjo fjalë, që ka mbetur pa shpjeguar, i përket grupit indoeur. *g*$^{\mu}$*her- / g*$^{\mu}$*hor* me qenë ngrohtë (që e gjejmë në ind. e vj. *ghṛṇṓti* ndrit, digjet, sllav. e vj. kisht. *gorěti* me u djeg, lit. *gãras* avull, lat. *formus* i ngrohtë etj.) dhe në pikëpamje morfologjike na paraqet një kolektiv që u sajua si një zgjerim i participit më *-t.* Kështu, si bazë do të vendosim një trajtë *g*$^{\mu}$*-hor-t-i̯ā.* Trajtimi i *ti̯-së* është po ai që shohim në *mjalcë* bletë, nga *melitia̯* (Meyer, E.W. 282) si dhe në *gërrucë* krahas me *gërrusë,* që do të trajtojmë më poshtë cf. edhe geg. *malcī* përbri tosk. *malësī. r*-ja në shqipet zhduket shpeshherë para spiranteve dhe afrikateve, shëmbëlla për këtë gjë u dhanë te fjala *buzë.*

g d h e n t latoj (drunin), rrah, geg. *d h e n d, d h ê n n*

Te Meyer-i gjejmë vetëm verbin që shënuam në ballë; *dhend* përkundrazi na e dëshmon Bogdani, Cun. Proph. I, 67, 19: *dhendi shtatë shty-*

lla excidit columnas septem, pastaj Kristoforidhi, f. 87 *dhend* = *gdhend πελεκίζω, λέπω* dhe Jungg-u f. 27 (*dhenn* intagliare, scolpire). Një tjetër vënd ku e gjejmë është Kristoforidhi, Gjaja e malësorëvet, Tomorri, Nr. 11, f. 3, shtylla 1: *dhëndni pushkëtë* "zbrazni pushkët", një përdorim që edhe ky na shpie te një kuptim bazë "gdhend rrah"; khs. *i ra dhjetë dufèqë* i ra dhjetë herë (Pedersen. Alb. Texte 111), përkundrejt shprehjes *ra me grusht* … Meyer-i, i cili njihte vetëm trajtën *gdhënt* – duhet vënë re që Kristoforidhi, Fj. f. 60 shkruan *gdhent,* jo *gdhënt,*[14] këtë fjalë në E.W. 471 e afron me *vgje* pinus halepeusis, nga lat. *abiegnum.* Kundër një interpretimi të tillë flet fakti që ekziston trajta *dhent,* edhe sikur momentin semantik ta lëmë mënjanë *dhent* është e afërt me nord. e vj. *detta* rrëzohem keq, çaj, çel me forcë, *datta* rrah, trokas, këto nga trajtat **dentan dantôn* të gjermanikishtes së parë (Fick 3^4, 200)[15] në *g* shohim po atë prefiks që ka konstatuar dhe Meyer-i, në fjalën *këqyr* sh. E.W. 230 s.v. *qyronj,* dhe që e gjejmë edhe në një radhë fjalësh si *gdhinj, kënaq, knell, kthiell, këeq* e *keq, klirtë,* fjalë që do t'i shohim më poshtë. *g*-ja ka dalë nga një *k,* duke iu asimiluar kjo konsonantit të tingullt që vinte pas. Meyer-i loc. Cit. duket se burimin e këtij prefiksi e sheh në lat. *co.* Po një mendim i tillë nuk mund të vërtetohet me siguri. Përhapja e madhe e këtij prefiksi në shqipet të bën të mendosh që ky të jetë afëri me prefiksin latin.

g d h i n j, geg. *g ë d h î*

Shkodra pas Bashkimit 122 thotë *gdhî.* Kjo vjen nga **ko-di-n̥jo* dhe lidhet me *dihet* gdhihet, e me *ditë*. Trajta e toskërishtes dhe trajta e Shkodrës na paraqesin po atë trajtim të prefiksit *ko-* që konstatuam më sipër te fjala *gdhent.* Pedersen-i vren në K.Z. 33, 546 që kundër një bashkimi të *gdhinj* me *dihet* flet fakti që është zor të mendohet një

[14] *gδent: gδεnt, δεnd* (Kristofriði, Ǵaja e malés., l. c.) si *vent: vεnt.*

[15] Nëse me Blankenstein, I.F. 21, 113; Pedersen, Vrgl. Gr. D. Kelt. Spr. I, 138, 149; Meillet, MSL, 9, 49 në lat. *cum* për shkak të sll. *sъ* vendosim palatalen *k̂,* do të mund të merrej në çdo rast si e vlefshme për huazim të prefiksit në fjalët e diskutuara shqipe. Për këtë të krahasohet për fillimin e lat. *cum* Brugmann, Gr. $2/2^2$, f. 852 dhe për përgjegjësin shqip të sll. *sъ* dhe përcaktimin e fillimit të tij shih edhe *shkel* (f. 78), *shkep* (f. 80) etj. Vëreni po ashtu analizën time të *shkilcë*, *shçīl*, *shçile* Lab = *coagułum* në një prej artikujve që do të dalin në I.F.

sufiks *g,* prandaj ai mendon që *dihet* duhet ndarë mundësisht nga *gdhinj.* Mirëpo tani që u konstatua një prefiks *ko-*, këto dyshime bien. Kristoforidhi në përshkrimin Gjaja e Malësorëvet, Tomorri Nr.10, f. 1, shtylla 2 përdor dhe një substantiv *gëdhim.*

Geg. (Shkodër) *g ë r r u s ë, g ë r r e s ë, k u r r u s ë, k r ū s* lat. (te Arnobius) *g r o s a* gërresa e ergjendarëve

Këto trajta i gjejmë në këto vende: *gërrusë gërresë* te Kristoforidhi 62, 63 *krusë* te Bashkimi 209, *krūs* te Jungg-u 62 e te Meyer-i A. St., 5,87. Në këtë vënd Meyer-i shkodr. *krūs* gërresë, kruese e bashkon me verbin *krus* rrudh, dhe këtë e identifikon me *kërrus* përkul; mirëpo një afrim i këtillë nuk qëndron dot as nga pikëpamja e kuptimevet. Lat. *grosa* e gjejmë te Arnobius-i 6, 14 Walde E.W. 276, ^{2}354 mendon që kjo fjalë të jetë një huazim marrë nga një gjuhë e panjohur[16]. Kur të kemi parasysh që *ū*-ja e Shkodrës del nga një *ō* që *gr-* dhe *kr-* shndrrohen shpeshherë midis tyre në këtë grup fjalësh, që për *gr-* gjejmë edhe *ger-* (Meyer, E.W. 130 s.v. *grinj gërruanj* përbri *kruanj, kruj* (geg.) idem, atëherë identiteti i shkodr. *krusë, gërrusë* me lat. *grosa* na del aq i plotë si në tinguj si në kuptim, sa që pyetja e Waldes se nga i ka shkuar latinishtes kjo fjalë, e ka gjetur përgjegjen vetiut, aq më shumë kur *gërresë*-s vetë E.W. 130 i ka caktuar vendin që i përket përbrënda shqipes. Kështu, pra, fjala që na ka lënë Arnobi na paraqet një nga më të moçmet elemente të leksikut shqiptar, të dokumentuara me shkrim. Tani na del përpara pyetja: emrat që u shënuan në krye të këtij artikulli si qëndrojnë në mes të tyre dhe si ndaj përfaqësuesve të tjerë të këtij grupi? Për t'iu përgjegjur kësaj pyetjeje duhet të marrim në shqyrtim format verbale të shqipes. Këto janë: *gërruanj, kruanj,* geg. *kruj, kruej, gryenj, grienj* hap ugar, *gërryj* (geg.), edhe *gërryej* (Meyer, E.W. loc. cit. Kristoforidhi 163, 179; Bashkimi 208). *ua* në *gërruanj, kruanj* ka dalë nga një *ō; ye, ie* në trajtat e tjera nga një *e.* Prandaj të dy grupet lidhen më së miri në mes të tyre po të pranojmë ablautin e njohur që ka shqipja në verbe l. *e,* 2. *ē*

[16] Kjo është një fjalë e gjuhës vulgare. Një listë të vulgarizuar që përdor Arnobius-i, ku gjendet edhe grosa, e ke te Stange, Beil. Z. Progd. Gvrn. zu Saargemund 1892/93.

që ka dhënë *ō.* Etimologjia na e vërteton një supozim të këtillë: khs., përveç atyre që sjell Meyer-i, E.W. 130, edhe nord. e vj. *krota* gdhend, nga një *grd* – gjerm. *kratzen* kruaj, nga *gradj* – (sh. Fick 3[4], 51, Kluge, E.W.[7] 263 v.). Nga aoristi, ku e kish vëndin e saj *ē-ja* që në shqipet dha *ō,* u sajua rishtas një prezent më *-uanj,* po ashtu siç e ka treguar Pedersen-i, A. Texte f. 152 për verbin *luaj*, që nga pikëpamja formale është analog me këtë *gërruaj;* kurse format më *ie* ruajnë vokalizmin origjinal të prezentit *gërrusë, gërrucë, krūse* dhe lat. *grosa* që na ka lënë Arnobi shkojnë në vokalizmin e aoristit, *gërresë* shkon me vokalizimin e prezentit. Pas këtij modeli ose pas një modeli pak a shumë si ky u sajuan pastaj këto çifte nomina actoris si *këndés* (Përmet), *këndúes* (Mirdita), *knnues* (Shkodra) te Kristoforidhi 151, Jungg-u 58, Bashkimi 196. Sufiksi *-së* që na del prej këndej është po ai që e veçuam te fjala *bresë* (sh. më sipër), pra një rrënjë më *ti-* e zgjeruar. Rrënjë të formuara me *-ti* përdoren edhe në gjuhët sllave si nomina instrumenti: rus. *rukojatь* dorëzë.

g o g ë l ë sferë, top, koklutë

Këtë fjalë, me kuptimin 'sferë, shuk, top' e hasim që te Bogdani, Cun. proph. I 33, 2. Kuptimin "gogël, koklutë" (në bimë) e ka Bashkimi, f. 128. Kjo fjalë lidhet me lat. *galla* gogël[17] ind. e vj. *glāu-ḥ* deng, top, grumbull, gjerm. e vj. e lartë *chliuwa* top, lëmsh (Walde, E.W. 259, 271 v. 2 333, 347, Fick 3[4], 58): rrënja është *gel[ā].* Baza e fjalës së shqipes është **ga(l)-gal-nā. V*endosja e një sufiksi *n* dhe bashkë me të e grupit *-ln-* është e nevojshme këtu: ngaqë *l*-ja intervokalike bëhet *ll,* kurse *lj*-ja te Bogdani dhe në shkodranishten e sotme na paraqitet si *j,* si p.sh *engjije* nom. pl. *ëngjijt* (Bogdani, Cun. Proph. I, 13,5). Kështu, pra, fjala e shqipes në punë të sufiksit piqet me lat. *galla,* e cila vjen nga një **gal-nā*. Sa i takon formimit të saj **ga(l)-gal* është një formë reduplikimi e llojit të sll. kisht. *praporъ* zile, çek. *prápor* flamur, ind. e vj. *gárgara-ḥ* shtjellë (e ujit) (Brugmann, gr. 2/1[2], 127 v.; Vondrák, Vgl. slav. Gr. 1, 497 v.) *l*-ja e rrokjes së parë u

[17] Schuchardt, Zeitschr. f. rom. Phil. 29, 323, 324, nga shkaku i ekzsistencës së kat. *gall* fluskë ujë, për lat. *galla*, si kuptim bazë të ngjashëm vendos kuptimin fluskë ujë e cila sipas tij kish dalë nga një *glgl* onomatopeike, Mirëpo në çështjen e kuptimit bazë dhe të shpjegimit etimologjik të lat. *galla,* fjala e shqipes, e cila është sinonime me atë dhe njëkohësisht është e pavarur nga ajo nga ana e morfologjisë, është një instancë që nuk do lënë mënjanë.

zhduk nga disimilimi. Pra, *g*-ja intervokalike që në të parë duket si e çuditshme që ka mbetur pa rënë, me vëndin ku ka mbetur na jep të kuptojmë që përpara saj ka rënë një konsonant. Veçse likuida edhe në vokalin e rrokjes së parë ka lënë një gjurmë. Grupi *-o(1)* i fjalës shqipe ka dalë nga një *-ál-* me theksim të shtyrë (Stosston) po ashtu si shq. *-or-* nga *-ár-,* në *sorrë*: lituan *szárka,* rus. *soróka* laraskë (Pedersen, en K.Z. 36, 337). Për intonacionin e shtyrë (gestossen) në rrokjen e reduplikuar cf. çek. *prápor* flamur, serbokr. *präporac* zile. Një tjetër formim me reduplikim në shqipet u pa më sipër te fjala *djathë* dhe do ta shohim dhe më poshtë te fjala *popëlë.* Kjo fjalë që trajtuam këtu mungon vërtet te Meyer-i në E.W., por e ka në A. St. 5, 78, e cituar pas Reinhold-it, Noctes pelasg., *Πρόδρομος λεξ.* 64, dhe e ka vetëm në shprehjet *makarundë gogëlë* maccheroni alla napoletana (në specia), *makarundë gogëlëmshë.* Për shpjegimin etimologjik të kësaj fjale Meyer-i shton: "Po të kemi parasysh kuptimin që ka gogë, "njeri i rëndë i ngathët, duarthartë" (E.W. 126), atëherë mund ta lidhim këtu dhe emrin e makaronave napoletane që janë të trasha e të shkurtëra *gogëlëmshë* mund ta marrim si 'lëmsh i rëndë'". Ky shpjegim bie poshtë nga ekzistenca e trajtës *gogëlë* që ka Bogdani, loc. cit. Prandaj fjala nuk ka të bëjë gjë me *gogë* "ofiq i vllehve, i mjeshtërve, njeri duartharë", e cila është një fjalë me gurrë onomatopeike. Fjala *gogëlëmshë* e Reinhold-it duhet zbërthyer jo në *gogë-lëmshë,* po në *gogël-lëmshë,* prandaj na del si një kompozitë që nuk do të thotë "lëmsh i rëndë", po "lëmsh-top".

grundë, krundë, krundef

Meyer-i, E.W. 132 shënon: jemi të tentuar ta krahasojmë këtë fjalë me gjerm. e ulët *grand* krunde gruri, zall, e cila lidhet me anglos. *grindan,* angl. *grind* po ashtu si sllav. e vj. *tricę* krunde me rrënjën *ter-,* fërkonj, veçse vokalizmi paraqet vështirësira. Kjo vështirësi zgjidhet në të vërtetë, po të vendosim një bazë **ghrn̥d-* ku *n̥*-ja (ka të ngjarë nëpërmes të një *-ën-*) dha *-un.* Të njëjtin zhvillim mund ta vërtetojmë në *mund, shtrungë, tunt,* pasivi *tundem.* Veçanërisht mund të krahasojmë dhe lit. *gréndu, grę́sti* fërkoj. Më shumë për këtë grup fjalësh gjen te Walde E.W. 244, ^{2}316; Fick 3^{4}, 340. Sa për gr. *χεράς -άδος* zall, të cilën edhe këtë e kanë afruar me këtë grupim khs. tani Frankel, K.Z. 42, 258 dhe Charpentier, K.Z. 43, 167.

gjellë, të ngrënë, në Kalabri jetë; *gjellís* rroj, banoj, *gjellinj* rroj, banoj

Meyer-i, E.W. 138 këtë grup fjalësh e konsideron të huazuar nga serbokr. *jelo* gjellë. Kundër një shpjegimi të këtillë flasin dy gjëra: l. emrat topikë të Shqipërisë sot, që janë me origjinë sllave, nuk paraqesin ndonjë reflektim të sllav. *j* me një *gj* në shqipet. Në bazë të hartës austriake të përgjithshme të Europës 1: 200.000 po përmëndim këtu: *Jagodina* (fleta Elbasan), *Juranishte* (po atje), *Jalovec* (fleta Prizren), *Jelshani* (fleta Manastir), *Jagodina* (fleta Durrës), *Juga* (fleta Shkodër.) Krahaso edhe disa huazime të sigurta prej sllavishtes, të cilat edhe këto paraqesin një *j* në ballë të fjalës: *jarinë* e pjekur (serbokr. *jarina,* Meyer, E.W. 161), *jarm* parmendë (bullg. *jarem, jarmo,* ibidem), *jugë* (serbokr. *jug,* ibidem 164). 2. fjala *gjellë,* siç po shohim te botimi i një cope nga monumenti më i moçëm i gjuhës shqipe që dimë nga përkthimi i Biblës prej Dom Gjon Buzukut, i vitit 1555 (Tomorri nr. 11, f. 3), ka përbri saj dhe *gjellin* rron, jeton (libri i 3 i mbretënvet 17, 24). Kjo fjalë me një anë s'ka si të ndahet nga *gjallë,* po më anë tjetër nga *gjellë* të ngrënë, kal. jetë nuk mund të shkëputet. Le të krahasojmë p.sh. ital. *vivanda* gjellë *vivere* me jetue (Te Bogdani, Cun. proph. I, 2, 5 shqipes gjellë i përgjigjet në përkthimin italian *vivanda*). Kështu shpjegohet tani dhe *gjellís* rroj, banoj (të dyja këto kuptime në Cun. phroph. II, 3, 7) bashkë me *gjellinj* banoj (këtë kuptim e gjejmë që te Bogdani, nga kuptimi "rroj, jetoj" (te Buzuku, sh. më lart) po ashtu sikurse në rus. *žitь* me jetue, me banue, *žitelь* banor. Një shpjegim kërkon edhe raporti i vokalit të brëndshëm të trajtës *gjallë* ndaj atij të trajtavet *gjellë, gjellinj, gjellis, gjellis.* Në këtë gjë na ndriçon forma e Buzukut *gjellin* rron, jeton që ka dalë rishmë në dritë: këtu kemi përpara nesh një formacion me *-inj* të cilin e gjejmë shpeshherë nëpër dialekte (Pekmezi, Gr. 184) si dhe te Bogdani e te Bardhi cf. *apinj* (Bogdani, Cun. proph. I. 14,14), *thithinj* (Bardhi 24), *bushinj* (Bogdani loc.cit. I, 43, 12), *njehen* (aty I, 26, 36). Si te ky verbi i fundit (cf. Pedersen, K.Z. 36, 339) ashtu dhe te *gjellin* rron, jeton ngjan një umlaut. *gjellë* të ngrëne, jetë është një formë postverbale siç është p.sh. *qartë* grindje: *qërtonj* (Meyer, E.W. 220).

Tosk. *g j e m p,* e shq. *g j e m b i, g j ë m p, g j ë m b i;* geg. *g j e m,* në Greqi *g l i m p,* në Siqeli *g l ë m b ë* f.; *g j e p* (Kavall.), *g l e p* gjirpërë

Këto fjalë që i përkasin sigurisht *një* grupi, Meyer-i, E.W. i ka në dy vise të ndryshme, kurse në E.W. 140 ai fjalët *gjëmp, glimp, glëmbë* i afron me lit. *gémbė* gozhdë e mbërthyer në mur, në f. 138 *glep* gozhdë e krahason – po dhe këtë me dyshime – me verbin *qep.* Asnjëra nga këto dy etimologji nuk mund të qëndrojë: me të drejtë Pedersen-i, K.Z. 36, 334 kundër krahasimit të *gjemb* etj. me lit. *gémbė* ka invokuar faktin që në shqipen e Greqisë trajta e fjalës është *glimp* dhe kjo na shpie në një të moçme *gl-* në ballë të fjalës. Që këtu duhet pranuar një *gl-* si trajtë origjinale, këtë na e vërteton forma *gem* te Kristoforidhi f. 62, e cila është baras me *gjem* dhe kjo (f.79) = *gjemp.* Trajta *gem* është e dialekteve gege të cilat në grupin *gl* e zhdukin palatalizmin e guturalit (Pekmezi, Gr. f. 64). Gjithë ky grup është afëri me lit. *geliù, gélti* shpoj, ther, *įgélti* ngul thumbin, shpoj, *gelonìs* thumb, thimth[18] *gjemp, gjëmp* (të dyja këto grafi janë të toskërishtes pas Pekmezit, Gr. 240) vjen nga një **gle-mo-.* Raporti semantik midis *gjëmp* dhe lit. *geliù* shpoj, ther, sqarohet edhe me denominativin *gjëmbonj* shpoj, thumboj, ther, po gjen një paralele edhe në serbokr. *bódlja*, gjemb, ferrë, *bòdēm* shpoj, thumboj. Mbaresa e trajtavet tosk. *gjemp,* geg. *gjem* duhet vështruar po ashtu sikundër dhe mbaresa në tosk. *trëmp,* geg. *trem* nga (lat. *tremo*): *m*-ja fundore bëhet *mp (mb)* (Pekmezi Gr. 23. Brugmann, Gr. I.^{2} 908). Sufiksi i fjalës së shqipes është po ai që gjejmë në ind. e vj. *ḗma-ḥ* kalim, gr. *οἶμος* kalim, rrugë (ind. e vj. *éti* shkon, ecën, gr. *εἶσι*), gr. *φλογμος* zjarr: *φλέγω*, got. *doms* vendim, gjyq, gjykatë: rrënja **dhē* vë, vendoj, gjerm. e vj. e lartë *strōm,* gjerm. e sotme *Strom* lumë i madh: rrënja **sreu-* rrjedh, gr. *ῥέω* etj. (Brugmann, Gr. 2/1 ^{2}, 246 vv.). Në trajtën *glimp* të shqiptarëve të Greqisë e cila e ka ruajtur konsonatizmin inicial, *i*-ja në trung të fjalës ka dalë nga një *ie.* Sic. *glëmbë* u sajua krahas me **glëmp* të origjinës ashtu si *ashtë* f. "koskë" krahas me *asht* m. si *vjetë* përbri *vit,* si *djathë* përbri **djath* që duhet supozuar në origjinë (sh. më sipër të *djathët*). Po edhe fjala *gjep* gjëmb, ferrë (që kështu e ka Kavalioti,

[18] Lidhja etimologjike e mëtejshme e këtyre fjalëvet të lituanishtes është e diskutuar, cf. Boisacq, Dict. ét. f. 118, Hirt, Abl. f. 87, Fick I ^{4}404; Peterson, I.F. 24, 259.

Meyer, A. St. 4, A) hyn këtu. Sepse trajtën origjinale *gl* të fillimit të fjalës e gjejmë te *glep* "*gjilpërë"* (Hahn, Reise durch d. Geb. d. Drin 158), inkuadrimi i së cilës në këtë grup fjalësh nuk paraqet ndonjë vështirësi. Po nga shkaku i kësaj *gl* fillestare, krahasimi i këtyre fjalëve me verbin *qep*, siç e mendonte Meyer-i, s'ka sesi të qëndrojë. Në sufiks *gjep-i* ndryshon nga gjëmb-i, ajo do të ketë një sufiks, të lashtë më -*bho-* (cf. lit. *dárbas* punë: *daraũ, -ýti;* lit. *garbė̃* nder: *giriù* lëvdoj; *pa-liaubà* të lënët, të mbaruarit (e një pune): *liáuti* lë, pushoj; got. *halba* gjysma, ana: lit. *szalìs* anë (Brugmann, Gr. 2/12, 388 v.), *b(h)* e së cilës,[19] duke u ndodhur në fund të fjalës, dha *p* e pastaj u përgjithësua. Meyer, E.W. 138 supozoi që *gjep* thumb, thimth, të cilën ai atëherë e dinte vetëm prej Thunmann-it f. 9, nuk ishte tjetër veçse një trajtë e shkëmbyer me *gjëmp*. Më pastaj, kur botoi Kavaliotin (A. St. 4) ku *gjep* gjëndet me të vërtetë, ai mendimin e tij të parë e tërhoqi vetë. Te *gjep* masur, kallam i shkurtër e i hollë, mendojmë se duhet nisur nga një kuptim "shkopth me majë, stap" (p.sh. lit. *akstis* stap i vogël me majë, gr. *ὀκτς* majë, thumb d. *Stecken stap, shkop, Stachel* thumb, thimth).

Tosk. *gjërë, gjerë*, geg. *gjânë*

Grafia e trajtës tosk. me *ë* në trung të fjalës gjendet te Hahn-i e te Meyer-i, veçse Kristoforidhi shkruan *gjerë,* kështu te Psalteri, Ps. 104, 25; 119, 45, po ashtu dhe në Fjalor, f. 76. Edhe disa nga shkrimtarët toskë shkruajnë *gjerë,* si p.sh. Eshref Frashëri (Diturija, I, 97),[20] Lumo Skëndo (pseudonim i Midhat Frashërit): Lirija Nr. 78, f. 3. Kjo fjalë është e afërt me got. *Þana-seiþs* më tej, angles. *sīd* i gjatë, i largët, i gjerë, irl. *sith* i gjatë, lat. *serus* i vonë, gjerm. e mesme e lartë. *seine* i plogë (rrënja indoeuropiane **sēi-* vij ngadalë e vonë, shtyhet (një punë); Walde, E.W. 567, 2705, Fick 3^4, 439). Fjala e shqipes rrjedh nga një formë apofonie me zanoren *a*.

[19] Sh. më poshtë të *shkelp.*
[20] Diturija. E pɛrkohɛšme šḱip literale ðe diturake. Sel'anik 1907.

gjizë

Kuptim "qumësht i zënë" është i Shkodrës, sipas Rossit (xhiz) e pas Bashkimit 143. Kjo fjalë ka të bëjë me lat. *serum* hirrë, gr. *ὀρός* hirrë, ind. e vj. *sará-ḥ* i lëngët *r*-ja përpara *z*-së ra po ashtu si në *buzë* (sh. më sipër, ku ka dhe të tjerë shëmbuj për këtë fenomen). Sufiksi është po ai që pamë te *buzë, blozë, s*-ja origjinale indoeuropiane dha *gj* përpara vokalit të theksuar siç ndodh rregullisht në shqipet, *ie* dhe *i* nga shkaku i dy konsonantave që ishin në fillim. Përsa i përket anës materiale vlejnë po ato gjëra që u thanë për *djathë.* Pikërisht kuptimi "qumësht i zënë" që është dëshmuar për *gjizë* na vërteton sa i drejtë është mendimi i Schrader-it i përmëndur dhe më sipër te fjala *djathë,* që në kohët e para mënyra e gatimit të djathit ka qenë primitive fare.

gjollë pllaka ku u vënë kripë dhënvet

Këtë fjalë e përdor Naim Be Frashëri në poemën bukolike Bagëti e Bujqësija (që unë e njoh vetëm nga ribotimi që bën revista Lirija, në Nr. 84, f. 2, shtylla 3). Edhe Kristoforidhi në fjalorin e tij f. 82, e dëshmon këtë fjalë për të folët e Përmetit, gjithashtu e ka edhe Bashkimi f. 143. Kjo fjalë, që gjer tani ka mbetur pa shpjeguar, ka të bëjë me lit. *sůlas* bankë, saks. e vj. *selmo* dërrasë, sll. e vj. kishtare *slěmę* tra, të cilat kanë dalë nga një kuptim bazë "dërrasë" (Walde, E. W. 581, ^{2}722, J. Schmidt, Vokalismus 2,78). Baza e fjalës së shqipes është **sēlā.*

hîdhitë (Bogdani) sh. hithra, në Gr. *hith*, geg. *hîth*, geg. *hidhun, i dhun*, tosk. *hidhurë, hidhëtë, idhëtë, idhënoj, idhëroj*

Me trajtën *hith* që jep Bashkimi f. 160, plotësohet Hahn-i, i cili për formën gege të kësaj fjale na dëshmon edhe ky një nazal, veçse në Stud. II, 147 shënon, vetëm trajtën deminuntive *hîsëll, hîthës* – trajtë që Meyer-i E.W. 152 e ndron me të drejtë në *hîthëll, hîthëth.* Se cila është forma e lashtë, posaçërisht se cila është mbaresa origjinale e fjalës, këtë na e sqaron Bogdani, Cun. Proph. I, 48, 5 me trajtën *hîdhitë*

(shkruar *hijnδitε*) që na jep e që e cituam në krye, një trajtë kjo që u ka shpëtuar leksikografëve gjer më sot. Nga kjo del se *th*-ja në geg. *hîth,* në Greqi *hith* në fillim ka qenë me vënd vetëm në fund të fjalës, dhe që këtej u përgjithësua. Kjo gjë na jep mundësinë ta lidhim këtë fjalë më tej; shkon me ind. e vj. *inddhé* ndez, përflak, gr. *αἴθω* digjem, island. e vj. *eisa* prej një **aidhsā* hi i nxehtë, shpuzë, gjerm. e vj. e lartë *ëssa,* gjerm. e sotme *esse* farkë etj. Walde, E.W. 10, [2]14, Boisacq, Dict. ét. 23).[21] *h*-ja është anorganike, ashtu si në *herdhe,* bole, për *erdhe:* gr. *ὄρχις* (Meyer E.W. 151); dhe me të vërtetë brënda grupit të kësaj fjale të shqipes, grup që do ta trajtojmë që tani, na paraqet edhe trajta pa *h* fillestare. Sa për zhvillimin e kuptimit që ka pësuar *hîth* -i khs. gjerm. *Brenn*nessel hith: *brenne* djeg, digjem. Këtu hyjnë edhe: geg. idhunë, tosk. idhëtë, krahas me to dhe geg. *hidhun,* tosk. *hidhëtë, hidhurë, geg. idhëním, hidhëním,* tosk. *idhërím* të idhëtit, zemërim, zi, inat. Meyer-i E.W. 157 këto fjalë i bashkon me sll. e vj. kisht. *jęza* morbus, slloven. *jeza* inat etj., duke identifikuer -*enz*- të sll. me *idh*- të shqipes, duke admentuar, pra, për fjalën e sllav. një *ĝ* ose *ĝh.* Po kundër kësaj flet natyra e *z*-së në sllav. e vj. kishtare *jęza,* që në monumente glagolitike është *jędza.* Kjo *z* d*z* nuk mund të ketë dalë nga tjetër veçse nga një *g* (Vondrák, Altkirchensl. Gr. 135). Prandaj, kush do të ngulmojë në një afëri të shq. *idhërím* etj. me sll. *jęza,* let. *ígstu, ígt* me pasë helm të përbrëndshëm, me qenë i idhnuem, me maraz, island. e vj. *ekke* helm, hidhërim, duhet të pranojë një alternancë të guturalit palatal më një gutural velar (kështu p.sh. Brugmann, Ber. d. Sächs. ges. 1897, 38 31). Prandaj duket edhe Pedersen-i në K.Z. 36, 326 ka shfaqur mendimin që etimologjinë e vjetër të *idhëtë* mund ta zëvëndësojmë prapseprapë me një tjetër të re e jo më të keqe. Mos të harrojmë edhe që për grupin e *jęza,* let. *ígstu* etj. ka në shqipet një fjalë që i përgjigjet atij edhe në punë të guturalit (sh. më poshtë te fjala *keq*). Kjo të bën edhe më shumë që shq. *idhëtë* etj. ta ndash nga grupi balto-sllav. Përkundrazi afrimi i *idhëtë* etj. me *hith,* gr. *αἴθω* digjem etj. nuk has në ndonjë vështirësi: *dh*-ja e shqipes reflekton një *dh* të indoeur.[22] Sa për zhvillimin e kuptimit

[21] *Gjerm e lartë e vj. essa, gjerm. e lartë e re Esse është më mirë të ndahet nga grupi i diskutuar këtu i gr. αἴθω etj.; cf. Kluge, E.W.[7], 120 dhe literaturën e shënuar atje.*

[22] Në qoftë se pranojmë mendimin e Meyer-it, Alb. St.3, 29,30 rreth reflektimit të indoem. *d* dhe *dh,* e cila *dh* indieuropiane në gjihën shqipe u poq e u bë një me *d*-në; që pra pas një n-je ka dalë në shqipet nga ata tinguj përhera *d* kurrë ndonjëherë *dh,* atëherë në geg. *hith hidhitë* (Bogdani) *dh*-ja ka hyrë nga disa trajta si p.sh *idhun.* (Ky bark fjalësh edhe në

që ka marrë kjo fjalë në shqipet "i idhët", përkundrejt kuptimit që ka në gjuhët motra me shqipen (gr. *αἴθω* digjem, ind. e vj. *indhé* ndez etj.) khs. sll. e vj. kisht. *gorьkъ* i idhët; *gorěti* me djegë. Kuptimi i mëtejmë i grupit shqiptar: "zemërim, zi, inat" mund u zhvillua vetiut nga kuptimi "i idhët djegës". Cf. përveç, *erbittern* me zemrue, dhe çek. *horšiti* me idhnue, me zemrue, me acarue: *hořký* i idhët e sll. e vj. kisht. *gorьkъ,* pastaj edhe pol. *najątrzyć* me zemrue, me idhnue: sll. e vj. kisht. *obętriti* e bëj të marrë zjarr, lit. *aitrùs* i idhët, djegës (në gojë) (Berneker, E.W. 269).

h u r d h ë, geg. hauq, shterrë, moçal, tosk. gropë me ujë

Kuptimet e gegërishtes sipas Bashkimit f. 163, të toskërishtes pas Kristoforidhit 481. Këto kuptime nga ato që jep Meyer-i, E.W. 154, dallohen në këtë që ata fjalorët e mësipërm, që janë përpiluar prej shqiptarësh, nuk njohin ndonjë kuptim "vënd i thellë në një lumë". Përveç kësaj, kjo fjalë na del prej Kristoforidhit, i cili e dëshmon (loc. cit.) për të folët e Beratit; është dhe e toskërishtes, jo vetëm e gegërishtes, siç e shënon Meyer-i. Fjala afrohet me prus. e vj. *wurs* hauz*,* lit*. júrės* det*,* let. *jūr'a* det, avest. *vairi* liqen, ind. e vj. *var(i)* ujë (ind-eur. *[e]u̯ēr* ujë: Walde, E.W. ^{2}860). *h*-ja duhet gjykuar ashtu si në *herdhe, hidhetë, hut* (sh. më poshtë). Për sufiksin cf. *Lapër-dh-í* (sh. më poshtë) dhe ato ç'u thanë te fjala *buzë.*

h u t më kot: *h u t o j* ndaloj, frublloj, *m e u h u t u e, (h) u t u e m*

hut më kot, në të zbrazët, mungon te Meyer-i e te Kristoforidhi, po e ka Bashkimi, f. 163. *me u hutue* e përdor Fishta te Lahuta I. f. 22[23] ("u trubullua, e humbi") si dhe Jungg-u [48], *hutoj* e ka Bashkimi 154 me kuptimin "ndaloj, pengoj", kurse Kristoforidhi 481 e ka për "turbulloj, i merr mënden". Prandaj kuptimet që jep Meyer-i E.W. 155 ("hap gojën rri me gojë hapët, budallallosem") kanë nevojë të plotë-

---

gjuhët indoeuropiane motra me shqipen përmban fjalë me infiks nazal dhe fjalë pa nazal.

[23] Lahuta e malcisë Kangë Popullore. në dy pjesë, të dya anonime dhe pa shënim vendi e viti. autori i këtyre këngëve është Gj. Fishta, frat i Kuvendit francar.? në Shkodër. Fshikulli 2 u shtyp në Zarë.

sohen nga rrënja. Të gjitha këto kuptime që përmëndmë dhe që duket sikur largohen nga njeri-tjetri, pajtohen e bashkohen mirë në mes të tyre. Ne do të nisemi nga *hut,* më kot, më të zbrazët; kjo lidhet me gr. *αὔτως* më të zbrazët, më kot, *αὔσιος* idem, *(Ϝ)ετός* pa shkak, më kot *(Ϝ)ετώσιος* i kotë i padobishëm, got *auþeis,* gjerm. e vj. e lartë *odi* zbrazët, më kot. Fjala shqipe *hut,* piqet plotësisht me gr. *αὔτως, αὔσιος*, në kuptimin dhe bashkë me fjalët që sapo cituam i përket grupit të ind. si vj. *ava,* lat. *au-, vĕ,* prus. *au,* sllav. e vj. *u*-larg (Brugmann, gr. 2/12, 488; Froehde B B 20, 194; Boisacq, Dict. ét. 104 293; Weigand, Deutsch. Wb,2, 3 330; Walde, E.W. 51, ^{2}70). Edhe nga pikëpamja morfologjike *αὔ-τως, αὔσιος* nga *αὔ-τ-ιος* got. etj. *auþeis* (cf. Schulze, K.Z. 40, 414, shën.1) pajtohen me *hut.* Përsa i përket vokalizmit *hut* ndaj këtyre fjalëvet që cituam qëndron në raportin e apofonisë. Në qoftë se got. *us-, uz-,* gjerm. e vj. e lartë etj. *ur-* prej, jashtë, prej diku, nga, hyjnë edhe këto me të vërtetë, siç mendon Brugmann, K. vgl. Gram. 468, 463 me Holthausen-in, I. F. 17, 293, në këtë grup që përfshihet në *au̯e-* (mirëpo sh. dhe W. Lehmann, Das Präfix *uz-* f. 10) atëherë këto do të afroheshin me *hut* për nga ana e vokalizmit. *h*-ja e fillimit të fjalës është anorganike. Rossi shkruan *utuem* (sh. Artikullin më sipër). Kuptimet e mëtejme të këtij grupi dalin vetiut nga kuptimi "kot, zbrazët". Kuptimi "ndaloj, pengoj" del pa ndonjë zor nga ky që thamë. Zhvillimi semantik "zbrazët, *kot,* budalla" (*me u hutue,* (*h*)*utuem, hutoj,* në kuptimet që kanë te Kristoforidhi e te Meyer-i) e gjen paralelen e tij në gjerm. e mesme të lartë *oede,* i pambaruar, i zbrazët, i kotë, budalla, i marrë.

j ē f. lejë

Pedersen-it, Festskrift t. Thomson 253, afrimi i kësaj fjale me lat. *jus* e drejta, ind. e vj. *yō-ḥ* shpëtimi, e mira, siç e pat menduar Meyer-i (E.W. 162, A. St. 3,40), nuk i duket i sigurt, nga shkaku i tingullit nistor (sh. edhe Brugmann, Gr. 12 277). Duhet të themi se s'kemi shënja të sigurta që të dallojmë në shqipet indoeur. *i̯* edhe *j* (*j* gjysmë vokalike dhe *j* spirantike), siç admenton Meyer-i (në shqipet *j, gj*). Duke e afruar këtë fjalë me ind. e vj. *āvi-ḥ* i favorshëm, *ávaḥ* n. kënaqësi, favor, ndihmë, *ávati,* gëzohet e shpie përpara e ndihmon, e mbron, gr. *ἐνηής* dashamirë; i butë, *ἀΐτας* mik, i dashur, got. *awi-liuþ* hir*,* miradije etj.

Walde E.W. 53, 271 v. rrënja indoeuropiane *au̯e-* e dashur, e dua) *j*-ja e ballit të fjalës shpjegohet si zhdukëse e hiatit. Sa për kuptimin krahaso *dashëlë* lejë (Pedersen A. T. 125): *dashurë, desha,* po edhe gjerm. *Erlaubnis, Urlaub* lejë: *lieb* i dashur (Kluge, E.W.[7], 118), gjerm. e mesme e lartë *gunst* = dashuri, mirëdashje, lejë. Baza e fjalës së shqipes: *au̯-i̯a* me apofoni të *a*-së në *e.*

j e r m i tërbuar, marrosur (Bogdani); *h j e r m* idem (Rossi)

Bogdani e përdor këtë fjalë në Cun. proph. I, 35, 11 (= it. frenetico). Meyer-i e citon fjalën në E.W. sipas Rossi-t, po shpjegim etimologjik nuk jep. E afërt me gr. *ὄρωρα* jam i ndezur, *ὄρτο* u ngre në këmbë, lat. *orior* ngrihem, got. *rinnan* me rendë, me vrapue (Walde, E. W. 436, 2547). Balli i fjalës paraqet një *j* që zhduk hiatin, ashtu si *jap* që ka përbri saj *ap* (Pedersen, Festskrift. Thomsen 247), si *jē* leje (sh. më sipër). *m*-ja është po ai sufiks participial që gjejmë edhe në trajtat e shkodranishtes së vjetër *bām, besuem, ngjermuem* (Bogdani, Cun. proph. I, 22, 6), *bīm* lindur (ibid. I. 83, 13), dhe që e pamë dhe më lart, te *burmë.* Ky sufiks e ka burimin aty ku e ka dhe sufiksi në sll. e vj. kisht. *vezomъ, chvalimъ,* lit. *vẽžamas,* ind. e vj. *kṣāmá-ḥ* shkrumbues, bërë shkrumb, *bhīmá-ḥ* i tmerrshëm, lat. *opīmus* ushqyes, pëllor, i majmë, ushqyer mirë, dhe paraqet, pas gjithë gjasave, një variant fonetik të formantit -*meno*- (Brugmann, gr. 2/12, 232; Kurze vgl. Gram. 111), i cili në fillim ka qenë me vënd pas konsonantesh, pas vokalesh të gjata e pas diftongjesh.

k a n d ë (geg.), *k ë n d ë* (tosk.) *ë n d ë*, oreks, andje

Fjalën e gegërishtes e shënon Jungg-u, L. 54 (shkruar *kânne*): Bashkimi 180 (cf. Meyer, A. St. 6, 6, 17), të toskërishtes Meyer, A. St. 5, 85. Meyer-i në këtë vend, pa dyshim me plot të drejtë, e bashkon me *ëndë,* që ka të njëjtin kuptim, dhe mendon që *kënda* mund të ketë dalë nga *ka ënda* ma ka ënda, më pëlqen, duke u shkrirë *ka ënda* në *kënda.* Po kundër një shpjegimi morfologjik të tillë – përbërje me foljen *ka* – duhet të themi që ky është pa analogji në gjuhën shqipe. Pran-

daj na duket me vënd që dhe këtë fjalë ta konsiderojmë një kompozitë, të ngjizur me prefiksin *ko-* që trajtuam te *gdhent* me *gdhinj* dhe do ta shohim dhe më poshtë, në mënyrë që kjo fjalë do t'i përgjigjet edhe morfologjisë gjerm. *Ge-lüste* ëndë, dëshirë (me *ge-* khs. *hust* qejf, shën. i përkth.) aq me fort, kurse Meyer-i, E.W. 5 përmend edhe të tjera fjalë që janë të afërta me *ëndë* etj. e që janë sajuar me prefiks, siç janë *prënj* kënaq*, prēhem* pushoj, kënaqem.

k a n a s ë qyp për vaj

Këtë fjalë e ka Pedersen-i, Alb. Texte 54 (Glosari 139), lidhet drejtpërdrejt me foljen *kap* (cf. gjerm. *Faß* fuçi, *Gefäß* enë: *fassen* nxë; gjerm. *Hafen* shkel: lat. *capio;* lat. *capis, capado* kupë me verhë: *capio*), dhe më tej, jashta shqipes, me lat. *caput-itis,* ind. e vj. **kaput,* në fjalën *kapucchalam* flokët e prapakresë, përçe, island. e vj. *hǫfoð,* got. *hanubiþ*, gjerm. e vj. e lartë *houbit,* gjerm. e sotme *Haupt* krye, kokë (këto tri fjalët e fundit mundet që të kenë dalë me anë të një përzierje me një fjalë me diftong *u* në rrokjen e rrënjës që afrohet me ind. e vj. *ka-kúbh* – majë, kikë: Brugmann, Gr. $2/1^2$ 428, Bartholomae, I. F. 5, 226, Walde, E.W. 96, 2 129, ku ka dhe tjetër literaturë). Që ato fjalët që u përmendnë më sipër, *caput* dhe *hǫfoð,* lidhen me *capio,* këtë e ka treguar Johansson, Beitr. z. gr. Sprache 136. Lat. *capit,* got. *haubiþ,* përkundrejt trajtave *caput,* ind. e vj. **kaput,* të cilat kanë dalë nga një temë e dobët *kaput-*, na shpien pas gjithë gjasave te një temë e fortë **kapu̯ot*, *kapu̯et-,* respektivisht *kaup-u̯et-* (Brugmann, loc. cit.). Nga e njëjta temë ka mbirë *kapasë* e shqipes, e cila rrjedh, pra, nga një **kapu̯ot-i̯a.* Dhe meqenëse *kapasë-n* etimologjikisht nuk mund ta shkëputim nga *kap,* më anë tjetër s'mund ta ndajmë kollaj, morfologjikisht nga lat. *capit-is,* got. *haubiþ* etj. dhe këto të fundit i përkasin grupit të lat. *capio,* nga karakteri indoeur. që ka në vetvete *kapasë* del për rrjedhim që dhe verbi *kap* është fjalë indoeuropiane, autoktone e shqipes dhe nuk është ndonjë huazim nga turq: *kapmak* me kapë, me zanë. Me këtë fiton prapë mendimi i mëparshëm i Meyer-it (BB. 8, 185), kurse në E.W. 174 ai këtë verb të shqipes e konsideron me burim të huaj.

k a p i t e m më zihet fryma, ngulçoj

Kjo fjalë në kuptim të saj i përgjigjet tamam lit. *kūpůju, kūpůti* më zihet fryma, ndaj së cilës qëndron në raport apofonie. Në të njëjtin grup hyjnë, (sh. Wiedemann, I. F. 1, 856) dhe gr. *καπνός* tym, *καπνύω* nxjerr frymë, lat. *vapor* avull, valë, got. *afhvapjan* mbyt, lit. *kvãpas* frymë, erë, erë e mirë, *kvepiù, -ėti* mbaj erë të mirë, *kvėpù, kvẽpti* shpirrë, *kvėpa* fryma e zënë, sll. e vj. kisht. *kypěti* me zie, çek. *kopet* blozë. Si bazë të fjalës së shqipes do të vendosim **k(u̯)ap-.* Sa për zhdukjen e *u̯*-së në këtë grup fjalësh sh. Hirt, Handb. d. gr. Laut- u. Formenl. 1, 5, 144, e së fundi Niedermann, I.F. 26, 46, me shënime bibliografike. Meyer-i, E.W. 176 mendon, po me dyshim, se do të jetë një huazim nga gr. e re *κόπος* mundim. Mirëpo reflektimi i zanores së brëndshme është një instancë kundër kësaj etimologjie (cf. Thumb, I.F. 26, f. 7 e 9). Morfologjikisht ky verb hyn në kategorinë e madhe të verbave në *-ís,* e cila ka përfshirë edhe fjalë autoktone, krahaso p.sh. *svaritem* varem poshtë, krahas me *svarem* (Kristoforidhi, Fjalori 366).

k a r p ë, k a r m ë shkëmb, shkrep, gumë

Këto fjalë i ka Kristoforidhi, Fjalori 144, për Dibër si dhe Bashkimi 182, 183; ato i përkasin rrënjës *(*s*)*kerep* (një zgjerim i rrënjës **sker-*), rrënjë e përhapur fort sidomos në gjuhët gjermanike, po edhe në të tjerat gjuhë indoeuropiane (Fick, 3^4, 456). Cf. sidomos norv. *skarv* shkëmb i gjallë, gjerm. e mesme e lartë *schrove, schrof, schroffe* gumë, shkëmb në det, faqe shkëmbi, *schraf* idem, lit. *kerpù* pres, ind. e vj. *kṛpāṇa-ḥ* shpatë. Ndërsa këto fjalë gjermanike në kuptim i përgjigjen fjalës së shqipes plotësisht për raportin semantik midis lit. *kerpù* prej dhe shq. *karpë* shkëmb khs. lat. *seco* prej: *saxum* shkëmb (Walde, E.W. 548 = 2 681). Trajta *karmë* nga pikëpamja morfologjike ka dalë nga **karp-n* me *m* nga *-pn-,* në qoftë vërtet se ajo trajtë që na jep Kristoforidhi do të jetë e drejtë. Bashkimi përbri *karmë* shkruan *karrmë.*

Edhe *shkrep, krep* 1. shkëmb, shkrep (ky kuptim sipas Bashkimit 486), 2. shpat (pas Meyer-it e Kristoforidhit), *zgrip* anë, buzë, duhet t'i

radhitim këtu. *shkrep, zgrip* përmbajnë një *ç* që ka dalë nga *dis.* Meyer-i E.W. 205 këto fjalë i afron me ital. *grappo* shkëmb i dalë dhe ky interpretim në themel nuk është i papajtueshëm me këtë që dhamë ne – këtu duhet lënë mënjanë çdo bashkim i kësaj fjale të italishtes, e cila në gjuhët romane nuk është fjalë vëndi me gjerm. e vj. të lartë *klëp* gumë – vetëm se nuk merr parasysh tingullin nistor në *shkrep* e në *zgrip.* Nga pikëpamja e kuptimit *zgrip* anë, buzë, ndaj grupit që trajtuam këtu e që ka përgjithësisht kuptimin "pres" (lit. *kerpù*) qëndron si rus. *rubь* buzë, anë: *rubítь* me ça, me pre.

këeq, keiq, keq

Meyer-i, A. St. 5, 85 e tërhoqi interpretimin e tij të mëparshëm (E.W. 184. gr. *κακός*) dhe e zëvëndësoi me një tjetër. Sipas mendimit të tij të fundit fjala ardhka nga lat. *cadūcus,* duke marrë për bazë trajtën *keiq.* Pedersen-i, K.Z. 36, 327 me të drejtë shprehet edhe kundër këtij shpjegimi, i cili del i pamundur për shkak të vokalit. Sepse, për të arritur te forma *këeq* që ka Kavalioti (Meyer, A. St. 4, 59), duhej të niseshim nga një lat. *cadōcus;* mirëpo për një formë të tillë nuk kemi asnjë gjurmë. Në të vërtetë për këtë fjalë të shqipes do të marrim për bazë trajtën *kééq,* sepse, siç do të dëftojmë që tani, nga kjo trajtë arrihet vetiut te *keiq, keq*, po përkundrazi nga *keiq* s'mbërrijmë dot te *kééq.* Po ta zbërthejmë fjalën në *kë-eq,* te *kë*-ja kemi prefiksin që trajtuam disa herë këtu (lat. *co-, com-*); *-eq* afrohet me let. *ígnis* i thartë, i keq gërnjar, *ígstu, ídfu, ígt* kam një dhëmbje përmbrënda, kam maraz, sll. e vj. kishtare *jędza* sëmunde (*dz* nga një *g*), slloven. *jeza* inat, pol. *jędza* harpi, grua e keqe, lat. *aeger* pa qejf, i sëmurë, mundet dhe nord. e vj. *ekki* helm, hidhërim, brengë (Walde, E.W. 10 v., 214 v. Berneker, E.W. 268 v.); Zupitza, Guttur 161; Fortunatov, Arch. f. sl. Ph. 11, 573). Nga kuptimet e fjalëvet të këtij grupi, siç i radhitmë këtu, ne i kuptojmë mirëfilli edhe kuptimet e tjera të fjalës së shqipes, siç shënohen në vise të ndryshme (p.sh. Hahn, A. St. 2, 44: e fortë për uthull; i egër, për qen, cf. leton *ígnis* i thartë, i keq, pastaj Pedersen, Alb. T. 139: *bënem keq* sëmurem; bëhem liksht: cf. lat. *aeger*). Sa për kompozimin e një adjektivi me prefiksin *kë-* khs. nga shqipja vetë fjalën *kthiell* që do ta trajtojmë më poshtë, pastaj dhe lat. *concavus, compos, con-*

cinnus, gjerm. *getreu* besnik, *gesund* i shëndoshë i shëndetshëm, *gerecht* i drejtë. Si bazë të pjesës radikale do të pranojmë një -*aigio*-; *q*-ja u përftua në fund të fjalës dhe që këndej u përgjithësua. Nga *këéq* dolli **këíq* geg. (Bardhi) *keiq,* duke pësuar *e*-ja influencën e *q*-së që vinte pas ashtu siç e shohim në pluralin *shtigje: shtek, brigje: brek* (Pekmezi, Gr. f. 57, 90, 285). Pastaj nga *këéq* dolli *keq,* po ashtu siç dolli *pyll* nga **pëyll,* nga lat. **padūlem,* për *palūdem* (këtë shpjegim e gjejmë që te Miklosich-i, Die rom. E1. i. Alb. f. 46) ose më poshtë e diskutuara *zī* nga **zɛ́ī.* Fakti që format enklitike të përemrit *më+e* dha *ma* (Pekmezi, Gr. 132) nuk përbën ndonjë instancë kundër këtij interpretimi të *keq: d*o të kemi parasysh që te *më+e* kemi të bëjmë me silaba enklitike, pra, atone, kurse te *keq, pull, zī* e dyta nga silbat që do të kontrahoheshin është e theksuar.

k ë n a q

Shkon me lit. *pranókti* me zanë, me ia mbërijtë, let. *nāku, nākt* me ardhë. *kë-* në *kënaq* është si prefiksi që trajtuam disa herë. Sipas kësaj analize ky verb në pikëpamje kuptimore na del si "ia mbërij, mjaftoj, mblidhem", kuptime këto që të shpien kollaj te përdorimet e tanishme të verbit: cf. lat. *convenire* mblidhem, pastaj: i përshtatem, e kënaq, gjerm. e vj. e lartë *biquāi i* përshtatshëm, i aftë, gjerm. e sotme *bequem* i rahatshëm, *gecwēme* i përshtatshëm, i lezetshëm: got. *qiman,* gjerm. e sotme *kommen* me ardhë (Kluge, E.W. 7, 48; Fick 34, 61), pastaj gjerm. *hinreichend, zureichend* = *genügend* mjaft, i mjaftueshëm. Për zhvillimin e kuptimit "dëfrej, kënaq" nga kuptimi *bazë* që vendosëm këtu khs. gjerm. *Vergüngen* dëfrim, qejf.: *genügen* me mjaftue, gjerm. e mesme e lartë *vergenügen* me kënaqë (gjerm. e vj. e lartë *ginuog* got. *gabōhs* mjaft të afërme më tej me ind. e vj. *aśnóti* e arrin, e merr, lat. *nanciscor,* Brugmann, Kl. vgl. Gr. 148; Walde, E.W. 2, 506).

k e m, q e m timjamë, *k ë n j e m, g n e m* idem

kem është trajta thjesht shkodr., të cilën na e dëshmoi Jungg-u, f. 56, Bashkimi, f. 189. Meyer-i, E.W. 222 ka geg. *qem* (cf. Kristoforidhi,

f. 184) dhe këtë e afron, po me dyshim, me sll. (rus etj.) *čadъ* tym, si **ked-mo.* Meqenëse rrënja indoeur. **qu̯ēp-* (gr. *καπνός*, lat. *vapor*, lit. *kvepiù* mban në të mirë) është e përfaqësuar në gjuhën shqipe, dua të them me fjalën *kapitem* (sh. më lart), kurse një rrënjë **ked-* do të ishte e izoluar, prandaj do të jetë më e drejtë që edhe *kem, qem* ta lidhim me atë bazë. Trajta bazë **k(u̯)ep-no.* Kjo ka të mirën që kjo trajtë bazë puthitet me gr. *καπνός* dhe në punë të sufiksit. *pn* dha *m* si në *gjumë: ὕπνός.* Në pikëpamje semantike vështërësi nuk ka. Për shkallën e apofonisë khs. sidomos lit. *kvepiù* mbaj erë mirë. Trajtimi i ballit të fjalës *k(u̯)* është ai që pamë më sipër te *kapitem.* Shkodr. *kem* qëndron ndaj *qem*-it të viseve të tjera si shkodr. *dhet* ndaj së përgjithshmes *dhjetë.*

Meyer-i në E.W. 222 te fjala *cem* ka dhe *gnem* tus që sjell Bardhi f. 178, veçse përmbi raportin fonetik të kësaj forme ndaj *qem* nuk shprehet. Në këtë mes duhet thënë që Kristoforidhi në Fjalorin e tij f. 184 na dëshmon për Berat trajtën *kënjem.* Eshtë e qartë që kjo fjalë e toskërishtes është identike me geg. *gnem* që ka Bardhi. *g* ka dalë nga një *k* në ballë të fjalës, siç ndodh rregullisht; dhe *ë*-ja në silabë atone bie shpesh herë. Po kjo do të thotë që përkundrazi duhet zbërthyer në *kë-njem,* ku *kë-* është ai prefiksi që kemi përmendur sa herë. *-njem* e së folmes së Beratit qëndron ndaj *-nem*-it të Bardhit ashtu siç qëndron *qem* ndaj *kem,* si *dhet* ndaj *dhjetë.* Etimologjikisht kjo *-nem, -njem* s'është gjë tjetër veçse refleksi shqiptar i gr. *ὄνεμος* (me zhdukje të vokalit inicial, siç e gjejmë shumë herë në shqipet; *tetë: ὀκτώ, ndēr* nga lat. *honōrem, ngushtë* nga lat. *angustus*, Pekmezi, Gr. 51). Për përhapjen e mëtejme të këtij grupi në gjuhën shqipe sh. Meyer, E.W. f. 5 (*âj*) *dhe* këtu më lart te fjala *kandë, këndë.* Nga ana e kuptimit krahaso sidomos sll. *vonja* erë, erë e mirë.

k t h i e l l adj. i pastër; *k t h i e l l, k ë t h i e l l,* geg. *k t h i e l l e* sqaroj; thjeshtë

Morfologjia e këtyne fjalëve del e qartë kur të marrim e të krahasojmë një anë *kthiell* me *thjeshtë,* më anë tjetër *kthiell* dhe sic. *fjeγε* i kthiellët, *fjeγonem* te Skiroi (= *kthiellοj* shpjegoj te Bashkimi). Shohim, pra, që te *kthiell* përbri *fjeγë* në atë *k*-në kemi prefeksin që dimë dhe në këtë mes

duhet shënuar që Kristoforidhi, Fjalori 149 *këthiell* e jep si formë të toskërishtes. Më anë tjetër, nga një krahasim i trajtës *kthiell* me *thjeshtë* na del që në -*thiell* duhet të veçojmë një -*ll* sufiksale. Në këtë mënyrë ne arrijmë te një rrënjë **the*-, e cila është refleksi i rrënjes indoeuropiane *(s)kē̯i-,* pra, afrohet me sllav. *sinǫti* me shkëlqye dhe si duket edhe me got. *shkeinan* me u dukë, ind. e vj. *chāyā* shkëlqim, dritë e fortë (sh. Pedersen, K.Z. 36, 318; Hirt, BB 24, 263, PBB 23, 353, Walde, E.W. 80, 2107, Fick. 34 462; Feist, E.W. 237). Verbi *kthiell* ka dalë nga një adjektiv *kthiell* që e ruajnë Budi me Bogdanin dhe e shënon edhe Bashkimi; ky adjektiv përmban një formant indoeur. -*lo*- (cf. sll. *teplъ* i ngrohtë *gnilъ* i kalbur, lit. *putlùs,* frymë, i ajtur, gjerm. e vj. e lartë *steigal* rëpjetë, Brugmannn, Gr. 2/1^2, 362). Ky adjektiv është i gjallë edhe në trajtën *fjeγε* të Siqelisë, sic. *γ* vjen nga *ll.* Sa për kompozimin e një adjektivi me -*kë* sh. ato që u thanë më lart te fjala *këéc.* Ky formacion denominativ i shqipes që po shohim këtu, formacion që është sajuar pa ndihmën e një derivacioni me -*i̯o,* është po ai që ndeshim në *zgjat, ngjat* (: *i gjatë*), *çmall* i nxjerr mallin (: *mall*), *zbarth* (: *i bardhë*), *stërvít* (: *vjet*), sh. Pekmezi Gr. 227. *thjeshtë* përmban sufiksin *sto-.* Khs. *vjesht e parë* shtator: *vjel,* Meyer, E.W. 475). Nga ana e kuptimit *thjeshtë* qëndron ndaj *kthiell* dhe ndaj rrënjës *sk̂ē̯i-* si sllav. *čistъ* i pastër, i krelluar ndaj lit. *skáistas, skaistùs* i ndritur, i rrënjyem dhe rrënjës sinonime *sqē̯i-* (Pedersen, I. F. 5, 73, Ark. f. Nord. fil. 20. 283; Walde, E. W. 97, 2 107; Berneker, E.W. 158, 122). Ndërsa Meyer-i këto fjalë në E. W. nuk i shpjegon etimologjikisht. Bugge jep një interpretim të fjalës *kthiell* në B.B. 18, 191, shpjegim që ai vetë e cilëson një "tentativë të guximshme". Verbi sipas Bugge-s u sajua pak a shumë në shprehjen (*boreanus*) *convertit *diellan,* e cila në shqipet dha në fillim *kërth diell;* kjo u shkri e dha *këthiell, kthiell* dhe më vonë u përdor bashkë me një objekt. Po këtu mjafton ekzistenca e formës *thjeshtë* për të vërtetuar që s'kemi të bëjmë me huazim.

k l i r t ë luginë

Meyer-i E.W. 192 e shënon këtë fjalë, po shpjegim nuk jep; në A. St. 4 që u botuan më vonë (lista e fjalëvet të Kavaliotit) në f. 76 fjalën e quan të paqartë. Një rrugë shpjegimi na del, po të kemi parasysh që lista e fjalëve të Kavaliotit i përket një dialekti i cili grupin me një gutural + *l* nuk e

ruan; cf. *gjuhë* (A. St. 4, 37) *klyç,* Kristoforidhi f. 159), sll. *ključ.* Prandaj kemi të drejtë të themi që grupi *kl-* në *klirtë* nuk është origjinal, që, pra, midis *k*-së e *l*-së ka rënë një vokal. Kështu, pra, *klirtë* mund ta marrim si *kë+li-r-të* me prefiks *kë-* që e pamë shpeshherë këtu, dhe me *-të* që është ai sufiksi i shqipes, për të cilin flet Meyer-i në A. St. 2, 76 v. (lik = *liktë*, *afër-të: afër),* dhe që u ngjitet mbiemrave. Kështu ne arrijmë në një *-lir-*. Kjo afrohet me let. *leĩja* luginë, e cila së bashku me lat. *lituus* shkopi i përdredhur i angurëvet, briri i kthyer i kushtrimit, got. *liþus,* gjerm. e vj. e lartë etj. *lid* mis, gjymtyrët na shpien te një rrënjë *lei* – lakoj, përkul (Walde, E.W. 425, 345 ^{2}437, 533, Fick 34, 365; Persson, Wurzelerw. 187; Johansson, I. F. 19, 120 shën); shq. *-lir-* është trajtuar nga kjo rrënjë me anë të sufiksit *-ro*, ashtu si dhe gr. *πικρός* i mprehtë, i idhët (në të vërtetë "që të ther, të shpon"), sllav. e vj. kisht. *pьstrъ* i larmë; rrënja *peiK̂-* shpoj, ther, qendis; gjerm. e vj. e lartë *muntar* i gjallë, i freskët, i zellshëm, i shkathët, sll. e vj. kisht. *mǫdrъ*: got. *mundon* vë re, gr. *μανθεῖν* me mësue (Brugmann, Gr. 2/12 349), sll. e vj. kisht. *bъdrъ* vigjilent: *bъděti* rri zgjuar (ibidem, Berneker, E.W. 105 vv.). Raporti semantik që ekziston midis shq. *k-lir-të* luginë, let. *llija* luginë dhe rrënjës *lei-* lakoj, përkul është po ai që gjejmë dhe në lit. *lankà* luginë livadh, përkundrejt verbit *leñkti* me përkulë, me lakue, në lat. *vallis* luginë përkundrejt rrënjës *u̯al-* me përkulë, me lakue (khs. island. e vj. *valr* rrumbullak, lit. *apvalùs* rrumbullak, Walde, E.W. 647), në gr. *ἄγκος* luginë : *ἀγκυλος* i përkulur, i shtrembër, ind. e vj. *añcati* përkul, lakon (Boisacq, Dict. ét. f. 7; Prellwitz, E.W. 2, 4, Walde, E.W. 29, 240).

k m e s ë, k ë m é s, k a m é s f. kizë

Kjo fjalë, që Meyer-i, E.W. 193 e la pa shpjeguar, lidhet me shq. *kep* çaj, gdhend gurë (Meyer, E.W. 185; për kuptimin sh. dhe Kristoforidhi 152), lit. *kapóti,* let. *kapát* me shatue, me prashitë, lit. *kaplỹs* shatë, sll. e vj. kisht. *kopati* me gërmue, me mihë, me shatue, gr. *σκάπτω* nuk, gërmoj, *σκαπάνη* kazmë varresh, shatë (Solmsen, Beiträge z. gr. Wortforsch. I, 196 v.; Prellwitz, E.W.^{2}, 236; Walde, E. W. 94 v. ^{2}127, 684). Baza e fjalës shq.: **kapneṭi̯ā* ose **kopneṭi̯ā* ku *pn* dha *m,* ashtu si në *gjumë* nga *supnos*: gr. *ὕπνος*. Sufiksi është ai që gjejmë më sipër te *gëresë, bresë,* pastaj te *çëllésë* shtypës, tundës. **kopneṭi̯ā* na del si një in-

formacion i sajuar nga temat e prezentit, sikundër edhe *gëresë* është formuar nga tema e prezentit. Tema e prezentit që ka shërbyer si bazë është një prezent nazal, ashtu siç na e dëshmojnë edhe gjuhët e tjera motra me shqipen (cf. çek. *kopnouti). -ne* te **kapneţiā, kopneţiā* ka dalë nga një *-neu-* (tipi i ind. së vj. *stiŗnṓ-ti, tanṓ-ti*). Kështu, pra, fleksioni indoeur. *-neú- -nu-* duket se në gjuhën shqipe është uniformuar.

k n e l l e m çelem, ngjallem, përtërihem

Grafinë dhe kuptimin e kësaj fjale i japim pas Piskos, Handbuch d. nordalb. Spr. f. 77. Fjala duhet marrë si *k-nell* dhe lidhet me got. *Ganisan* me u shëndoshë, me shpëtue, me u lumnue, gjerm. e vj. e lartë etj. *ginesan* me shpëtue, me u ngjallë, gr. *vóστος* kthimi në atdhe, ind. e vj. *nā́satjāu* mjekë hyjnorë (Weigand, D.W.[5] 1, 679, Prellwitz, E.W.[2], 310). *-nell* rrjedh nga një **nes-l,* me ndrim të *sl* -së në *ll* siç e gjejmë në *kollë:* sll. e vj. kisht. *kašlь* (Meyer E.W. 185). Edhe ky verb u sajua nga një adjektiv i pajisun me formantin *-lo,* ashtu si *kthiell* që pamë më lart. Për të shënuar është edhe fakti që *k*-ja si këtu si dhe në *kënaq, kthiell,* ka shërbyer për të formuar perfektivin, krejt ashtu si lat. *cum* dhe *ga*-ja e gjuhëvet gjerm. Bashkimi 196 jep si kuptim divenire vivo e splendente, rischiararsi dhe ky përkon mjaft mirë me atë që sjell Pisko: sepse kuptimi bëhem i shkëlqyer, i ndritun ka dalë nga një përdorim ekspresiv për zjarrin ose për diellin, pak a shumë si fjala norvegjeze, që është edhe njëkohësisht me këtë fjalën e shq. *-nøre* ndez, çel zjarrë, sued. Dialektore *nöra* idem, kurse island. e vj. *nøra* do të thotë freskoj, ushqej (Meringer, Wörter u. Sachen I, 168 v.). Krahaso për nga ana e kuptimit dhe island. e vj. *kveykva, kveikja* ndez zjarrë, në të vërtetë e ngjallë, e cila është një me got. *qius* i gjallë, gjerm. e vj. e lartë *quëc* i gjallë, gjerm. e sotme *keck* guximtar, i pafytyrë (Kluge, E.W. [7]236). Për kuptimin bazë të rrënjës *nes-* sh. Meringer, loc. cit. Shq., pra, paraqet këtu një zhvillim që është paralel me atë të gjuhëvet gjerm. e të ind. së vjetër. Grafia që përdor Bashkimi: *knnell,* me *nn,* bazohet në konsiderata etimologjike; në shqiptimin shkodran, të cilin e gjejmë te Bashkimi, *nn* dhe *n* në këtë pozicion nuk dallohen (prandaj p.sh. *knim* te Pisko, loc. cit. f. 70, përkundrejt *knnim* te Bashkimi 196, *me shnosh* te Pisko 71, te Bashkimi 430 *shnnosh.*

k r e m e (geg.), *k r e m t e* (tosk) ditë feste

Meyer-i, E.W. 205 si formë të tosk. ka *krëmtë,* po dy autorë shqiptarë, Pekmezi, Gr. 252 e Kristoforidhi, Fj. 176, na dëshmojnë për tosk. që të dy trajtën *kremte.* Trajtën *kreme* e gjejmë për geg. te Jungg-u, Fjal. 60 e te Pekmezi, loc. cit. kurse kremte që e ka Meyer-i për geg. e ndeshim dhe te Bashkimi, f. 206, shkruan *kremte.* Meyer-i e lë pa shpjeguar. Bugge, BB 18, 168 mendon për një afëri me gjerm. e vj. të lartë *hirmen* me u prehë, me pushue. Mirëpo kundër këtij shpjegimi nga pikëpamja objektive duhet shënuar që ideja e ditës së kremte si një ditë pushimi është ide hebreo-kristiane. Prandaj le të na lejohet të propozojmë një tjetër afrim: saks. e vj. *hrōm.,* gjerm. e vj. e lartë *hruom,* gjerm. e sotme *Ruhm*[24] zulmë, glorie, island. vj. *herma* me lajmue, me kumtue, ind. e vj. *kīrtí-ḥ* të përmendur, zulmë, kumt, lajm, *car-karti* përmend, mburr, lëvdoj, gr. *κήρυξ* kasnec (sh. Osthoff, Etym. Parerga 35, Walde, E.W. 99, 2 132; Feist, E.W. 145). Si bazë e fjalës së shqipes na del **krō-m,* e cila përkon në sufiks te saks e vj. etj. *hrōm* (për sufiksin e fjalës së gjuhëvet gjermanike sh. Brugmann, Gr. 2/1^2 249). Nga kjo në vënd të *qer-ā* që supozohet zakonisht, ku *ā*-ja admetohet vetëm duke u mbështetur në gjuhët gjermanike që në këtë pikë janë ekuivoke, ne si bazë do të vendosim një *qer-ō.* Sa për raportin semantik që supozohet me këtë interpretim: glorie: festë, khs. sidomos sll. e vj. kisht. *slavъnъ dьnь* dies solemnis, çek. *slavnost* e kremte, festë, ditë feste, serbokr. *slävljenje* festa e shejtit pajtuer (të shtëpisë), fjalë këto që hyjnë të gjitha te *slava* glorie. Në punë të mocionit kjo fjalë e shqipes shkon pas emravet të ditëve së javës si *premte.*

k r i p m. flokë, leshra

Përveç autorëvet që citon Meyer-i në E.W. 206 (Schirò Raps.. 58, Mitko), këtë fjalë e dëshmojnë dhe këta: Marchiano, Canti pop. f. 54, Diturija I, 86, pastaj dhe Bogdani, shpeshherë. Kjo fjalë ka të bëjë me lit. *krypti* me u dredhë, me kthye nga ana tjetër, *kreipti* me dredhë, me kthye nga ana tjetër, sll. e vj. kisht. *krěsь τροπή,* temporum muta-

[24] Në aspektin semasiologjik nuk shfaqet thelbësisht ndryshe etimologjia e fjalës shqipe, nëse me E. Schröder (Z. f. d. Alt. 42, 67) vendosim sll. e vj. *hrôm* etj. e sll. e vj. *hrôpan*, gjerm. e lartë v. *rufen*. Shqipja *-m-* do të dilte në atë rast nga *-bn*, cf. Më poshtë te *lumë*.

tio. Sa për zhvillimin e kuptimit khs. irl. *folt* flokë, lesh, kimr. *gwallt* lesht e kres, sll. e vj. kisht. *vlasъ* flokë, lesh, avest. *varəsa* flokë, lesh., gr. *ἑλύω* përdredh, mbështjell, përkul, lat. *volvo* etj. (sh. Walde, E.W. 688, 2 857). Flokët merren, pra, si "kaçurrel, kacara".

q e r t h u l l qark, motovilë, enemi; *q e r t h u l l o j* (*-ë l l o j*) rrethoj, i rri përqark

Grafinë e kuptimin e fjalës së parë e muarmë te Kristoforidhi, Fjalori 186 (sh. dhe Bashkimi 63). Meyer-i, E.W. 220 shkruan *qerthël* (me *l* të butë) dhe si kuptim jep "qark, rreth, çikirik" (që si duket, nuk është një me eneminë). Meyer-i fjalën e bashkon me *qark* që rrjedh nga lat. *circus* dhe zhvillimin ai e mendon kështu që nga deminutivi *qerkth* dolli *qerth* e prej kësaj *qerthëll,* dhe kjo sipas tij u bë nën influencën e *civellus* gr. e re *κερκέλι*. Po këtë shpjegim e kundërshtojnë pikësëpari disa arsye fonetike. Kemi njëherë deminutiva si *zokth* zog i vogël: *zok, mikth : mik.* Edhe në *ujkth* lëkurë megjithë lesh, bashkë grupi *kth* ka mbetur i plotë. Prandaj s'ka ndonjë arsye pse mos të ish ruajtur, krahas me *qark,* ai **qerkth* që pat presupozuar Meyer-i. Pastaj, edhe një ndikim i lat. *circellus,* gr. e re *κερκέλι,* siç e admentonte – sadoqë jo me siguri. Meyer-i nuk pajtohet me faktet e theksimit të shqipes që pranohen sot rëndom: paraoksitonet e latinishtes, kanë hyrë në shqipet pa e ndruar theksin, p.sh. lat. *honōrem: ndēr* lat. *cornutus: kërrutë,* lat. *famíl̥ia: fëmijë,* në Jugë *fëmilë.* Kristoforidhi loc. cit. ka *qerthull,* dhe kjo nuk piqet me *circellus.* Më në fund edhe kuptimi "moptaile, enemi" nuk i përgjigjet me substantiv roman që admetohet në këtë mes. Në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me refleksin shqiptar të rrënjës indoeur. **qert- *qerāt* – që na del në gr. *κάρταλος* shportë, ind. e vj. *kr̥ṇátti* përdreth fillin tjerr. sll. e vj. kisht. *krę(t)nǫti* me dredhë, *krętati* me përkulë, lat. *cratis* thurimë (sh. Walde, E.W. 148, 2198). Kuptimi që ka fjala e shqipes i përgjigjet fort mirë kuptimit që pamë te ky grup fjalësh që cituam. Emrat e qerthullit edhe në të tjera gjuhë kanë dalë prej verbash, që duan të thonë "dredh, përdredh, sjell". Krahaso p.sh. përveç gjerm. *Winde* enemi, qerthull, serbokr. *vïtao : vïti, r. krony,* nga një **kront-n:* sllav. e vj. kishtare *krǫtiti* (Ach. f. sl.

Phil. 28,3). Sinonimi rus është, pra, me shq. *qerthull* i afërt edhe nga ana e burimit. Në pikëpamje morfologjike *qerthull* përmban formantin *-lo,* siç e ka p.sh. dhe *mjergullë* (sh. Brugmann, Gr. 2/12, 362, dhe këtu më poshtë, te *mjergullë*), pastaj *pillë* (sh. më poshtë). Pra, *qerthull,* përsa i përket sufiksit, afrohet me irl. *cert-le* lëmsh, e cila është dhe etimologjikisht e afërt me të; *rth* ka dalë nga *rt,* si zakonisht.

q i p ḱ mullar

Kjo fjalë, që Meyer-i, E.W. 228, e shënon, pa dhënë proveniencën as shpjegimin etimologjik, sipas Kristoforidhit 188 është e toskërishtes jugore (Berat, Përmet). Afrohet me sllav. e vj. kishtare. *kupъ* tok, grumbull, lit. *kaũpas* idem, gjerm. e vj. e lartë *houf* tok, grumbull çetë, lagje, gjerm. e sotme *Haufe* tok, grumbull, gjerm. e vj. e lartë *hūfo* grumbull. Posaçërisht kësaj fjalës së fundit të gjermanishtes së vjetër të lartë fjala e shqipes i përgjigjet më mirë në pikën e shkallës së ablautit. Kështu, pra, si bazë për të do të vendosim këtë **kūp-íjā. qipḱ* qëndron në vënd të një *qypi* dhe na paraqet ndrimin e *y*-së në *i* që është karakteristik për këtë fjalë me *i,* po kjo nuk do të thotë që edhe gegërishtja e ka vërtet me *i,* sepse Bashkimi nuk kufizohet (sh. Parathënien, f. VI) në leksikun e gegërishtës, po ka marrë shumë gjëra edhe nga Kristoforidhi. Më anë tjetër, Kristoforidhi këtë fjalë e dëshmon vetëm për toskërishen, dhe Jungg-u, i cili ka vetëm leksikun e dialektit gegë, nuk e ka fare atë. Mendimi që kjo fjalë mund të ishte p.sh. nga sllav. *kupъ*, duhet hedhur poshtë, ngaqë *u*-ja e sllavishtes në më të shumtën e rasave nuk ka dhënë *y* në shqipet. Këtë e shohim nga kjo listë: *duf* = sllav. *duchъ* (Kristoforidhi 106), *jugë* = sllav. *jugъ* (Meyer, E.W. 164), *kurvë* = sllav. *kurva* (ibidem 217), *trup* = sllav. *trupъ* (ibid. 438), *runs* qengj = serb., bullg. *runo* bashkë lesh (ibid. 371), *rus* blond (ibid.), *ugar* = serb. bullg. *ugar* tokë e çarë (ibid 456), *ulicë* (Kristoforidhi 292) = sllav. *ulica* ulicë, *ubrigë* strehë (te de Rada) = serb. *briga* kujdes, merak, hall, me prefiksin sllav *u* (Meyer, E.W. 455), *strug* zdrug = serb. *strug* id. (ibid. 355). Vetëm *klyç, kliç* që më vonë u bë *qyç, këjiç*) dhe *galige* moçal (te de Rada, sh. më poshtë), duken sikur e kundërshtojnë këtë rregull. Po në këto dy rasa kemi të bëjmë me reflekse të sllav. *lju* (*ljuč, kaljuga*). Këtu, pra, kemi zëvëndësim fonetik të sllav. *lju* me shq. *ly;* një raport analog me këtë ekziston midis gjerm. *ü,* frgj. *u* dhe rus. *ju*,

e cila në huazimet që ka rusishtja nga ato dy gjuhë përfaqëson tingujt në fjalë: rus. *Tjuringija, Türingen, Ljubek, Lübeck, kjuveta* cuvette; pra, duke gjykuar nga këto fjalët që përmëndëm në kohën kur hyjtin këto fjalë në shqipet, *lj* + vokal e sllavishtes jugore dhe *l*-ja e zbutur + vokal e shqipes nuk kanë qënë foneme identike. Përveç kësaj sllav. *kup* ekziston me të vërtetë në shqipet si *kup* (sh. më poshtë).

l a b ë lëkurë, lëvozhgë, tapë

Këtë fjalë e gjejmë në revistën Tomorri, nr. 2 f. 4 shtylla l, në përkthimin e jetës së Piros prej Plutark-ut, përkthyer prej Dokë Sulës. Në gërqishtet i përgjigjet fjala *φλοιός*. Kjo fjalë etimologjikisht hyn në grupin e lat. *liber* bli rus *lubъ* lëkurë e brëndëshme, lëvozhgë, bli, prus. *lubbo dërrasë,* lit. *lubà, lűbas, lóbas* lëkurë e drurëve, let. *lůbīt* me lëvorue, me qirue, *luba* shindër e gjatë e çatisë (sh. Feist E.W. 175, Walde, E.W. 335, 2425 v. Fick. 3^4, 376), me këto fjalë fjala e shqipes qëndron në raportin e ablautit. Baza për shqipen është *laub-,* baza indoeuropiane *ləubh-, lōubh* – (cf. Brugmann, Kl. vgl. Gram. 88, Wiedemann, Handb. d. lit. Spr. 14). E vetmja gjë në këtë mes duket pak si e çuditshme. Po dhe këtu sikurse te *degë* f., që ka dalë nga një mashk. **dvoighos,* do të nisemi nga një bazë mashkullore **laubhos* (më sipër *djathë*). Kështu, pra, kjo fjalë në punë të gjinisë gramatikore përkonte në të parë me rus. *lubъ,* got. *laufs* fletë, gjeth.

l a j paguaj (një borgj), *l a m* pagesë; *p ë r l a j* rrjep, plaçkit, *b l e j, b l e n j, b l ē* paguaj (një borxh)

Mungon te Meyer-i, E.W., po e ka Kristoforidhi, f. 195, Bashkimi 221, Pisko 143; Meyer-i, A. St. 6, 14. Kjo fjalë në formë është bërë një me *laj,* mirëpo kuptimi si edhe lidhja që ka me *përlaj* rrjep, plaçkit, na mësojnë që etimologjikisht të dy fjalët kanë burime të ndryshme; është qysh herët e afërt me lat. *luo* paguaj, me të cilën puthet në kuptim plotësisht. Përmbi farefisin e këtij verbi në gjuhët motra sh. Walde, E.W. 354, ^{2}447; Weigand, E. W.^{5} II, 84, 85 (gr. *λύω* zgjith, *λύτρον* shpërblim, got. *fraliusan,* gjerm. e vj. e lartë *farliosan* me bjerrë, got.

laus zgjidhur, i shkëputur, i zbrazët, i kotë, gjerm. e vj. e lartë *lōs* i lirshëm, çpenguar, i privuar, i pafre, anglos. *lēas* i zbrazët, i privuar, gjerm. e vj. e lartë *lōsan* me shëprblye me të holla me pague për diçka etj.). Ndaj lat. *luo* shq. *laj,* nga një **lau-n̯o,* qëndron në raport të ablautit, kurse got. *laus.* gjerm. e vj. e lartë *lōs;* got. *lausjan* – të cilat paraqesin një zgjerim me *s* – qëndrojnë në të njëjtën shkallë të ablautit. Po gjerm. e vj. e lartë *lōs*, me kuptimet e saj "lirshëm çpenguar, i privuar" dhe anglos. *lēas,* që do të thotë "i zbrazët, i privuar" na tregojnë qartë që fjala *përlaj* e shqipes duhet afruar me grupin e tyre. Meyer-i këtë fjalë në E.W. 237 e lidh me *laj* pastroj, bëj banjë, po kjo gjë nuk ecën për arsye semantike.[25] Nga ekzistenca e *laj* paguaj një borxh sqarohet tani dhe puna e fjalës *blenj, blej, blē.* Vërtet që Meyer-i, E.W. 39 këtë e nxjerr nga lat. *ablevare,* po ky interpretim, pas sa shkroi Pedersen-i (Rom. Jahresber. 9, I, 210), por të qëndrojë më në këmbë. *blē* vjen nga *b-lē,* e kjo nga *leu̯ "*kundërpaguaj, shpërblej", *b*-ja e fillimit të fjalës është prepozicioni *mbë, më*, i cili paraqet të njëjtin trajtim si dhe në *bëleth* mbledh (Kavalioti, Meyer, E.W. 265 A. St. 4,80), *brënda* krahas me *mbrënda* (për përbërjen e kësaj sh. Pedersen, Rom. Jahresber. 9, I. 213), shkodr. *binem* çuditem; tosk. *mbinj* geg. *pî* e bëj të mpihet, e mpij (Meyer, E.W.265), një trajtim analog pëson edhe *n*-ja në ballë të fjalës, d.m.th. bie, duke e ndruar eventualisht një konsonant të shurdhët që vinte pas në sonor; *digjonj, dëgjonj,* nga lat. *intelligo* (Meyer, E.W. 66), *der, gjer* deri, përbri *ndjer* (sh. më poshtë). Me këtë shpjegim që dhamë këtu sqarohet edhe kuptimi i kompozitavet: *shpërblenj*, *kseshpërblim* shpërblim. Kuptimin origjinal të verbit e ka ruajtur mirë *bluem* yst (Kavalioti) si të thuash "përmbipagesë". Në punë të shkallës së ablautit i përgjigjet got. *fra-liusan.* Në pikëpamje morfologjike duhet nisur nga *blē* (cf. Pedersen; Alb. Texte 12; Pekmezi, gr. 233); *b-lē* nga një -*leu̯ō.* Duke ndjekur tendencën e për-

[25] Ato mënyrat e së thënit të rumanishtes që shënon Papahagi, Jahresber d. Inst. f. rumän. Spr. 14, 164 e që janë paralele me të shqipes (dakorum. *N'am spălat de datorie,* arum. *mi laĭ di borğe,* paralele me shq. *laj detyrënë)* e kanë burimin te një ndikim i shqipes mbi rumanishten në trajtën e përbrëndëshme të këtyre shprehjeve. Gjuhët e tjera të Ballkanit nuk njohin ndonjë shprehje të këtillë. Fenomene analoge me këtë ka dhe të tjera në gjuhën rumune. Khs. p.sh. mënyrën sesi leu kuptimi i rum. *lumë* botë, jetë (sipas sllav. së vj. kishtare *svĕtъ* dritë, botë, Puşcariu, Et. W. d. rum. Spr., f. 97, 1127).

gjithëshme të verbeve të shqipes, kjo fjalë (cf. Pedersen, loc. cit.) shkoj e hyri në koniugacionin më *n-* dhe kështu iu përshtat në mbaresë verbave si p.sh *pëlqenj;* që këndej formimi i abstraktit *kseshpërblím = pëlqím.* Pastaj pas modelit të atyre rasave, ku kemi asbtrakta më *-ím* krahas me abstrakta më *-úam* (cf. e *shëlbueme* Kristoforidhi, Fjalori 386 përbri *shëlbím*), krahas me *-blím* u sajua *bluam.*

l a p ë lëkurë e barkut të derrave; *l ë p i j* gdhënd, daltoj. *l a t ë* lloj cakorre, lloj nagaçe

Të dy fjalët më të para që i ka Kristoforidhi, Fjalori 197, 204, lidhen me gr. λέπω qëroj, λέπος lëkurë, lëvore, idem, λοπός leskër; λοπίς luspë, slloven. lepen, rus. лепéнь copë, leckë, mbeturinë, rriskë, lit. lãpas fletë, gjeth (sh. Prellwitz, E.W.2, 265; Walde, E.W. 335, 2,425 v.) Vërtet se G. Meyer-i në E.W. 236 me gr. λέπω krahasoi shq. lakur lakuriq, po ky afrim nuk është me vend, me që gr. λέπω me farefisin e saj nuk kanë labiovelar, po labial. Këtë e dëshmojnë më së miri ato fjalë të gjuhëvet sll.-bal. që i përkasin këtij grupi26. Te lapë hyn nga fjalori i shqipes dhe lëpīj gdhend, daltoj gegërisht e toskërisht, për gegërishte nga shkaku i aoristit lëpīna që e gjejmë te Kristoforidhi 204, duhet nisur nga një prezent lëpîj; khs. dhe participin lëpirë të toskërishtës. Sa për zhvillimin semantik të lëpīj gdhënd, daltoj, kruaj, përkundrejt gr. λέπω qëroj khs. lat. scalpo gdhënd, daltoj, kruaj, me gjerm. Schale lëkurë, guajtë, schälen qeroj, nord. e vj. skilja ndaj, veçoj. Prandaj për bazën lep më mirë do të jetë të nisemi nga një kuptim bazë "çaj, ndaj", nga i cili shpjegohet edhe kuptimi i lapë-s lëkurë (posaçërisht lëkura e barkut të berrave), po ashtu si ai i lat. scortum lëkurë, shuall, ind. e vj. kr̥tti-ḥ lëkurë: rrënja sqer veçoj, ndaj, pres (gjerm. e vj. e lartë scëran me qethë etj., gr. δέρμα lëkurë e rjepur, lëkurë: ind. e vj. dr̥ṇáti çan, gr. δέρω. rjep (Walde, E.W. 143, 2 192). Nga pikëpamja morfologjike *lëpīj* (*lëpîj*) duhet gjykuar po ashtu si fjala *lëpínj* (me gjuhë) që ka trajtuar Pedersen-i në Rom. Jahresber. 9, I, 211. Këtu duhet vendosur dhe fjala *latë* lloj cakore,

[26] Fjalët *lakur* lakuriq, *lëkurë, likurë,* shkodr. *lkur* f. lëkurë, shuall, lëvore drurësh, bishtajë, hyjnë në grupin e sllav. së vj. kisht. *lǫčǫ* ndaj, veçoj shkëput, gr. *λακίς* f., *λάκος* n. rreckë zhele, *λακίζω* gris, çjerr, lat. *lacinia* kind (në themel reckë), *lancino* shqyej gris, shqerr etj. (sh. Prellwitz, E.W.[2], 258; Walde, E.W. 317, 2403).

nagaçe e vogël. Kjo te Meyer-i mungon, po e la *latë* lloj cakore, nagaçe e vogël. Kjo te Meyer-i mungon, po e ka Bashkimi 226, Kristoforidhi 199. Meyer-i, E.W. 60 ka vetëm denominantivin latonj, të cilën ai e lidh me daltë = rum. daltă nga sllav. e vj. kishtare dlato. Mirëpo latonj si denominativ hyn natyrisht te latë e jo te daltë. E sa për latën, nuk ka asnjë arsye që këtë ta konsiderojmë një huazim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga sllavishtja. Ndrimin dl: gl e (sh. Pedersen, K.Z. 33, 545; Bugge, BB 18, 167; Meyer, A. St. 4, 81) e kanë pësuar, siç do ta tregojmë më poshtë te sogje roje kullë (sh. pjesën e II) edhe huazimet e shqipes nga sllavishtja. Kështu, pra, për sllav. Dlato duhej të prisnim në shqipet një glatë, gjatë. latë vjen nga një *lap-tā, me ndrim të pt-së në t (më poshtë te ngris), kuptimi i saj puthithet bukur me kuptinin e lëpíj gdhënd daltoj: cf. gr. σκαλίς sëpatë: lat. scalpo daltoj. Për sufiksin e latë-s sh. ç'u tha më lart për fjalën botë.

l a p ë r d h i fjalë të ndyra; *l a p a r o s* ndyj, qelbem

Këto fjalë mungojnë te Meyer-i, po i ka Kristoforidhi (198 respektivisht 197) me Bashkimin (226). Hyjnë në grupin e ind. së vj. *rēpaḥ* n. Njollë, ndyrësi, lerë, *lēpa-ḥ* të lyerit, të ndyrët, gr. *λίπος* n. dhjamë, *λιπαρός* i majmë, sll. e vj. kisht. *lěpъ* lyrë, lerë, ngjitës për të zënë zogj, lit. *lipsznùs* ngjitës lat.*lippus* zglliban, sklepan, (më gjatë përmbi këtë grup fjalësh flet Walde, E.W. 343 ^{2}434 v.). Baza indoeur. është *leip-, loip-,* në shqipet *lap* nga *loip.* Për reflektimin e diftongut *oi* në gjuhën shqipe khs. *gjalmë:* got. *Insailjan* (Brugmannn, gr. I^{2} 183). Përsa i përket kuptimit fjalë të ndyra, ky është kuptimi i specializuar, se po të marrim emrin topik *Laparda* (fshat në verilindje të Beratit, harta e përgjithshme e Austrisë 1: 2000.000, fletore Elbasan, e shkruan *Ljaparda*), na bën të mendojmë me të drejtë që në themel kemi të bëjmë me një kuptim të moçëm më të përgjithshëm ndyrë si llucë. Khs. emra vëndesh sll. si serb. *Grezna,* rus. *Grjazь, Grjazovec, Grjaznucha, Grjaznoe,* të cilat lidhen të gjitha te sll. kisht. *gręza* llucë, rus. *grjazь* llucë, lerë, ndyrësi, slloven. *grez* baltë e butë e e thellë, moçal (Miklosich, Slav. Orstsnamen aus Appellativen, f. 27). Përveç kësaj, verbi *laparós* ndyj, fëlliq, qelbem, të shpie te një kuptim i parë "ndyrësi lerë", i këtij substantivi. Nga pikëpamja morfologjike, koekzistenca e lapërdhī dhe laparós na dëfton që emri duhet zbërthyer në lapër-dhī. Baza

loip është zgjeruar në shqipet me sufiksin -aro-, ashtu si në gr. λιπαρός. Vokalin e sufiksit përveç se të laparós e gjejmë të gjallë edhe te emri i vëndit Laparda. Dhe sa për pjesën fundore -dhī, kjo na del një konglutinat, siç e shohim edhe te lapër-dhī përbri Lapar-da, pastaj te njerí krahas me njer, te kallí krahas me kall. Kështu, pra, meqë dh- në lapër-dhī ka dalë nga d pas r-së, ne arrijmë te d-ī (= d-ijā). -d- afrohet me sufiksin -da të sllav.: pravьda, vražьda. (Për këtë sufiks sh. Brugmann, gr. 2/12, 472). Në shqipen vetë me konglutinatin -dhī ka të bëjë dhe konglutinati -zī (njerëzī, marrëzī): -z nga një dj. Për llojin e kësaj afërie më shumë hollësira te fjala zī.

l a p s dëshiroj

Këtë fjalë e shënon Kristoforidhi 198 për Tiranë (te Meyer-i, E.W. mungon). Hyn në indoeur. **leubh-,* të cilën e gjejmë në got. *galaufs* i dëshirueshëm, çmuar, i vlefshëm, ind. e vj. *lúbhyati* ka dëshirë të madhe, lat. *lubido libido* gjakim, epsh, *liebet lubet* ta ka ënda, sllav. e vj. kishtare *ljubiti* me dashtë etj. (Përmbi këtë grup fjalësh në gjuhët motra sh. Walde, E.W. 336, ^{2}426; Feist, E.W. 180). Baza e fjalës së shqipes është **laub-.* Në pikëpamje morfologjike, para së gjithash, është për të vënë re se *s*-ja e shqipes nuk mund të jetë një *s* origjinale, por – meqë siç po duket, përjashtohet rasa që të ketë dalë nga një labiovelar – rrjedh nga një *-ṭi*. Dhe grupi *-bt-, -pt-* në gjuhën shqipe nuk ruhet, po u bë *t* [cf. *shtatë:* lat. *saptem,* Brugmann, gr. 1^{2}, 722, 971, pastaj *latë* (sh. më lart), *ngris* (sh. më poshtë]. Nga ana tjetër, nuk mund të pranohet që *-b-* fundore e bazës të ketë qënë ndarë nga *-ṭi-* me anë të një vokali që në krye të herës spese po të ishte kështu *-b-* si intervokalike do të kish rënë. Pra, këtu kemi të bëjmë me një formë verbale të re, të sajuar me anë të analogjisë. Ashtu siç kemi krahas me *mbrap* kthehem edhe *mbraps* (Kristoforidhi 231), *prapsem* (Lumo Skëndo, Këndime f. 12)[27], ashtu edhe prej një **lap* nga *laub-* erdhi e u përftua *laps*. Një formim analog me këtë është dhe *laps* u lodha, u mërzita.

[27] Kɛndime pɛr škołat e para prej Lumo Skɛndo. Sel'anik, 1910.

l a p s u lodha, u mërzita

Vetë me gr. lαπαρój i flashkët, i butë, i blluzgët, λαπάζω zbraz (stomakun), ἀλαπαδνός i dobët, i mjerë, lit. aĨpti me u likshtue (më shumë për grupin e gërqishtes te Boisacq, Dict. ét. 41; Persson, Wurzelerweit. 170, 226). Sa për mënyrën e formimit sh. verbin më sipër.

l e n j lindem, *l i n d* pjell, *p o l e m* popull

Për mënyrën sesi lidhen në mes të tyre të dy verbat që cituam, lidhje që, sado me dyshim, e kish parë edhe Meyer-i në E.W. 241, sh. Pedersen, Alb. Texte f. 12. Atje shpjegohet edhe sesi *lenj* hyn në fleksionin më *-n*. Me *lind* nuk mund të ndahen nga njera tjetra dhe meqë *lenj* (Pedersen, l.c.) përmban një *d* të zhdukur rregullisht, bie natyrisht mendimi i Meyer-it që *lenj* mund të ketë ardhur nga lat. *levare*. Kjo fjalë përkundrazi shpjegohet mirëfillit me mjete të visarit autokton; got. *liudan* me u rritë, gjerm. e vj. e lartë *liotan* idem, *liut* popull, gjerm. veriore e lartë *Leute*, sll. kishtare *ljudъ* popull, let. *laudis* gjind, njerëz. *lindem* qëndron ndaj *lenj* si *zgjindem* (Kavalioti) ndaj *gjenj*; pra *i* në *lindem* do të jetë sajuar me anë të analogjisë, sepse që të themi se edhe *e*-ja që ka dalë nga një indeur. *eu* të ketë dhënë përpara dy konsonanteve një i, siç ka dhënë *e*-ja origjinale, për këtë do të jetë zor të gjinden prova të tjera. Me këto verbe lidhet edhe *polem* popull (e gjejmë që te Bogdani), e cila fjalë paraqet të njëjtin zhvillim kuptimi që shohim dhe sllav. *ljudъ* popull, gjerm e vj. e lartë *liut* popull, fjalë, që janë gjiri me atë. Si paralele semantike për polem popull, lenj, lind, le të përmendim dhe këto: sll. *narodъ* komb, *roditi* me le, me pjellë; lat. *natio*: *nasci* me le, *gens*: *gignere. po-lem* vjen nga një **leud-m-* me atë sufiks participial që e trajtuam te *jerm* dhe me të vërtetë, një formë e tillë ekziston dhe e gjejme të përdorur si particip: *lem* = it. generato (Bogdani, Cun. proph. I, 8, 7). Mendimi që shfaq – me dyshime – Meyer-i, që polem ardhka nga gr. *πόλεμος* dhe dashka të thotë në të vërtetë trubullirë, përshjellim: nga ana e kuptimit nuk të kënaq dhe rrëzohet edhe nga fjala *lenë* lindje, që është afërt me polemin dhe morfologjikisht është sajuar njësoj si ajo (me këtë kuptim s'e gjen nëpër fjalorë, po e ka shkrimi

Ferrëfejës a mësime myslimane… këthymun shqip në dialekt t'Elbasanit prej J.H.M. f.5), *lemë* do të thotë "lindje" (orient), kështu te Krsitoforidhi, Psalteri, B. 78, 26, dhe Fjalori, 203). Këtu, përveç këtyne, hyn dhe *les* ai që bijon, generator (Bogdani, Cun. proph. I, 8,7).

l e s h; *l e t ë* jele

Interpretimi që i jep Meyer-i fjalës lesh (: gjermanik. *Flies*, gjerm. e mesme e lartë *vlies*, anglos. *fleos* nga një bazë e përbashkët **tleusi*-, E.W. 241) s'ta do mëndja të jetë i drejtë meqë për grupin e fjalëvet të gjuhëvet gjermanike një fillim me *tl*- nuk është i siguruar. Përkundrazi Fick 3^4, 225 fjalën gjermanike e afron me let. *pluskas* tufë flokësh, zullufe, lit. *plùskos* tufë flokësh, flokë, irl. *luascah* leshtor. Thurneysen, I. F. 14, 128, pas të cilit shkon dhe Kluge, E.W. 7, 477, gjerm. e mesme e lartë *vlies* etj. e lidh me rl. e mesme *lō* flok leshi, kjo nga një *pluso*- lat. *pluma*. Pra, grupi i gjerm. së mesme të lartë *vlies* ka të ngjarë që në ballë të fjalës ka pasur *pl*, po *pl*-ja në shqipet në ballë të fjalës nuk ndrohet. Atëherë kemi të drejtë të kërkojmë për shq. *lesh* një afrim tjetër. Ind. e vj. *lava-ḥ* të prerët, gjë e prerë, qethë lesh, flokë; pjesë, copë, *laví-ḥ* drapën, gr. *λαῖον* idem (cf. Petersson, I.F. 24, 268, Fick 3^4, 270 Walde, E.W. 354, ^{2}447). Baza e fjalës së shqipes është **leu-s* me formantin -*s.* Krahaso zgjerimet me *s* të këtij grup fjalësh në gjuhët gjermanike: got. *lausjan*, gjerm. e vj. e lartë *lōsjan*, *lōsōn* etj. (Fick 3, 4 377 v. Walde, loc, cit). Sa për afërinë e formantit *s* me determinativin *s,* sh. Persson, Wurzelerweit. f. 89, shënim 2, Brugmann, gr.2/1^2, 515, 538. Këtu duhet vendosur dhe shq. *letë* jele, një fjalë që gjer më sot nuk qe regjistruar; kjo vjen nga një **leu-t*; nga pikëpamja kuptimore kjo fjalë qëndron ndaj lesh si frëngj. *crinière* jele ndaj *crin*, lat. *crinis* flokë, leshra. Për reflekset e tjera të këtij grupi në gjuhën shqip sh. më lart te *laj*.

l ë n g ó r i përkulshëm, i epur (de Rada)

Meyer-i, E.W. 244 këtë fjalë e lidh, po jo me siguri, me *lëngonj* (nga lat. *langueo*, -*ēre*), po këtë etimologji, edhe duke lënë mënjanë të tjerat, s'ta afron mëndja as nga ana e kuptimit. *lëngór* i përkulshëm, i epur, afrohet më

fort me lit. *leñkti* me përkulë, me lakue, *liñkti* me u shtrembnue, sllav. e vj. kisht. *lęšsti* me përkulë, *lǫkъ* hark, let. *lůkans* i përkulshëm, i epur (nga një **lank*-, Bielenstein, Lett. Spr. I. f. 240) gr. *λοξός* i përkulur nga njëra anë, lat. *licinus* i përkulur, i kthyer nga lart (për këtë grup fjalësh cf. Fick. BB. 21 276; Prellwitz, E.W. 2265, 274; Wald E.W. 318, 2 405; Zupitza, Gutt, 69; K.Z. 36, 58 a). Në sufiks me këtë fjalë piqen dhe fjalët *hjezor* me *hie*: *hie*, *gjatulor* i ngadaltë: *gjatë* që të dyja edhe këto fjalë të Kalabrisë si ajo që po trajtojmë. Është vështirë të thomi nëse ky sufiks burimin e ka në lat. apo vetë në shq., sidoqoftë, edhe ky mendimi i fundit nuk duhet hedhur poshtë, meqë një formant po e vërtetojmë dhe në *lapërdhí*, *Laparda* (sh. më lart). Me këtë rasë një *-or* nga një *ā-ro* mund të shpjegohej mirëfilli në këtë mënyrë që formanti *ro-* iu ngjit temave që qenë në origjinë tema më *-ā* dhe që andej ky konglutinat u përgjithësua. Po në qoftë se do të decidohemi për origjinën lat. atëherë mund të mendojmë një kontaminacion të *-ar* dhe *-tor*, *-tuar*, nga lat. *-arius*, *-tore* (cf. Meyer-Lübke në Gröbers Grundriss 2, 1, 1055) me *-or*.

l i m o n t í́ nga, papunë

Meyer-i këtë fjalë e ka prej de Radës. Tani e përkthen Dokë Sula në përkthimin e Piros së Plutark-ut, kapitull 14 (Tomorri, nr. 6, f. 4 shtylla 1). Përkthyesi do ta ketë marrë fjalën nga shkrimet e De Radës. Kristoforidhi me Bashkimin nuk e kanë. Meyer-i, E.W. 246, mendon, po me dyshim, për ta nxjerrë nga it. *alimentare* (pra si të thuash: "pensionist"), po ky shpjegim nga ana e kuptimit nuk të besohet dhe fonetikisht çalon. Këtu më fort kemi të bëjmë me një kompozit të ngjitur me mjetet vetiake të shqipes, pjesa e parë e të cilit është një imperativ: *lë-mon-t-í́* = leje kohën, ku *lë* është imperativi i verbit *lë*, dhe *mon-* është akuzativ i *mot*. Këtë trajtë të akuzativit e gjejmë p.sh. dhe në vargun *i shërbeva mot e mon* (De Rada, Raps.); pastaj në fjalën *gjithmon* ("gjithë kohën, çdo kohë", Pekmezi, Gr. f. 215, khs. gjerm. *alliveil* "përhera"). Kompozita me *lë* si ky që pamë këtu ka shqipja dhe të tjera; p.sh. geg. *lebarqí́* (Meyer-i, E.W. 242), tosk. *lëbarkë* (Kristoforidhi 201) të hequr bark. *i-*ja e silabës së parë në *limontí́* ka dalë nga një *ë* pas *l*-së, siç e shohim dhe në kal. *livere*, krahas me *lëvere*

rrecka (Meyer, E.W. 244), në geg. *livroj* përbri *lëvroj*, *lëroj* (arën), geg., tosk, *lishoj*, prej dhe pranë tosk. *lëshoj*, tosk. *likurë*, geg. *likur*, pranë tosk. *lëkurë* (cf. Pekmezi, Gr. 285). Kjo fjalë e shq. në kuptimin e saj i përgjigjet frëngj. *passe-temps* – substrati i drejtpërdrejtë i këtij substantivi më *ī* është një adjektiv më *-etë*, i formuar prej **lë-mon*, i atij lloji që përmend Meyer-i në A. St. 2, 77: *errëtë* pranë *errë*, *majmëtë i majmë, largëtë* pranë *largë*. Që në *limontí* midis *n*-së e *t*-së ka rënë një vokal, këtë e shohim jo aq nga të raujturit të paprekur të grupit *-nt-* se De Rada, Raps. 18 shkruan, përveç *limontí* edhe *këntuar* – sesa nga arsye morfologjike.

l u m, l u m ë, l y m ë lumë; *l i s ë, l u s ë, l y s e*, she, përrua

Meyer-i, E.W. 251 shënon trajtën *lymë* prej Bardhit. E gjegjmë edhe te Bogdani, Cun. proph. I, 67, 19. Shpjegimin që jep Meyer-i loc. cit. marrë nga lat. *flūmen*, W. Meyer-Lübke, Gröbers Gr. I; 1047 e quan "jo krejt të sigurtë". Dhe me të vërtetë, po ta nxjerrim këtë nga latinishteja, ndeshim së pari në vështirësi fonetike: *fl*-ja iniciale e latinishtes qënka përfaqësuar në shqipet me një *l*, kurse lat. *fl* ruhet: *flok* nga *floccus*, *fluturoj* nga *fluctulare* pastaj, vështirësia që paraqet reflektimi i lat. *ū*, në *flūmen* (kurse zakonisht ka dhënë *y* në shqipet) del nga shtjellimi i Meyer-Lübke-s, loc. cit. Së dyti, shpjegimi i *lumë* nga *flūmen* ka lënë mënjanë fjalën *lisë*, *lusë*, *lyse* she, përrua, që u shënua në krye. Nga këto tri forma të parën Meyer-i, E.W. 247 e citon pas Hahn-it, Reise durch Gebiete des Drin und Wardar f. 24, po pa ia shpjeguar burimin. Harta e përgjithshme e Austrisë për Europën e mesme 1:200.000 te fleta e Prizrenit shënon tri rrypna uji me këtë emër. Këtu e gjejmë të shkruar *Ljusa* (*lj=l*, cf. *Ljaparda = Laparda*) dhe *Lüsja*. Këto fjalë të shqipes, po t'i afrojmë me cimr. *lliant* lumë i madh, det, sllav. e vj. kishtare *lьjǫ*, *lějǫ* derdh, lit. *lė́ju* derdh, *lytùs* shi got. *leiþu* verë pemësh, rrënja *lei-* (Walde, E.W. 337, Fick 3^4, 364), nuk hasim asnjë vështirësi. Baza e trajtave *lymë*, *lumë*, *lum*, është **li-m*, një formë kjo që ruhet e gjallë në emrin e lumit *Lim* në Hercegovinë.[28]

[28] *Që emri i lumit Lim shkon bashkë me apelativin e shqipes lumë këtë e ka pranuar qysh Vondrák, Altksl. Gr., f. 53, duke sqaruar gjithsesi i-në e emrit të lumit me rrethan të brendshme sllave (cf. Sll. kisht. e vj. plinǫti përbri pljunǫti). Analiza*

Sufiksi po ai që konstatuam në fjalën *polem* popull. *y*-ja në *lym* u shkaktua nga labiali që vinte pas. Shëmbuj për ndrimin *i: u* pas një *l*-je na japin Meyer-i, E.W. 250 me Pekmezin, Gr. 56, *lule*, nga lat. *lilium*, *kolubë*, kasolle, nga sllav. *koliba*, *luath livadh*, nga gr. e re *λιβάδι. lisë*; *lusë* kanë atë sufiks që e pamë dhe te *bresë*; *kmesë*, lat. *grosa* (te Arnobi). *y*-ja në *lysë,* në qoftë se kjo trajtë ekziston vërtet, do të jetë përftuar pas *lym*.

Tosk. *l u m ë,* geg. *l u m* i lumtur, geg. *l u m n í* lumtëri, lavdi, *l u m n o j* lus shënjtorë ose të vdekur, lavdoj

Të tjerë përfaqësonjës të kësaj familje i gjen te Meyer-i, E.W. 250; fjalëvet të geg. që cituam këtu në krye u dhamë jo vetëm kuptimet që ka Meyer-i, po dhe atë të Bashkimit, f. 240. Këtë familje fjalësh Meyer-i e ka lënë pa shpjeguar, ku *lumë*, *lum*, ka dalë nga *lub-no* dhe është e afërt me gjerm. *lob* lavd, lavdi, nord. e vj. *lof* lavdi, lit. *liaupsẽ* lumërim, këngë lavdi, *liáupsinti* me lumnue etj. (për përhapjen e këtij grupi në gjuhët motra indoeuropiane sh. Walde, E.W. 336, [2]426, Berneker, I.F. 40, 151, dhe këtu më lart fjalën *laps*). Me këto fjalë që cituam këtu afrohet mirë nga ana e kuptimit sidomos *lumní*. Trajtimi i *bn*: *m* është, pas sa u tha këtu, po ai që shohim te *pn* (*gjumë* nga *supnos* gr. *ὕπνος)*. Një e këtillë konkordancë në trajtimin e *bn* dhe të *pn* është afër menç a priori, sa kohë që si trajtë të ndërmjeme midis *pn* dhe *m* do të pranojmë një *mn* (Meyer, ct. st. 3, 32), dhe sa kohë që për *bn* supozimi i një forme të këtillë ndesh edhe në më pak vështirësi se sa te *pn*. Edhe në latinishtet *pn* e *bn* janë bërë të dyja *mn* (*somnus*, nga një *sụepnos*, khs. *sopor*; *Samnium*, khs. *Sabelli*. Morfologjikisht *lum*, nga *lub-no-*, është një formim participial: "i lëvduar, i lumnuem".

l u n g ë

Meyer, E.W. 53 dhe Bashkimi kanë kuptimin e rëndomtë të lungës, kurse Kristoforidhi, Lex. 213 ka kuptimin e veçantë "iritacion i bajameve".

---

etimologjike e fjalës së shqipes – dhe për këtë duhet të shihen çështjet e realieve – më vete lejon që i të shihet si e fillme.

Meyer-i, loc. cit. këtë fjalë e afron, po si me dyshim, me *bullungë* xhungë, e dalë në trup si dhe në enë metali, dhe e bashkon kështu me *bulë*, mungull, gonxhë që vjen nga lat. *bulla*. Mirëpo me këtë shpjegim mbetet i errët trajtimi i silabës së parë. Kjo fjalë më fort ka të bëjë me ind. e vj. *rṓga-ḥ* cen, sëmundë, ruje e thyer, dhimbje, sëmundë, lit. *lū́žti* me thye (intrans.), gjerm. *Lücke* vrimë, sopë që mungon, *Loch* birë, vrimë, rus. *luznutь* me i ra, me shty (për këtë grup fjalësh khs. Walde, E.W. 352 ^{2}445). Fjala e shqipes bashkë me ind. e vj. *rṓga-ḥ*, *rujā* na shpien te një *leu-g*, kurse fjalët balto-sllave janë vazhdimi i një *leu-ĝ*-. Sa për zhvillimin semantik të fjalës ("lungë") përkundrejt irland. së vj. "dhimbje sëmundë" khs. gjerm. e vjetër të lartë *swëro* dhimbje në trup, sëmundë, bullungë, lungë, gjer. e sotme *Geschwür* lungë.

m a r r

Meyer-i, E.W. 261, këtë fjalë, pak si me dyshim, e afron me ind. e vj. *mr̥šáti* prek, dhe si rasë analoge për trajtimin fonetik ai përmend fjalën *dritë*, prej një **drste*, *mer*- për *mers*-. Veçse në A. St. 3,14 që u botuan pas E.W., Meyer-i vetë provoi që në *dritë* nuk kemi një ndrim të *rs*, po një ndrim të *k̂t* në *t*; *dritë* shkon me ind. e vj *dr̥ś*-, gr. *δέρκω,* anglos. *torht*. Prandaj një *rr* nga një *rk̂* nuk ka të ngjarë që të jetë. Përveç kësaj barazimi: shq. *marr*: ind. e vj.*mr̥šáti* prek, nuk të kënaq as nga ana e kuptimit. Më mirë pra ta afrojmë verbin e shqipes me gr. *μάρη* dorë (cf. Neisser, BB 19, 121 v.) *εὐμαρής* përdorak, këtu kemi të njëjtin raport kuptimi si në gr. *χείρ*, shq. *dorë*: ind. e vj. *hárati* merr mban, *háraḥ* të marrët, dorëza, *haraṇa-m* të marrët krahu (Prellwitz, E.W. 504). Krahaso përveç këtyre edhe austr. *Greiferl* = dorë (*greifen* = me kapë, me rrokë, përkth.). *rr* në *marr* vjen nga një *rn*. Ky verb, siç ka dëftuar Pedersen-i, K.Z. 33, 542 dhe Alb. Texte 12, është një nga më të vjetrat verbe nazale të shqipes. Me këtë gjë konkordon më së mirë fakti që vetëm prezenti e participi paraqesin një *rr*.[29]

[29] Gjiri pakëz më e largët është gr. *μάρπτω* kap, që rrok, të cilën e afron Pedersen-i BB 20, 231. Për *μάρη: μάρπτω* sh. Brugmannn, I.F. 18, 131, Persson, Wurzelerw. 62, për *μάρπτω* sh. Kretschmer, K.Z. 31, 392. Nuk është e sigurtë që *μάρη* të ketë një temë e moçme më *r-n*- (ef Pedersen K.Z. 32, 248).

m a z ë ajkë, sipa e qumështit

Kjo fjalë mungon te Meyer-i, po gjendet te Bashkimi 257, Jungg 76 (maz), Kristoforidhi 217, i cili jep edhe kuptimin e fundit (gr e re *τσίπα*); etimologjikisht hyn në familjen e shq. *manj, maim*, lat. *madeo* jam i lagët, i njomë, gr. *μαδάω* përderdhem, tretem, ind. e vj. *mēda-ḥ* dhjamë, *mḗdha-ḥ* lëng i lyer, pije e fortë, gjerm. e vj. e lartë *mast*. gjerm. e sotme *Mast* të majurit, maja (Brugmann, Grundriss 1,[2] 624). Baza është *madi̯ā*. Meqë ajka paraqet të majmit e qumështit, emërtimi i saj kuptohet mirëfilli nga ana semantike. Sa për raportin kuptimor "cipë e qumështit" përkundrejt "ajkë" khs. gjerm. e mesme të lartë *roum* ajkë, gjerm. e sotme *Rahm* ajkë, përkundrejt anglos. *rēama* cipë e hollë (Fick 3,[4-] 348).

Geg. *m a z í* hulli; toka e punuar, gati për të mbjellë; të çarët e ugarit

Formën dhe kuptimin e kësaj fjale e kemi prej Kristoforidhit 217, i cili si sinonim na jep *ugar*, dhe prej Bashkimit 257; Meyer-i, E.W. 257 ka trajtën *mazie*, pas Rossi-t, po fjalën e lë pa shpjeguar. Kjo hyn në rrënjën *mad* i bie, e pres, e rrah (gjerm. e vj. e lartë *steinmezzo*; lat *maialis* derr i tredhur, nga një *madi̯alis,* Sommer, I.F., ll, 265; Walde 361 [2]455). Për kuptimin khs. gr. *φάρος* hullis, çaj copëtoj, lat. *ferio* shtyj, i bie, e govit (Walde, E.W. 217, [2]283). Një trajtë bazë **madi̯ā*, që dha **mazë* erdhi e iu ngjit një *í* sekundare në atë mënyrë siç u pa më për së afërmi të fjalës *zī*. Për punë të sufiksit krahaso sinonimin *vërrí* (sh. më poshtë). Shtimin sekundar të *-í-së* e shohim dhe te geg. *lëbarqí* dizenteri, përkundrejt tosk. *lëbarkë*.

m b y l l, m b i l l

Kjo fjalë afrohet me lit. *pilìs* kështjellë, kala, let. *pils* idem ind. e vj. *pū́r* kala, qytet i fortifikuar, *gōpuram* portë e qytetit, gr. *πόλις* kala, qytet, *πόλη* portë, duke admetuar një raport semantik pak a shumë të atillë si midis rus. *zamaknútь* mbyll dhe *zámokъ*, në çek *zámek* etj. (Për këtë grup fjalësh sh. së fundi Jacobsohn K. Z. 42, 272 v.). Fjala *mbyll* në bazën që do të supozojmë për të i përgjigjet më fort fjalës së baltishtes *m-pi̯*, respektivisht

-pu̯l̥-. Me këtë ne vëmë në dorë një dëshmi për reflektimin të *l̥*-së sonantike në gjuhën shqipe. Sikundër, pra, që *r*-ja sonantike në pozicion para sonanti reflektohet me *ir*, kështu reflektohet edhe *l*-ja sonantike, në të njëjtin pozicion, me *il*. *y*-ja dolli nga *i*-ja pas tingullit labial. Trajta sekundare të *mbyll* sjell Kristoforidhi, Fjalori f. 232. Nga këto vetëm tosk. *mbëllynj* duhet bashkuar me *mbyll*, *mbill* nga ana e etimologjisë. Pedersen-i, Alb. Texte 156 ka *mbëllij*, *mbllij*; *ë*-ja këtu u përftua në silabën e patheksuar. Format që gjejmë te Pedersen-i na tregojnë se kemi të bëjmë me një formacion verbal të llojit që trajton Pekmezi, Gr. 184, 152 v. Përkundrazi, trajtat *mbëshel*, *mbëçel*, *mbërçel*, *mëshel*, që i ka Kristoforidhi loc. cit. hyjnë te *çel*.

m b u r r, m b u r r e m

Meyer-i, E.W. 55 këtë fjalë e lidh, sadoqë pak me dyshim, me *burrë,* të cilën ai më tej e afron me gjerm. e vj. të lartë *gibūro* bashkëbanor. Po Wiedemann-i, BB 27 219, dyshon që fjalët *mburr* e *burrë* të jenë të afërta në mes të tyre, dhe mendon që *mburrem* do të ketë të bëjë me familjen e fjalëvet sllave që i ka trajtuar Miklosich-i, E.W. 268 te fjala *pŭch-*. Mirëpo atëherë mbetet i ërrët raporti fonetik midis tingullit fundor të verbit të sll. dhe tingullit fundor të verbit të shq.: sll. *ch*. rrjedh nga një *s*. Veçse më anë tjetër vërtet që për arsye të kuptimeve është mirë që *burrë* dhe *mburr* të ndahen nga njera tjetra, por për *mburr* është e mundur pa tjetër që të gjëndet një vënd përbrënda shqipes: duke e lidhur me *bie* sjell, lat. *fero* gr. *φέρω* sjell, indoeur. *bher-*. Edhe *mbahem*, e cila edhe kjo hyn në këtë grup (Meyer, E. W 35) ka kuptimin "mburrem". Pra, fjalët *mbahem* dhe *mburr* që janë të afërta nga kuptimi, janë të afërta edhe nga burimi i tyre. Për kutpimin krahaso edhe serbokr. *ponòsiti se* me u mburrë, me u krenue, me u mbajtë me të madh: *nòsiti* me bajtë. Në pikëpamje fonetike si bazë duhet vendosur një **bhr̥-n-, bhₑr-n* (cf. Wiedemann, loc. cit.), në të cilën *r̥*-ja dha *ur* nga shkaku i labialit të mëparshëm, *mburr* është një prezent i vjetër më nazal, ashtu siç është dhe *marr*.

Tosk. *m b y t, m b y s*; shkodr. *m y s* vras

Kuptimi "vras" është i Shkodrës (sh. Jungg, Fjaluur f. 85). Kuptimet e tjera (të tosk.) u zhvilluan ashtu si dhe frëngj. *noyer* me mbytë, nga lat. *necare* me vra; po ashtu dhe ital. *annegare* me mbytë, nga lat. *adnecare*. Për *mbyt* Shkodra thotë *me myt n'uj*; (cf. Bogdani, Cun. proph. I. 2,7). Për punë të etimologjisë kanë rëndësi themelore kuptimet e kompozitit: *përmbys* në Greqi *prëmis* zbraz, *përmbys* përplas; në Siqeli *përmus* vras, *përmismë* i rrëzuar, *përmisurë* shkarë, rrëshqitur, *përmbysem* bie përmbys; *përmbytëje*. Të gjitha këto kuptime, sidomos "kthej përmbys, e përmbys, përplas" bashkohen me kuptimin e trajtës së thjeshtë (*mbyt*) nën një kuptim bazë "rrah, i bie, e godit, e rrëzoj e përplas = e shtroj përdhe"). Ka mundësi, pra, që kjo fjalë të ketë të bëjë me lat. *confūtare* me rrëzue, me përmbysë, me rrahë, island. e vj. *bauta* me rrahë, me shty, gjerm. e vj. e lartë *bōgzan* idem, dhe më larg lat. *battuo* (cf. Walde, E.W. 137, 63, 2 185, 85, Fick 3^4, 274).

m i h gërmoj, rrëmoj tokën; - m ë s t ë adv. *m ë z a j* (në fjalët *n j i m ë s t ë, n j i m ë z a j* njëfish, *d y m ë z a j* dyfish)

mih: e afërt me got. *maitan* me gdhëndë, me pre, gjerm. e vj. e lartë *meiʒan* idem, *meiʒil* daltë. Raportin që ekziston midis kuptimevet daltoj, pres dhe mih, gërmoj, rrëmih e gjejmë dhe në shq. *grinj*: *gryenj* gërmoj, *grienj arënë* hap dhe të ri (Meyer E.W. 130). *gryenj* i përgjigjet, pra, në kuptimin e saj plotësisht fjalës *mih*, për të cilën Bashkimi 266 jep kuptimin rrëmih me shatë. Vegla primitive të të prerit shërbenin njëkohësisht edhe për të prerë, për të gërryer e për të rrëmihur (Walde, E.W. 2, 127). Ky konstatim vërtetohet më së miri nga këto familje fjalësh që përmëndmë këtu. Nga pikëpamja e historisë së kulturës materiale te shpjegimi i kuptimit që ka familja e fjalës *mih* në shqipet le të kemi parasysh edhe këtë që punimi i tokës me shatë paraqet një nga format më të lashta të ekonomisë (Ed. Hahn, Die Haustiere und ihre Beziehung zur Wirtschaft des Menschen, f. 388 vv., Das Alter der wirtschaft. Kultur, f. 54 vv.; Schrader, Reallexicon, f. 11), që prandaj filli i kuptimevet: çaj (got. *maitan*) *mih*, rrëmih tokën (shq. *mih*) kuptohet mirëfilli nga ana materiale. Meqë mbaresa *h* ka dalë nga një *-skō* (Brugmann, Grundriss 1, ^{2}758, Meyer E.W. 314 s.v. njof), si bazë e fjalës shqipe na del

mid-skō̂. Këtu e kanë vendin dhe numërorët *njëmëstë, dymëstë* i njëfishtë, i dyfishtë adv. *njëmëzaj*, *dymëzaj* (Pekmezi, Gr. 126). *-mëstë*, *-mëzaj* (me *ë* në silabë të patheksuar) hyn në grupin që trajtuam këtu më lart, ashtu si lat. *duplex* gr. *δίπλαξ*: *plango* rrah, gr. *πλάζω* (Walde E.W. 472, 188 ^{2}588, 247). Edhe në let. për "njëfish" thonë *wîńkart*, për "dyfish" *diwkart* ku *kart* i përgjigjet lit. *kařtas* një e goditur, një herë (=sll. e vj kisht. *kratъ*, çek. *-krát* herë).

m j e r g u l l ë, m j e g u l l ë

Meyer-i, E.W. 283 këto forma i barazon me geg. *njegull* nga lat. *nebulla*, në mënyrë që sipas tij *nj*-ja u bë *mj*, duke shkuar nëpërmes të një *mnj*-je; dhe ai thotë se një fjalë vendi e afërt me lit. *myglà*, sllav. *mьgla*, mund të ketë influencuar. Mirëpo me këtë mbetet e pashpjeguar *r*-ja në *mjergullë* – Brugmann, Grundriss 2/1^{2}, 362 e veçoi *mjegullë*-n nga lat. *nebula* dhe e merr për fjalë autoktone të shqipes, besojmë se me të drejtë. Veçse krahasimi që ai bën me gr. *ὀμίχλη*, lit. *miglà* (*myglà*) ndeshet në disa vështirësi të natyrës fonetike, dhe ja sepse: ose *mjegullë* ka pasur që në të parë një grup *-gl-*, dhe atëherë do të prsni një trajtë më *-gl-*, *-gj-*, ose *g*-ja dhe *l*-ja kanë qënë në *mjegullë* të ndara që në ballë me një vokal, dhe atëherë pritej që *g*-ja midis vokales të kish rënë. Edhe vokalizmi i fjalës së shqipes nuk i përgjigjet lit. *miglà* etj. Mundet që në sqarimin e kësaj fjale të na vijë në ndihmë ky fakt. Psalmin 97, 2 ("re dhe errësirë ka rreth tij", te Luter-i) Kristoforidhi e përkthen kështu: *rē edhe mjergullë është rreth atī*. Në biblën çeke të vëllez. ky vënd është përkthyer kështu: *oblak a mrákota jest vůkol něho*. Këto dy fjalë të një kuptimi etmilogjikisht lidhen: shq. *mjergullë* çek. *mrákota* nga një sll. e përbashkët *mork-*. Në punë të guturalit shqipja vërtet që nga sllavishtja largohet, po afrohet me refleksin e këtij grupi nëpër gjuhët gjermanike: nord. e vj. *myrkr* errësirë (Fick. 3^{4}, 313; Kern, I. F. 4, 108; Osthoff, po aty 8, 12 shën; Solmsen, K.Z. 34, 27). Edhe kuptimin "mjegull" që e ka fjala e shqipes përveç kuptimit "errësinë" e gjejmë edhe në gjuhët sllave: rus. *mórokъ* errësirë, mjegull e dendur, çek. *mrákotný* i errët, mjegullor. Nga *mjergullë* u bë *mjegullë* po ashtu si nga *largoj* trajta. *lagoj* me të njëjtin kuptim, që e ka Bashkimi f. 222. Në pikëpamje morfologjike përpara sufiksit *-lā* do të admetojmë që në trung të fjalës ka pasur një vokal, cilësinë e tij nuk mund ta caktojmë më; *u*-ja u sajua pas guturalit.

m o r r

Afrohet me ind. e vj. *marcáyati* e rrezikon, e ha, e dëmton, *marká-ḥ* të vdekurit, vdekja, lit. *pasmeřkt* me prishë, me shkatërrue. Zhvillimi i kuptimit është po ai që shohim në gr. *φθείρ* morr: *φθείρω* prish. *rr*-ja dolli nga *rk*-ja ashtu si në *sorrë*: lit. *szárka* etj. (Pedersen, K.Z. 36, 337). *o*-ja në trung të fjalës na shpie te një shtoston i dikurshëm, po ashtu si në fjalën *sorrë*.

m u n d

Meyer-i, E.W. 291, këtë fjalë e bashkon vetëm me got. *mundrej* qëllim, gjerm. e vj. e lartë *muntar*, gjerm. e sotme *mutnar* zgjuar, i gjallë, lit. *mundrùs* idem, duke përjashtuar nga ky grup sllav. e vj. kishtare *mǫdru* i urtë, me mend lit. *mandrùs* nadan, krenar. Mirëpo got. *mundrei*, gjerm. e vj. e lartë *muntar* hyjnë patjetër në tokun e fjalëvet balto-sllave që u përmendnë këtu më lart me të cilat bashkohen nën një bazë *men-dh-.* Po kjo gjë vlen dhe për verbin e shqipes. *-und* ka dalë nga një *-n̥d*, ka të ngjarë që nëpërmes të një trajte së ndërmjeme *-ënd*, ashtu si dhe në *grundë* (sh. më lart), në *shtrungë*, në *tund* (sh. më poshtë).

n d a j pranë, afër; karshi, në krahasim me

Një vështrim të përgjithshëm mbi përdorimin e këtij jo të vërtetë, po të ashtuquajtur prepozicioni na e jep Pedersen-i, Alb. Texte 166. Po aty theksohet dhe ndryshimi që ekziston te ky në regjim të rasës. Përveç viseve që janë cituar m'atë vënd si shembuj meritojnë të përmënden dhe këto. *Zoti është ndaj gjithë atyre* (Kristoforidhi, ps. 145, 18). *A viteniu ndaj mue* – accedite ad me (Bogdani, Cun. proph. I, 15, 16). Pekmezi, Gram. 209 ka geg. *ndaj*, *ndej* "në krahasim me" përdorur me akuzativ. Pedersen-i, loc. cit., përveç shprehjeve si *ndaj natë, ndaj ditë*, të cilat përkojnë, pra, me ato që shënon dhe Pekmezi, thekson dhe të tjera si *ndaj kishet* apud ecclesiam (Bardhi), *ndaj kalit* vicin del cavallo (De Rada) – ndërtime që janë prapë analoge me ato që cituam më sipër prej

Kristoforidhit e Bogdanit, dhe rasat *kishet, kalit* i quan dative. Pas analizës etimologjike që po japim këtu këto rasa si gjenitive si dative adnominale (cf. gr. *γραμματεὺς τῆς βουλῆ* shkronjës i kshillit lat. *opercula doliis*, ësht' i zhvilluar sidomos në sllavishtet: *vьsěmъ rabъ*, gjerm. e vj. e lartë *ein vorlouf allen:* Brugmannn, Kl. vgl. Gram 434: Vondrák, Vgl. sl. Gr. 2, 365 v). Po kjo çështje nga pikëpamja interne e shqipes natyrisht që as nuk shtrohet. Sinonime me *ndaj* është *ndanë* adv. afër, pranë, prepozicion me gjenitiv pranë, nga ana, një fjalë kjo që Meyer-i, E.W. 11 e lidh me të drejtë me *anë*. Fjalët *ndaj* e *ndanë* duan afruar edhe nga ana e etimologjisë, *ndaj* nga **nd-anį̄*, si një lokativ i hershëm. Për një refleks të lokativit në gjuhën shqipe sh. Pedersen, K.Z. 36, 310 dhe Rom. Jahresber. 9 (1905), I, 209, ku *mali*, gjenitivi i paskajuar i fjalës *mal*, konsiderohet si lokativ më -*eĩ* ose -*oĩ*. Kjo *anį̄* që ndërtuam ne këtu ndryshon nga *mali* vetëm në trajtimin e *į̄*-së, trajtim që lidhet me punën e sandhit. Përdorimi me akuzativ do të ketë ardhur nga ndikimi që kanë ushtruar prepozicionet e tjera.

ndjer, ngjer, ngjera, njer, gjer, deri

Përveç këtyre trajtavet që ka Meyer-i, E.W. 299, gjejmë edhe këto: *ndjerë* (Bardhi 21, Bogdani, Cun. proph. I. 4, 14, 82); *njera* (Pedersen, Alb. Texte 171), *gjerë* (te Meyer-i, E.W. 139 e pashpjeguar) *gjer*, *ngjeç*, *ndy*, *ndyç* (Kristoforidhi, Fjalori 79). *Ndjerë, deri*, megjithë format e tjera që cituam këtu në krye është shq. *inj* deri nga një **enį̄* (Meyer, E.W. 159), gr. *ἐν,* lat. *in*, gjermanik. *in*, lit. *ĩn, į̃* etj. si një **entero*-. Një paralele nga ana semantike e gjejmë në gr. *œστε*, lokr. delf. *ἔντε* deri, e cila, sado të ndryshme që të jenë intepretimet e kësaj fjale (cf. Brugmann, I.F. 14, 72, po ndryshe, sa për pjesën e saj të dytë, Thumb, K.Z. 36, 199, prapë ndryshe Günther, I.F. 20, 11 v), si pjesë të parë përmban një prepozicion me funksion lokal. Një analog të *ndjerë*, nga një *entero*, si nga ana morfologjike si nga ana e theksit e gjejmë në *pështjerë* poshtë thellë, një fjalë që e ndeshim që te monumenti më i parë i gjuhës shqipe, te përkthimi i Biblës prej Buzukut, Mbretërit 3, 17, 23 (botuar në të përkohshmen Tomori, Nr. 12); e ka edhe Bogdani, Cun. proph. I. 34, 8, shkruar *peſctierè* (te Meyer-i fjala mungon). Jo vetëm *è*-ja fundore duhet kënduar *ë*, po edhe *e*-ja e silabës së parë: sepse Bogdani shkruan shpeshherë gabimisht *e* për *è* (=*ë*), p.sh. *delij-*

runė loc. cit. I; 34,7 (tosk. *dëlir*, geg. *dlir*), *njerëzitė* loc. cit. 34, 8 (tosk. *njerëzit*, geg. *nierzit*), *ghezojnė* po aty (tosk. *gëzoj*, geg. *gzoj*). Kjo fjalë ka të bëjë me *poshtë*, *përposh* (mbi të cilën flet Pedersen-i, Alb. Texte 180, K.Z. 36, 290): *-posh* nga **pēd-su* ndër këmbë. Baza e *peſctierė* (=*pështierë*) është me një formë ideale, *pēd-s-t-ero*. Po në fakt duhet nisur nga *poshtë*. Te fjala *ndjerë ndj*-ja u bë *ngj* (cf. Pedersen, Alb. Texte 128, s.v. *gjekët*). *ngjeç* u përftua nga *ngjer ç*, ku *ç* është përemri pyetës. Sa për zhdukjen e *r*-së sh. më lart te *buzë*. Trajta *der* që e ka Shkodra (Kristoforidhi 79) duhet venduar edhe kjo këtu, sidomos për punë të fjalëvet *ndy*, *ndyç*, që i përmendmë më lart. Siç dihet, në shkodrançen shpeshherë nuk kryhet palatalizimi i *e*-së, cf. shkodr. *dhet* përkundrejt tosk. *dhjetë*. Sa për *d*-në fillestare në *der*, nga **en-t-ero* khs. shëmbujt që u dhanë më sipër (te *laj*) për *blē*: geg. *digjoj* pastaj *bëleth* (Kavalioti), Shkodr. *Binem* etj. Po kështu ka dalë trajta *gjer* nga *ngjer*. Prandaj edhe është gjë fort e dyshimtë që sinonomi *deri* të jetë marrë nga jashtë. Këtë Miklosich-i si me dyshim pat pranuar që shq. *deri* ridhte nga sllav. serb.-sllav. e vj. kishtare, kroat *deri*), për shkak të *ndjerë* – trajtat e tjera nuk njiheshin atëherë (Alb. Forch. I. 18). Meyer-i ndoqi mendimin e Miklosich-it (E.W. 293). Mbase kemi të bëjmë vetëm me një influencim të fjalës së vëndit nga fjala e sllavishtes në punë të mbaresës *i*, sadoqë edhe ky supozim nuk është i domosdoshëm (khs. p.sh. *derë*, A. St. 6, 35, *i*-ja fundore hyri për *ë*-në, si në lidhëzen *qi*). Dubleta të trajtavet që nisin me *gj* janë *qyç*, *qyr*; *q*-ja këtu qëndron në vënd të *gj*-së, siç ngjan zakonisht (cf. *gjuaj* – *quaj*, *gjedhe* – *qedhe*). Për vokalin e *qyç*, *qyr*, *ndyç*, *ndy* – kemi të bëjmë këtu në forma të gegërishtes – khs. geg. *nye* përbri tosk. *nē*, *nejë*, nga lat. *nōdus*.

n d i e h gjindem, *n d e s h* përpiqem me

(Bashkimi 303, 302; Jungg, Fjal. 90) Kjo fjalë afrohet me sllav. e vj. kishtare *dešǫ*, *desiti*, sll. kisht. e rusisht *došu*, *dositi* (edhe *dešu*, *desiti*) me hasë, serbokr. *dësīm dèsiti*, me ndeshë, çek. *podesiti*, *udesiti* me i a mbërrijtë, me e kapë. Konkordanca semantike e fjalës së shqipes me të sllavishtes është e përplotë. Nga ndryshimi që ekzsiton midis të dy verbeve që u përmëndnë në krye dhe nga forma autonome që paraqet verbi *ndjeh* del se as nuk duhet ta mendojmë që shqipja këto fjalë t'i ketë marrë prej sllavishtes. *sh*-ja e

shqipes në *ndesh* dhe *s*-ja sllave në *desiti* mund të bashkohen vetëm nën një indoeur. *s*. Kjo na vërteton që sllav. *desiti* më mirë nga të gjitha është ta afrojmë duke ndjekur Pedersen-in, I. F. 5, 47, me gr. *δήω* do të gjej. Këtë interpretim edhe nga ana e kuptimit ta do mëndja më shumë sesa afrimin e desiti me gr. *δέκομαι* pranoj, ind. e vj. *syáti* i bën një nder, lat. *decet* ka hie (cf. Fick, I. 4, 234, Walde, E.W. 168, ^{2}223; Berneker, E.W. 188). Veçse në sllavishtet mundet që të jenë tretur du verbe në një. Le të kemi parasysh kuptimet e larga të serbokr. *Udèsiti* me ndreqë, me goditë (që i përgjigjet lat. *decet* me gjithë farefis, 2) godit, ndesh më një, përpiqem me një që puqet krejt me shq. *ndesh* dhe afrohet fort dhe me kuptimin e gr. *δήω*. *e*-ja në shq. *ndesh* shpjegohet mirëfilli po të kemi parasysh *ndjer*; sipas Krstoforidhit f. 272 kjo fjalë përdoret në Shkodër e në rrethet e saj. Shq. *ndieh* na paraqet të njëjtën mabaresë që ka *mih*, *njeh*; pra rrjedh nga nje *des-skô̄*.

n d j e t ë i urryer; f. urrejtje, të vështirë; *n d o t e m*; geg. *n n ī s h e m*

Të dy fjalët që i cituam në krye i ka Meyer-i, E.W. 302 te *ndŷj*, ku, pa dhënë ndonjë shpjegim, shënon vetëm duhet hedhur poshtë çdo afrim me *ndŷj*. Pa dyshim, Meyer-i këtu ka të drejtë. Geg. *nnīshem* mungon nëpër fjalorë, po e përdor Fishta; Lahuta e Malcís I, 14. Ky grup fjalësh lidhet me *dhjes*, pasivi *dhitem*, të cilat i afrojnë me gr. *χέζω* ind. e vj. *hadati* (Meyer, E.W. 86), Prellwitz, E.W. 2 503). Sa për zhvillimin semantik të *ndjetë* përkundrejt *dhjes* krahaso p.sh. çek. *ohavný,* i ndjetë, sll. kisht *govьno* mut, ind. e vj. *guaváti* cacat. Në pikëpamje morfologjike *ndjetë* lidhet me grupin e abstraktëve verbale dhe adjektivale më -*ta*, për të cilat u fol më sipër te *botë*. Tani na del pyetja sesi qëndron *ndjetë* ndaj *dhjes* në pikëpamje formale. Sikundër që krahas me *thanj* nga **saus-n̥jō̄*: lit. *saũsas*, sllav. e vj. kishtare *suchъ* i thatë (Meyer, E.W. 88), aoristi *thava,* u bë dhe një paritcip *thatë*; kështu dhe krahas me *dhjes* aorist *dhjeva* leu dhe një particip *ndjetë*. Në fund të fundit, pra, një formacion si *ndjetë* i detyrohet faktit që *d*-ja radikale e *dhjes*, nga *ĝhedi̯ō̄*, në aorist doli në mes të fjalës dhe kështu u zhduk rregullisht (veta 3 sing. e aoristit *dhjeu*, Pedersen, Alb. Texte s.v. *luaj*). Kështu shpjegohet tani edhe pasivi *dhitem* i gegërishtes (me geg. *i* nga *ie*); pasivi (refleksivi) i shqipes sajohet duke i ngjitur participit format e verbit *jam* geg. *nnīshem*, nga **ndīshem*, ka dalë ose nga një **ndiet-shëm*. *ndjetë*

(cf. *moshë* përbri *motshë*: *mot*) ose nga një *ndied-shem*, me *d* radikale dhe me trajtim të grupit *dš* si në *përposh*, nga *pēd-su* (Pedersen, K.Z. 36, 290). Nga këto të dyja, për arsye morfologjike ka më të ngjarë që e para të jetë e drejtë. *ndotem* na shpie te një participp me infleksion (ablaut). Në gradën e infleksionit *ndotem* qëndron ndaj *dhjes* me *vdorem* vdirem ndaj *vdjer*.

n g ē shkodr. *n g a e* rast, kohë e lirë, nge

Kuptimet, sipas Kristoforidhit, Fjalori f. 260 (*εὐκαιρία*), Bashkimit 291 (opportunita, l'aver tempo di fare una cosa), Jungg, Fjal. 96 (opportunita). Këta dy fjalorët e fundit na japin trajtën *ngae,* të cilën e gjejmë dhe te Pisko, Handb. d. nordalb. Sprache 129 (*skam ngae* = s'kam kohë = kohë të lirë). Kuptimin që jep Meyer-i (E.W. 305). Kuptimin që e jep Meyer-i (E. W. 305): lit. *gyv-*, sll. e vj. kisht. *živ-*, ind. e vj. *jīv-* me atë gradë infleksioni që ka dhe lit. *gaivus* i gjallë, e refuzon me të drejtë Pedersen-i, K.Z. 36, 325, dhe më të vërtetë, përjashtohet çdo mundësi që *ngae* – dhe Meyer-i vetëm këtë trajtë dinte – t'i përgjigjet në gradë të infleksionit lit. *gaivu* (shq. *e* nga një *ai*). *e*-ja e tosk. *ngē* u sajua në mënyrë sekundare me anë të kontraksionit. Krahaso edhe geg. *roe,* tosk. *re*, geg. *hā̆* hae, nga *hae* (Pekmezi, Gram. 247): tosk *hē*. Vokali *ā̆* i formës *ngae* të gegërishtes është primar dhe këtë e shohim qartë nga trajta e skajuar *ngaja* (Lahuta e Malcís I. f. 11). Po kjo pikë s'na lejon ta afrojmë këtë fjalë me lit. *gaivus* që lidhet te një rrënjë *gᵘeu̯ē-*. Atëherë paraqitet nevoja e një shpjegimi tjetër dhe këtu duhet të kemi parasysh dhe kuptimet e ndryshme. Meyer-i niset nga kuptimi "fuqi, gjallëri", i cili në fjalorët e Jungg-ut, Bashkimit e Kristoforidhit nuk gjindet dhe Meyer-i na e dëshmon vetëm për Skironë, pra, për arbërishten e Italisë. Kuptimi që njihet përgjithësisht në shqipen e Ballkanit është "nga voli, kohë e lirë". Ky kuptim e afron fjalën me sll. e vj. kisht. *godъ* kohë, kohë e volitshme rus. *godъ*. vit, kohë, serbokr. *gôd*. ditë e kremte, vit, rast i volitshëm, *prïgoda* rast, gjerm. e v. e lartë *gigat* i përshtatshëm. Baza e fjalës së shqipes është **gadhā*, me zhdukje të rregullt të okluzivit të tingullt në mes dy vokalesh. Kuptimi "fuqi gjallëri" (Skiro) u zhvillua pastaj po ashtu si në ukr. *hóžyj* (sll. e përbashkët *godъ*) që do të thotë "i freskët, i gjallë" (Berneker, E.W. 318). Këtu hyn edhe verbi

impersonal geg. *ngjend*, që Kristoforidhi në Fjalorin e tij 263 e përkthen me *εὐκαιρῶ*, *ἀδειάζω,* pra, "kam kohë, kam nge, ngehem"). Të njëjtin kuptim e gjejmë dhe në refleksin sllav. të këtij grupi: sll. e vj. kisht. *godъ*, që përveç *ὥρα* kohë, do të thotë edhe *καιρός* kohë e volitshme, *vъgodъ εὐκαίρως* (kjo i përgjigjet në kuptimin plotësisht *ngjend*, *godě byti* me iu përshtatë, çek. *vhod* i volitshëm, i tamamtë, i përshtatshëm, serbokr. *zgöda* rast, rahati. Në pikëpamje morfologjike kemi të bëjmë me një formacion me *-n*, ashtu siç e gjejmë p.sh. dhe në *lind*. (cf. Pedersen, Alb.Texte 12).

n g r i d h e m ethem*: n g r i d h u r ë* era përç, *g ë r d e s* kurvar

ngridhem e ka Reinhold-i, Nocta Pelasgicae, Πρόδρομος Λεξ. 66 dhe pas tij Meyer-i, Alb. St. 5, 97. Në atë vënd ai mendon në një afëri me slloven. *grdệti* se[30] me të ardhë të vështirë. Nga pikëpamja e kuptimit është shumë më afër menç ta lidhim me ind. e vj. *gʰṛdhyati* lakmon, gjakon, *gʰṛdhnúḥ* lakëmeç, dishrak (për këtë familje fjalësh të indishtes së vjetër sh. Uhlenbeck E.W. der ai. Spr. 82). Indishtja e vjetër krahas me rrënjën *gardh-* lakëmoj, gjakoj paraqet edhe një rrënjë sinonime *gard-*: *garda-ḥ* lasciv, lakëmeç (aty f. 78). Sa për mundësinë e një bashkimi më të tejmë të fjalëvet inde që cituam me grupin gjermanik të got. *gredus* uri sh. Feist, E.W. 117 dhe literaturën që përmëndet atje. Baza e fjalës së shqipes është *gʰṛd-.* Zhvillimi i veçantë që ka marrë shq. *ngridhem* në kuptimin të saj, përkundrejt ind. së vj. *gʰṛdhyati* lakëmon, gjakon, kuptohet vetvetiu. Khs. lat. *cupido*: *cupio* lakëmoj, gjakoj. Këtu hyn edhe *gërdës*. kurvar (Reinhold, loc. cit. 64), të cilën Meyer-i, A. St. 5, 77 do ta bashkojë me *gërdís* më vështiroset, shpjegim ky që, nga ana semantike, sigurisht që s'ka sesi të kënaq *-ër* në *gërdës* ka dalë nga *ri*, e kjo nga *ṛ*, siç ka ngjarë shpeshherë.

n g r ī n j, n g r ī, geg. *n g r ĩ, s h k r ī n j, s h k r ī*, geg. *s h k r ĩ*, shkreh

ngrīnj e *shkrinj*, megjithë format sekundare të tyret; i ka Meyer-i E.W. 306 v., kurse formën *shkreh* e gjejmë te Kristoforidhi, Fj. f. 400 (s.v. *shkrîtë*). Nga trajta *shkrīnj* (përbri saj dhe *çkrinj*) shihet që fjala

[30] Pletešnik I, 247 shkruan *grdíti se*.

ka nisur në ballë me *kr*. Atëherë ky grup duhet afruar me rus. *čerstvъ* i ngurtë, i thatë, pa ndjenja, *serstvína* kore, sll. kisht.-rus. *črьstvъ* i ngurtë, solid, serbokr. *čvr̂st* (me metatezë) i fortë, i ngurtë, lat. *crassus* i trashë i majmë i vrazhdë (cf. Walde E.W. 148 [2]198, Berneker 171: baza **qerāt* thur, lidh e bashkoj, mledh top). Që kuptimi thelb i grupit të fjalëvet të shqipes është "i fortë, i ngurtë" këtë e shohim nga kjo që edhe kuptimi "ngrij" edhe kuptimi "shkrij" dalin vetëm në trajtat e ngjitura me prepozicion. Edhe nga shprehja e gegërishtes që përmënd Kristoforidhi f. 110 *âshtë ngrīm e âshtë bāmë shtank* ngrin (nga një frikë e përnjëhershme) na del edhe sot kuptimi bazë. Një paralele ekzakte për zhvillimin semantik "fortohem, ngrij" na e jep greqishtja: gr. e re *παγώνω* ngrij, dhe gr. e vj. *πάγος* akull, ngricë: *πήγνυμι* ngul, *πηγός* i fortë i shëndoshë, *âshtë ngrim* = gr. e re *ξεπαγιάζει.* Edhe rus. *čerstvína* kore që cituam më lart është interesante, në lidhje me punën e kuptimit, për grupin e fjalëvet të shqipes që trajtuam këtu dhe për kuptimet "ngrij, shkrij", që kanë këto: khs. lat. *crusta*: gr. *κρύος* ngricë *κρύσταλλος* akull. Për konstatimin e bazës së fjalës shqipe ka rëndësi fjala *shkreh* (që mungon te Meyer-i, po e ka Kristoforidhi), sepse nga *shkreh* arrihet te *ngrinj*, jo anasjelltas. Baza e *sh-kreh* është **kret-sk̂ō. ngrinj*, *shkrinj* nga **kret-nį̄ō* ashtu si *vinj* nga lat. *venio*.

n g r y s, n g r i s, n g r y s e m, n g r i s e t ë, u n g r i s

Kjo fjalë që te Meyer-i ka mbetur pa shpjeguar afrohet me lat. *creper* i mungët, errët, *crepusculum* të mugëtit. Edhe për fjalën latine gjer më sot nuk ka një shpjegim të kënaqshëm (cf. Walde E.W.[1] e [2]). Baza e fjalës së shqipes është **n-kŗp-tį̄o-*. Grupi *pt* shtrohet e thjeshtohet në *t*: khs. *shtatë*, nga *septṃ̀ti* (G. Meyer, A. St. 3, 33; Brugmannn, Gr. 1[2] 722), përmbi ndrimin e *pt* në *t* flet posaçërisht Pedersen-i, K.Z. 36, 325. Khs. dhe *latë* më sipër (te *lapë*). Për një formacion analog sh. te fjala *rras*.

n g j e l b ë t ë, n g j e l m ë t ë i kripur

Pedersen-i, K.Z. 36, 285, i cili pati parasysh vetëm trajtën *njelm* që e ka Pisko 147 me Jungg-un 88 e me Albaninë II 157, e pa mundësinë e ekzistencës së një forme më të vjetër *ngjelm* dhe që kështu kjo fjalë mund të afrohet ma lat. *sal*. Trajtën *ngjelbetë* na e dëshmon tani përnjëmënd Kristoforidhi, Fjalori f. 262, për Tiranë. Kristoforidhi Loc. cit. 263 na jep trajtën *ngjelmetë* edhe për Shkodër, po kjo, në bazë të dëshmive të Piskos, Jungg-ut si dhe të Bashkimit 146, dëshmi që konkordojnë në mes të tyre duke na dhënë të gjithë një trajtë me *nj-* iniciale, nuk do të jetë ekzakte. Sidoqoftë, trajta që na dëshmohet për Tiranë vërteton interpretimin që jep Pederseni, i cili, përveç kësaj, kish pasur parasysh edhe trajtën me *ngj-* iniciale që i qe dëshmuar gojarisht për Shqipërinë e Mesme. Në *njelm* nga një *n-sal-mo*, kemi sufiksin *-mo* që e gjejmë dhe në gr. *ἅλμη*. *e*-ja ka dalë nga një *a* nën influencën e *l*-së që vjen pas, e cila ka për efekt umlautin (për këtë gjë sh. Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss 1^2, 1042 vv.) khs. *helm,* gjerm. e vj. e lartë *scalmo* murtajë, *elp,* gr. *ἅλφι. ngjelbëtë* ka sufiks *-bho-*, për të cilin sh. Brugmann, Grundriss $2/1^2$, 388. sh. dhe më poshtë, te *shkelm*, *shkelë*.

n u s fill, gjalmë

Këtë fjalë Meyer-i, E.W. 312 na e dëshmon vetëm për shq. e Italisë, dhe shpjegim etimologjik nuk jep. Po tani këtë e gjejmë dhe te Bashkimi 309. *nus* hyn në familjen e lat. *neo*, *nēre* gr. *νέω* tjerr, *νῆμα* tjerrë, fill; rrënja është **snē*, po krahas me këtë ka dhe rrënjë paralele në indoeur.: **snēu-*, që e gjejmë në island. e vj. *snūa* me dredhë, sllav. e vj. kisht. *snujǫ*, *snovati* me endë, let. *snaujis*, lak, ind. e vj. *snutáḥ* prej dellit (p.sh. Walde, E.W. 410, ^{2}514). Kështu fjala e shqipes paraqet atë gradë të infleksionit që ka fjala sanskrite. Për nga ana e morfologjisë khs. sll. e vj. kisht. *nitь* fill, tërkuzë (që na shpie te një rrënjë **snēi-*), ndërsa *nus* rrjedh nga *nu-ṭio-*. Nga pikëpamja e kuptimit shq. *nus*. qëndron ndaj isl. së vj. *snūa* me dredhë si gjerm. e vj. e lartë *drāt* fill ndaj gjerm. së vj. të lartë *drāen*, gjerm. e sotme *drehen* me dredhë.

njollë

Kjo fjalë mungon te Meyer-i, po e gjejmë të përdorur te revista Diturija (Selanik) I. f. 60 shtylla 1 e ka Kristoforidhi (f. 287) me Bashkimin (f. 148). Meqë *nj*-ja mund të ketë dalë nga një *ngj* (sh. vërejtjet që bën Pedersen-i K.Z. 36, 285 rreth fjalës *njelm*), na jepet mundësia ta afrojmë me gjerm. e vj. të lartë *salo*, *sal(a)wêr* me ngjyrë të thellë, të mbyllët, e ndyrë, anglos. *salo* me ngyrë të thellë, island. *sölr* e verdhë, e ndyrë (baza gjermanike *salva*-), rus. *solovój* e verdhë (për kuaj), isl. *salach* i ndyrë (për grupin e fjalëvet gjermanike sh. Fick, 3^4, 437). Shq. *njollë*, nga *n-sāl-v-*, në vokalizëm afrohet me gjerm. e ulët *saul* i ndyrë, si me blozë (= saks. e vj. **sōl*), e cila edhe kjo hyn në këtë grup që trajtuam këtu (Holthausen, I. F. 25, 150). *lv*- dha *ll*, si zakonisht në gjuhën shqipe.

njomë, ngjomë, nglomë; njom lag, rij, u jap ujë kafshëve

Një rrugë për të shpjeguar etimologjikisht këtë grup fjalësh që ka mbetur pa shpjeguar te Meyer-i E.W. 314 na e çel forma *nglomë* që na jep Kristoforidhi f. 264 për çamërishtën e që Meyer-i në kohën e tij nuk e dinte. Si u sqarua kështu fillimi i fjalës, kjo hyn në grupin e sll. kisht. ruse *glěnъ* jargë, lëng ngjitës, rus. *glěnь* lëng, slloven. *glen* jargë, baltë, llucë etj., lit. *glẽma* jargë ngjitëse, *gléima*, *glemẽsa* idem (Juškevič, Slov. I, gr. *γλοιός* vaj i ndyrë ngjitës, lëng që të ngjitet, anglos. *clœm* ledh, baltë (rrënja indoeuropiane *glēi*-, cf. Wood, I. F. 18, 43; Siebs, K.Z. 37, 34; Meillet, M. S. L. 8, 298; Berneker, E.W. 310, 303; Fick 3^4, 57). Sa për kuptimin e fjalës së shqipes ("i lagët") përkundrejt kuptimit që paraqesin fjalët që sapo cituam këtu nga të tjerat gjuhë indoeuropiane ("që të ngjitet ndër duar, baltik") khs. çek. *vazký* i njomë i ritë, përkundrejt rus. *vjazkij* që të ngjitet, ngjitës, baltik. Nga një kuptim i parë "si jargë" (prej nga dolli "pak i lagët, i njomë, i ritë") u zhvillua kollaj pastaj kuptimi "delikat, i njomë". Krahaso për këtë gjë gjerm. e mesme të lartë *kleine* i pastër, i hieshëm, i njomë, gjerm. e sotme *klein* i vogël (në themel "i lyer, lyer me dhjamë", Kluge, E.W. 7, 274), një fjalë kjo që etimologjikisht hyn në grupin që trajtuam këtu më lart. Baza e fjalës së shqipes – **glēmo*. Pra, fjala shqipe afrohet në punë të infleksionit (ablautit) dhe të përbërjes së saj sidomos në lit. *glẽma*.

p a l ë anë, parti; klasë, seksion

Këtë fjalë me kuptimin "anë, parti" e përdor p.sh. Lirija, nr. 76, f. 2 dhe Tomorri, nr. 2, f. 4 (Jeta e Piros, Kap. 5, përkthyer prej Dokë Sulës). Kuptimin "klasë, seksion" e ka Bashkimi f. 312. Te Meyer-i, E.W. kjo fjalë mungon; sepse fjala palë "e thyer e rrotës, radhë, zgjedhë, çift, varg me fiq të thatë" duket sheshit edhe nga kuptimi që s'është një me të, dhe, përveç kësaj, siç del nga grafia e Bashkimit në shqiptimin e gegërishtes, të dy fjalët ndryshojnë. Sepse palën e rrobës Bashkimi 317 e shkruan *pale* kurse palën që vumë ne në ballë të këtij artikulli ai në f. 312 e shkruan *paal*. Për të njëjtat arsye nuk ka sesi që fjala të jetë identike me *parë par*, çift, nga lat. *par*, përbri së cilës ka dhe *palë* (p.sh. te Lirija, nr. 70, f. 1; Tomori, Nr. 11, f. 3, shtylla 1; khs. dhe Kristoforidhin, Fjalori 300). Sa për anën e kuptimit khs. ato që shënon Walde (E.W. 449, ^{2}561) rreth përpjekjeve që janë bërë për të lidhur lat. *par pars*. E sa për shqiptimin e gegërishtes sh. Bashkimin 312: *paal*, *paala* parti, *paal paala* par, çift. *palë* anë, seksion (geg. *pāl,* e shquar *pala*) është qartë që lidhet me sllav. Kisht. *polъ* anë, breg, fis, gjysmë. Meqë palë ka *l*, dhe këtë e ka dhe në shkodranishten, duhet si *l* bazë të admetojmë jo një *-l-* intervokalike dhe as një *-l̨i-*, po një *-ln-*. Pra, kjo fjalë duhet marrë më mirë si një formë participiale më *-n*, e cila bashkë me sll. *polъ* do afruar, siç duket, me rrënjën **(s)phel-* (ind. e vj. *phálati* pëlcet, çahet më dysh*, phā́la-ḥ* pluar, cumb, sllav e vj. kisht. *plěi*, rus. *polótь* me herrë (barërat), got. *spilda* dërrasë për të shkruar, gjerm. e vj. e lartë *spaltan*, gjerm. e sotme *spalten* me ça etj) (cf. Fick. 3,^{4}511: Walde, E.W. 549, ^{2}732). Sa për zhvillimin kuptimor "anë, palë, gjysmë-çaj" khs. got. *halbs*, gjerm. e sotma *halb* gjysmë, gjerm. e vj. e lartë *halba* anë, drejtim, nord. e vj. *halfa* gjysma, pjesë, anë, palë, gjerm. e vj. e lartë *halba* anë, drejtim: lat. *scalpo* me pre, me daltue me një vegël, me gdhendë, me krue, me gërvishtë (Fick 3, ^{4}85, Walde, E.W. 549, ^{2}682). Për të tjera reflekse të rrënjës *(s)phel-* në gjuhën shqipe sh. te fjalët *plis* dhe *popëlë*.

Tosk. *p e n d ë*, *p ë n d ë*, geg. *p ê n d ë*, *p ê n n ë*, pëndë qe, ditar (toe); *p e n k* zagarë të lidhur bashkë

Nga këto fjalë Meyer-i (E.W. 326) të parën e bashkon me *pendë* e zogut, krah, nga lat. *penna* pendë. Mirëpo kuptimet e këtyre janë larg shumë njeri nga tjetri: më një anë "pendë qe, ditar toke", më anë tjetër "pendë (e zogut), krah", dhe kjo nuk është në favor të atij interpretimi. Përveç kësaj *penna* (respektivisht *pinna*) në asnjë vënd të gjuhëvet romane nuk ka kuptimin "pendë qe, ditar toke"[31]. Fjala e shqipes përkundrazi afrohet me lit. *spandyti* me nde, *pinnù*, *pìnti*, sllav. e vj. kisht. *pęti* me ndehë, me ngrehë, sll. e vj. kisht. *pǫto* zinxhir, verigë. Pra, baza e fjalës së shqipes është "gjë e ngrehur, pendë qe". Sa për zhvillimin semantik "çift qe, çift", khs. ind. e vj. *yugám* zgjedhë, çift, pastaj frëngj. *couple* çift (në të vërtetë "zagarë të lidhur bashkë": lat. *copula*). Zhvillmi i mëtejmë i kuptimit gjer në "ditar toke" (si masë) ka një analogji në gjerm. *Joch* zgjedhë, ditar toke, lat. *iugera*. Nga pikëpamja morfologjike kemi të bëjmë me një formë më *-tā*; nga ato që trajtuam më lart te fjalët botë, latë (khs. sllav. e vj. kisht. *vrъsta*. lat. *repulsa* etj). Nga pikëpamja fonetike është e vërtetë që nuk do të kish asnjë vështirësi që ta konsideronim *pëndë* huazim nga sllav. *pǫto* (sa për tingujt khs. *pëndar* bekçi arash e vreshtash, pojak, nga sllav. e vj. kisht. *pǫdar*, Meyer, E.W. 332; më shumë do të flitet për këtë te huazimet, te fjala thëngjill). Mirëpo janë dy momente që flasin kundër një mendimi të këtillë: 1. kuptimi i fjalës së shqipes që është zhvilluar posaçërisht nga jashtë dhe që s'ka as analogji përbrënda gjuhëvet sllave; 2. është ekzistenca e fjalës *penk* m. zagarë të lidhur bashkë që do ta shqyrtojmë tani. Këtë fjalë e ka Pekmezi, Grammatik 266;[32] po ta lidhim te baza indoeur. **(s)pen-* që trajtuam këtu, kjo fjalë gjen sinonime të plota në rus. *púto* zagarë të lidhur bashkë, litar, lit. *pántis* litar për t'i lidhur këmbët bagëtisë. Në pikëpamje morfologjike *penk* është

[31] Për zhvillimin e kuptimevet në gjuhët romane sh. Gröber, Arch. lat. Lexicogr. 4,437; Meyer-Lübke, Zeitschr. f. rom. Plil. 24, 403 v.; Puşcariu, ibidem 28, 682 v.

[32] Meyer-i, E.W. 327 shënon vetëm fjalën *pengë* qapat që i vihen kalit, pengesë, sipas Bardhit, dhe këtë e nxjerr nga lat. *pedica*. Për vështirësitë që has ky shpjegim sh. Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss 1^2, 1050. Edhe më të mëdha janë natyrisht vështirësitë po të duam ta nxjerrim *penk*-un nga *pedica*.

e pajisur me sufiks -*k*, ashtu si *byk* (sh. më lart), *ujkth* bashkë lesh (sh. më poshtë). *e* u përftua përpara një nazali plus një eksplozivi, ashtu si në *vënt*. Kështu të dy fjalët e trajtuara këtu, *pendë* e *penk*, e mbështetin njëra tejtrën. Pastaj, pas *penk* do të jetë formuar edhe *pengë*, siç gjejmë përgjithësisht feminina krahas me shumë maskulina, si *lot*, *lotë*, *djep – djepe*, *djebë*. Më vonë, nga verbi denominativ *pengonj* erdhnë e u formuan abstraktët *pengesë* zinxhir pengimi, rryp pengimi, *pengim* (khs. rus. *púty* litar zinxhirë). Le të shënojmë dhe këtë që Kristoforidhi, përveç fjalës *pëndar* të tosk., që do të thotë pojak, bekçi arash e vreshtash, Meyer-i në E.W. vetëm këtë shënon – ka edhe një geg. *pëndar* bujk, i zoti i një pënde qesh (*γεωργός*, *ζευγίτης*). Natyrisht që kjo nuk mund të ndahet nga *pënda* jonë, *τὸ ζευγάρι τῶν βοῶν*, pra s'ka të bëjë aspak me tosk. *pëndar*, që vjen nga sllavishtja.

p i l l ë vegël për të krehur a për të lënurë lirin; ajo që kreh e lënur lirin; *p j e k ë t ë* qërpikët

pillë mungon te Meyer-i, po na e dëshmon Krstoforidhi, f. 326, për Berat, si dhe Bashkimi, f. 351. Fjala ka të bëjë me gr. *πέκτω* kreh, qeth, lat. *pecto* kreh, lit. *pèszti* me ndukë, me ndukë për flokësh, gjerm. e vj. e lartë *fahs* flokë, leshra etj. Baza e fjalës së shqipes është **pek̂-lā; i* nga një *ie* përpara dy konsonantesh; -*k̂l*- pati po atë trajtim që pati -*sl*- (si p.sh. në *kollë*). -*lā* është sufiksi indoeuropian që formon nomina instrumenti (emra veglash), khs. sll. kisht. *greblo* lugatë, lat. *pīlum* shtypës, dorë e havanit (Brugmann, Grundriss 2/1, [1]364 vv.). Kuptimi që ka fjala e shqipes tregon që kjo nuk vjen as nga altinishtja *pīlum* dorë e havanit, as nga sllav. *pila* sharrë. Në të njëjtën familje hyn fjala *pjekëtë* qerpikët (Pedersen, Alb. Texte, f. 32, 178), e cila me kuptimin e saj piqet më së miri me ind. e vj. *pakṣman* qerpikë, flokë. Po kurse ky grup fjalësh në gjuhët satem ka *k̂* (khs. sidomos lit. *pèszti,* avest. *pašnəm* qepallë), shq. *pjekëtë* ka *k* velare. Pra, ka të ngjarë që kemi të bëjmë me një fjalë të marrë hua nga një gjuhë centum.

p j e k prek, takoj, i bie, e godit

Kuptimi "i bie, rrah" është kuptimi bazë, siç e vërteton dhe Pederseni, Alb. Texte 178. Afrimi që bën Meyer-i (E.W. 341) me lat. *plecto* duhet lënë mënjanë, meqë *pl*-ja ruhet në shumicën e dialektevet të shqipes dhe më anë tjetër *pj*-ja fillestare në *pjek* është e shqipes së përbashkët. Këtu do të kemi të bëjmë me një metatezë të **kep-,* pra, do ta afrojmë me gr. *κόπτω* e godit, i bie. Krahaso fenomenin analog në gr. *ἀρτοκόπος* furrxhi: *πέσσω*, nga *peq̑u̯i̯ō* pjek, pastaj, siç duket, edhe lit. *kepù* pjek – sllav. *pekǫ* pjek. Për këto lloj metateza flasin më shumë në këto kohët e fundit Niedermann, I. F. 26, 45 v. e Hirt, I. F. 21, 171. Refleksi shqiptar i këtij grupi, në trajtën e tij të pandrruar, d.m.th. pa pësuar metatezë, u pa më lart, te fjala *kmesë.*

p l a f mbulesë leshi e larme; *p l ë h u r ë, p ë l h u r ë, p l u h u r ë, p ë l u r ë* beze e ashpër, pëlhurë bankash

Meyer-i, E.W. 343 me të drejtë *plaf* e *pëlhurë* i ka afruar njërën me tjetrën. Tani, duke u vërtetuar një farefis i *plaf*-it përbrënda shqipes, bie vetvetiu mendimi që kjo të ketë ardhur nga slloven., kroat. *plahta* çarçaf i dyshekut, mbulesë e tryezës, mendon që Meyer-i e përmënd vërtet, po si të pasigurt, duke theksuar edhe vështirësitë që dalin. Atëherë kemi të drejtë që për *plaf*-in të kërkojmë një vënd përbrënda fushës së visarit autokton të shqipes: lat. *plecto,* gjerm. e vj. e lartë *flihtu, flehtan,* gjerm. e sotme *flechte* thur, gërshetoj, ind. e vj. *prašna-ḥ* thurimë, shportë e thurur etj. *plah* ka dalë nga një *plo*$\hat{k}$*s-qo-* dhe është në themel vazhdimi i një teme më *-s*, të cilën e gjejmë dhe në gr. *πλέκος* n. thurimë, *πλοχμός* gërshetë, nga **ploksmo* (cf. Meillet, MSL ll, 313). Për mënyrën e formimit të fjalës khs. lat. *ēsca* gjellë, lit. *ėška* (ose *ėkas*) hej, kërmë, coftinë nga një *ēd-s-k-*, fjalë që kanë dalë nga një temë më *-s,* të cilën e shohim edhe në lit. *ėdes-is* hej, tagji, sllav. e vj. kishtare *jasli* grazhd, gjerm. e vj. e lartë *ās,* gjerm. e sotme *Aas* kërmë, coftinë (sh. J. Schmidt, Neutra 379). Sa për sufiksin *-k* khs. *byk, penk, ujkth.* Trajtimi i mbaresës është po ai që gjejmë dhe në verbet e shqipes më *-h* (*njoh, mih*). Për anën kuptimore le të krahasojmë çek. *pletivo* pëlhurë: *pletu* thur, pleks.

p l a n k, p l e n g u turp, dhunë, mbarrë

Këtë fjalë që te Meyer-i mungon, e ka Kristoforidhi (f. 331) me Bashkimin (f. 355). Është afëri me lat. *plango* i bie, e godit, island. e vj. *Flekkr* njollë, nishan, gjerm. e sotme *Fleck* njollë, lit. *plega* dajak, ndëshkim trupor. Fjala e shqipes na paraqet një shkallë infleksioni *pleg-* (ose *plëk-*), ashtu si dhe fjalët e gjuhëvet gjermanike që sapo cituam (Për shkallët e ndryshme të infleksionit te ky grup fjalësh sh. Walde E.W. 472, ^{2}588). *e*-ja u zhvillua përpara bazalit një eksploziv, ashtu si në *vent* e në *penk*. Për zhvillimin kuptimor që ka pësuar fjala e shqipes, përveç isl. e vj. *flekkr* khs. dhe gjerm. *Fleck* = njollë dhunë ("njollë në nder"), pastaj lat. *pudet me* më vjen turp: *pavio* rrah, godit (Walde, E.W. 498, ^{2}621).

p l i s dheu

Kuptimin "plisi i blertë" e ka Kristoforidhi 331. Meyer-i, E.W. 345 mendon, po me dyshime, se mos vjen nga gr. e re *πλί(ν)θος* tjegull. Ky mendim s'duket të jetë i drejtë dhe për këtë mjafton fakti që te Kristoforidhi (loc. cit.) gr. së re *πλί(ν)θος* i përgjigjet shqipja *plitë,* e cila piqet me atë fjalë edhe në kuptim, kurse *plis* largohet nga kuptimi. Kjo fjalë hyn përkundrazi te rrënja *(s)phel-* (ind. e vj. *phā́la-ḥ* pluar, *phálati* çan pëlcet e çahet më dysh, gr. *σπάλαξ* 'urith' sh. dhe më sipër te *palë* dhe më poshtë te *popëlë.* Baza është: *pli-tḭo,* qoftë që do të nisemi nga **pli-,* një zgjerim i rrënjës që *përmëndmë* (sh. Fick 3, ^{4}252), qoftë që do të vendosim një *pḭ-tḭo,* ku *ḭ*-ja në këtë rasë ka pësuar të njëjtin trajtim që pati dhe *i̯*-ja. Përsa i përket anës morfologjike këtu kemi të bëjmë me një zgjerim *-ḭo-* të një substantivi të pajisur me formatin *-to;* cf. lit. *pánczei,* zinxhirë, hekrua, përkundrejt sll. së vj. kisht. *pǫto* (Brugmann, Grundriss 2/1^{2}, 409). Raporti semantik ("plis = e çarë") na del edhe në gjerm. *Scholle* plis, që hyn te rrënja **sqel* çaj (Kluge, E.W. ^{7}412); ind. e vj. *loṣṭá-* m. n. si bucë dheu, që i përket rrënjës **leust-, louṣt-, lust-* shpoj, shtyj, godit, ind. e vj. *logáḥ* plis dheu, që lidhet me *rujáti* thyem, Petersson, I.F. 24, 251 v.

p l o k, p l o g u, p l o g ë, p l o g ë t ë i plogët, përtac; *p l o g ë n í*

plogë e gjejmë që te Bogdani, sh. edhe Bashkimin f. 356, Kristoforidhi f. 332, ku shënohen edhe fjalët e tjera që cituam në krye. *plog* ka dalë nga **pa-log-*, i përgjigjet plotësisht sinonimit të tij, lat. *neglego,* shkujdesem, lë pas dore (*pa = nec),* ku hyjnë edhe *religens* fetar, shpresëtar, gr. *ἀλέγω* kujdesem për një gjë, *ἀλεγύνω* bëhem merak (për përhapjen e këtij grupi në gjuhët motra sh. Walde, E.W. 176, [2]233, Boisacq 42). shq. *-log-* ka dalë nga *lēg-,* ku *ē*-ja përfaqëson shkallën e rregullt të vokalit në aoristin asigmatik të shqipes. Për zhdukjen e vokalit të *pa-* përpara një likuidi kemi dhe analogji të tjera: *prulun-perulun* (Bashkimi 366), *print* nga lat. *parentem. ë*-ja fundore në *plogë* u zhvillua sekundarisht, si në rasat që u panë më sipër te fjala *djathë.*

p l o k, p l o g u tok, grumbull

Këtë fjalë që mungon te Meyer-i, Kristoforidhi në Fjalorin e tij f. 332 e dëshmon për toskërishten, për të folët e Përmendit e të Korçës. *plok, plogu* ka dalë nga një **plēgo* dhe afrohet me *plot* lat. *plēnus*, got. *fulls,* lit. *pílnas*, sllav. e vj. kishtare *plъnъ* etj.[33] Kjo fjalë me përbërjen e saj me anë të formantit *-go-* radhitet në ata emra që përmënd Brugmann-i në Grundriss 2/12, 507; pjesa e parë (këtu *plë-*) duket si një rrënjë njërrokshe ose si një emër radikal. Në pikëpamje morfologjike khs. sll. kisht. *struga* rrymë, barkë (rrënja *sreu* – rrjedh); lit. *eigà* të ecurit, *at-eigà* të arriturit: *eĩti*

[33] Për lat. *religens*, *religio* sh. tani W. Otto, Arch. f. Religionswiss. 12 (1909) f. 541, i cili nuk ka ndonjë kundërshtim për afrimin e këtyre fjalëve latine me gr. *ἀλέγω* etj. shton njëkohësisht. "Po nuk merret vesh pse e kanë përbuzur afrimin me *legere* që të paraqitet vetvetiu". Walde, E.W.[2], 874 e pëlqeu këtë mendim. Në këtë mënyrë pranohet në themel mendimi i Wiedemann-it, i cili në BB 27, 240 shënim, i cili edhe ky e bashkon lat. *religens* njëkohësisht dhe me gr. *ἀλέγω* dhe me lat. lego, gr. *λέγω*. Edhe von Lingen, Die Wrz. *ΛΕΓ* und *ΛΕΧ*, f. 35 pyet se nga cili shkak formal Fick-u fjalët *neglego*, *religens* i ngjit te rrënja *leg* "kujdesem", po *eligo*, *colligo* i vëndon te rrënja leg "mbledh, zgjedh, lexoj". Kësaj pyetjeje të von Lingen-it i jep tani përgjigjen gjuha shqipe: latinishtes *legere* "me mbledhë, me zgjedhë, me lexue" në shqipet i përgjigjet mbleth (Meyer, E.W. 265) me *ĝ* palatale, latinishtes neglegere "me lanë mbas dore, mos me marrë parasysh" i përgjigjet shq. *plok*, *ploge* "i plogët" me *g* velare. Kështu, pra, mendimi i rëndomtë gjer më sot (cf. Otto, loc. cit), i cili *lego* dhe *religens* i ndan, gjen një mbrojtje fonetike në gjuhën shqipe.

me ecë; lit. *kúgis* çekan: *káuti* me rrahë, etj. Në këtë mënyrë me shq. *plok* tok, grumbull mund të bashkojmë edhe gjerm. e vj. të lartë *folc* grumbull, ushtri, gjerm. e sotme *Volk* popull, nord. e vj. *fólk* çetë, fis, popull, etj., pa qënë nevoja që për këto fjalë të pranojmë një zgjerim të rrënjës *pel-* (siç bën Fick-u 3^4 , 235).

Tosk. *p o p ë l ë, p o p e l,* geg. *p o p ë l* copë shkëmb gur i madh; grumbull, plis

Këtë fjalë e ka Kristoforidhi (f. 333) me Bashkimin (f. 358), në kuptimet e para që dhamë këtu. Kemi të bëjmë me një formë reduplikacioni, siç e pamë më lart te *gogëlë;* për këtë tip khs. dhe ind. e vj. *dā́dr̥ṣi-ḥ* guximtar, gr. *δηδέχατα*, Brugmann, Grundriss 2/1, ^{2}129). Kështu, pra, *pōpëlë* vjen nga **pē-pel-n-.* Po edhe një bazë shqipe e lashtë (*pá(l)-pal-n* është e mundur, formë që do t'ishte analoge me *gá(l)-gal-n* që dha *gogëlë.* Me këtë kjo fjalë mund të afrohet me serb.-sll. kisht. *planina* mal, bjeshkë, ukrain. *polonyna* vënd shterpë, tokë mashkullore (sllav. e përbashkët **poln-*), të cilat i lidhin më tej me gjerm. e vj. të lartë *felis,* gjerm, e sotme *Fels* shkëmb. gr. (te Heziku) *πέλλα* gur, ind. e vj. *pāṣṣyam* gur, shkëmb, shkrep (Kluge, E.W. ^{7}132; Weigand, D. W.^{5}, I, 519; Prellwitz, E.W.^{2}, 359; Fick 34, 237; Brugmann, Grundriss, 1, ^{2}430; J. Schmidt, K.Z. 32, 387). Në punë të sufiksit *-n-* fjalës së shqipes më fort i afrohet sllavishtja, Falk-Torp te Fick-u, në vëndin që cituam, mendojmë që emrat në fjalë mund të lidhen te rrënja *(s)phel-* çaj: ky afrim, po ta shikojmë nga ana e përbërjes së fjalës shqipe, ka më të ngjarë të jetë me vënd. Të tjera mise shqiptare të këtij grupi i trajtuam më lart (te *palë* e te *plis*). Meyer-i këtë fjalë, duke shkuar pas Kavaliotit, e shënon te fjala *pupë* xhufkë, vile rrushi (te Kullurioti kodër), me të cilën ai e bashkon në pikëpamje të etimologjisë. Vokalizmi i të dy fjalëvet e kundërshton këtë gjë. Sa për kuptimin "grumbull, plis" khs. *plis,* që është e një rrënje me *popëlë,* përveç kësaj edhe gjerm. *Scholle* plis: sllav. *skala* shkëmb, shkrep.

p r i s h l. shkatërroj, rrënoj; 2. shkulem, emigroj

prish me kuptimin e dytë mungon në E.W. të Meyer-it, po e gjejmë në një tekst që botoi ai në Alb. Studien 5, 32, pas botimit të Fjalorit ("E bija ziliqare e mbretit"), përveç këtu edhe te Kristoforidhi 343. Bash ky përdorim i fjalës na mëson se interpretimi që dha Meyer-i (*πρίω* sharroj, kuptimi më i parë i së cilës duhet të ketë qënë, pra, një më i përgjithshëm) ka nevojë të plotësohen. *prish* afrohet me gjerm. e vj. të lartë *freisa* të vënët në rrezik, rrezik, tmer, prishje – një fjalë që edhe nga kuptimi afrohet mjaft me fjalën e shqipes, saks. e vj. *frēsa* rrezik, rrezik i kojës, *frēsōn* vë në rrezik, shtie në ngasë, tundoj, gjerm. e sotme *Fraisen* ngërç, got. *fraisan* me provue, me shqyrtue. Në qoftë se duke afruar këto fjalë të gjuhëvet gjermanike me lat. *periculum, experior,* (siç bëjnë Hirt-i, Ablaut 121, sh. me Walde, E.W. 462, ^{2}576; Fick 3, ^{4}245) jemi në rrugë të drejtë, aq më shumë, që ky afrim shkon mirë për nga ana semantike, atëherë qëndron edhe krahasimi që bëri Meyer-i midis shq. *prish* e gr. *πρίω*; sepse, po të bashkojmë gjerm. e vj. të lartë *freisa* etj. me *periculum,* do të nisemi nga një zgjerim i *prr-*, pra nga *p(e)ris-* (baza është pas Hirt-it *perēi-*) dhe kjo ka vleftë dhe për *prish;* edhe gr. *πείρω* sipas Prellwitz-it, E.W. ^{2}, 384, mund të afrohet me *πρίω* dhe mund të hyjë kështu edhe ajo në indoeur. *per-.* Po ashtu pak a shumë qëndron puna, natyrisht, në qoftë se për fjalët gjermanike nisemi me Wiedemann BB. 28, 48, i cili, përveç kësaj shtron si alternativë, për grupin e këtyre fjalëvet, edhe bazën që pat vënë Hirt-i – nga një *fr-ai-s* indoeur. *pr-ōi-s* ose *pr-ai-s*, pra, nga një zgjerim i rrënjës, me diftong *i* dhe me *s*. Edhe nga një e tillë bazë mund të ketë dalë fjala *prish* e shqipes. (Ndryshe mendojnë për gjerm. e vj. të lartë O. Hoffmann, *Γέρας*, 38, Brugmann, Grundriss 1^{2}, 925). Sa për zhvillimin e kuptimeve: "prish, shkatërroj". Indoeur. *per-* khs. gr. *πέρθω* nga një *per-dh- - prish* shkulem, emigroj, lidhet me gjerm. e vj. të lartë *firren,* saks. e vj. *ferrian, firrōn, nord* e vj. *firra* me largue (baza e fjalëvet gjermanike: **ferzian, *ferzion,* Fick 3^{4}, 231). Fjala e shqipes u përgjigjet këtyre plotësisht, vetëm në vokalin radikal jo, i cili në shqipet ra. Baza e fjalës shqipe është *pris-*. Kjo na paraqet mbeturinën e një komparativi të vjetër të gjuhës shqipe, i cili në mënyrën e formimit të tij, domethënë në infleksionin e sufiksit, i përgjigjet latinishtes *magis.* Le të shënohet në këtë rast që kjo nuk është e

vetmja mbeturinë e komparativit të moçëm që ka ruajtur gjuha shqipe: edhe *madhështí: math, madhi,* lat. *magnus,* ind. e vj. *mahant-* do shpjeguar si një komparativ i këtillë; pra, *madhësh-t-i,* nga *maĝis-* i përgjigjet plotësisht latinishtes *magis.* Për infleksionin sufiksal sh. Sommer, I.F. 11, 58; J. Schmidt, K.Z. 26, 385; Brugmann, Grundriss $2/1^2$, 548. Për mënyrën e derivacionit të kësaj fjale kujto ato që u thanë te *limontí.* Kështu, pra, të dy verbet *prish* shkatëroj dhe *prish* shkulem, emigroj, vërtet janë afëri midis, po në mënyrën e formimit të tyre ndryshojnë; i pari na paraqet një zgjerim më *-s-,* i dyti është një derivat i komparativit të moçëm.

r e s h, r e s h ë n bie borë bie shi

Siç del nga shënimi që ka Bashkimi në f. 374, kuptimi i këtij verbi nuk përfshihet krejt me të rënët e borës (siç e ka Meyer-i, E.W. 363), sepse kjo fjalë përdoret edhe për hi, zjarr etj. që vjen prej qiellit. Meyer-i, loc. cit. mendon, po me dyshime, ta nxjerrë nga një, **vresh* dhe ta afrojë kështu me ind. e vj. *varṣá* – shi, gr. *Fέρση,* irl. e vj. *frass* rrebesh. Veçse më vonë, në A. St. 3, 86, ai këtë fjalë e quan të pashpjeguar; dhe me të drejtë, sepse *vr-*ja në ballë të fjalës në shqipet ruhet si e tillë. Po kur ne fjalën *resh* ta bashkojmë me sllav. e vj. kishtare *rosa,* lit. *rasà* vesë, ind. e vj. *rasā* lagësirë, vlag, lat. *rōs, rōris* (rrënja indoeuropiane *eres,* rrënjë paralele me *u̯eres*, e cila ka dhënë gr. *Fέρση,* ind. e vj. *varṣá-* shi, sh. Walde, E.W. 529, 2658), nuk ndeshim në asnjë vështirësi fonetike. Trajta *reshën,* që Meyer-i e shënon sipas da Lecce-s, është një trajtë sekundare e *resh* – vetëm këtë ka Bashkimi, ashtu si *hipën* (Bogdani, Cun. prophet. I 14, 13; 36, 17) është trajtë sekundare e *hip,* cf. Pekmezi, Gram. 184).

r ë n d ë, geg. *r â n d*

Kundër interpretimit të Meyer-it, i cili e nxjerr këtë fjalë nga lat. *grandis,* flasin disa arsye me karakter fonetik; grupi *gr-* në ballë të fjalës ruhet, nuk bie; khs. p.sh. *grij, grua, griq* kope, nga lat. *gregem; rreth,* të cilën Meyer-i, A. St. 3, 8 e sjell si një paralele fonetike, duke e nxjerrë nga një *graidos* e duke e afruar me gjerm. e vj. të lartë *chreiz* qark, rreth, është

fjalë e errët nga pikëpamja e etimologjisë (Pedersen, Roman. Jahresbericht 9, I, 215); *re* vërejtje, që Meyer-i, E.W. 362 e nxjerr nga lat. *grevis = gravis,* duhet shpjeguar ndryshe (Wiedemann, BB 27, 21). Edhe nga ana e kuptimit shq. *rëndë* i rëndë, me rëndësi, i mërzitshëm, nuk i përgjigjet latinishtes *grandis,* siç thekson edhe Meyer-i vetë në A. St. 4, 25; në gjuhët romane *grandis* përdoret vetëm për "i madh", jo për "i rëndë". Fjalën *rëndë* të shqipes mund ta afrojmë me lit. *rė́ju* vë stavë, stivoj. Sa për kuptimin khs. gjerm. *Last* barrë, *lästig* i mërzitshëm: nord. e vj. *hlaða* me stivue; rus. *kladъ* barrë: *kladú* vë, vë stavë, stivoj. Nga pikëpamja morfologjike kemi të bëjmë me mbeturinën e një participi më *-ent-,-ont-,* siç e gjejmë dhe në *vrëndë,* që do të shohim më poshtë. Në toskërishtet fjala mbaron me *-ë,* duke i u përshtatur analogjikisht mbaresës që kanë shumica e adjektivavet (sh. Pekmezi, Gram. 104).

Geg. *r î t ë* pak i lagët i njomë

Këtë fjalë Meyer-i s'e ka, po e gjejmë te Kristoforidhi 351 e te Bashkimi 375. Është afëri me ind. e vj. *riṇáti* e bën të rrjedhë, *rīyatē* zë të rrjedhë, *riṇa-ḥ* rrjedhës, që ka zënë rrjedh, sllav. e vj. kisht. *rinǫti* me rrjedhë, *rěka* lumë, lat. *rīvus* përrua, she etj. (të gjitha këto hyjnë te rrënja *rei-* rrjedh, dhe për këtë sh.Walde, E.W. 527, ^{2}655; Fick 3^{4}, 341). Fjala e shqipes është formuar me sufiksin *-të,* të cilin e trajtuam shpeshherë këtu, dhe ka dalë nga një formë nazale e verbit e cila na shfaqet dhe në ind. e vj. *riṇáti,* sllav. *rinǫti.* Kuptimi i parë është "që rrjedh, rrjedhës", e prej këtej mundi e u zhvillua lehtë kuptimi "pak i lagët, i njomë". Edhe në gr. *ὑγρός* i gjejmë të dy kuptimet, dhe "i lagët, i njomë" dhe "rrjedhës, që rrjedh". Baza është **rinëtë,* sepse po të kish qënë në ballë një grup *-nt-,* do të kishim sot *-nd-.*

r u a j bëj roje, ruaj, shikoj, vështroj, *r e s ë,* zili, ndezë; vëndi ku rrinë e presin peshqit, që t'i zëmë

Të dy kuptimet e fundit të ruaj i kemi shënuar pas de Radës, Gramm. f. 62 (it. *miro*). Ky verb është i afërt me fjalën *rē* në shprehjen

vë rē, fjalë të cilën Wiedemann-i, BB 27, 210 me plot arsye e ka bashkuar me lit. *regėti* me pa, me këqyrë, irland. *réil* i qartë, nga një **reg-lis, rosc* sy, nga *rog-sko.* Sidomos kuptimi që jep de Rada: "shikoj, vështroj" piqet plotësisht me kuptimin e verbit të lituanishtes.[34] Në pikëpamje morfologjike ky verb na paraqet një formë aoristi, po ashtu siç na e ka vërtetuar Pedersen-i Alb. Texte 152, për verbin *luaj*; nga aoristi, ku *g*-ja intervokalike u zhduk rregullisht dhe ku ishte me vënd dhe vokali i gjatë, u formua rishtas prezenti. Nga kuptimi "shoh, shikoj" u zhvillua pastaj kuptimi tjetër "ruaj, servare" (kështu p.sh te Bogdani, Cun. prophetarum I, 68; *Manna ruhetė nde Enetė Aarta.* Mana servatur iu vasa aurea). Krahaso zhvillimin krejt analog të gjerm. së sotme *bervahren* ruaj, përkundrejt gjerm. së mesme të lartë *warn* vë re, i vë mëndjen, e marr parasysh, saks. e vj. *warōn* marr parasysh: gr. *ὁράω* shoh. Këtu hyn dhe *të ruansh* që ta ruash, prej nga u bë pastaj *truanj* (Meyer, E.W. 369), kuptime këto që venë mirë me etimologjinë që u dha këtu. Mendimi i Meyer-it, që verbi ynë të ketë dalë nga sllav. *chraniti,* nga pikëpamja fonetike nuk të bind. Sepse, kurse edhe në fjalët latine të shqipes, që kanë hyrë këtu shumë shekuj përpara fjalëvet sllave, *a*-ja na reflektohet me shq. *ă* si *ā*-ja e gjatë si e shkurtëra, barabar (p.sh *faqe facies, fat fātum, gjukatë judicātum, kunat cognātus, ngrat ingrātus,* Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss 1^2, 1041), atëherë nuk ka të ngjarë që *a*-ja e sllavishtes që hyri më vonë, të ketë bërë ndrimin *ā* në *ō* dhe pastaj diftongimin e *ō*-së. Po përveç kësaj, kundër një mendimi të tillë flasin dhe disa fjalë që janë sigurisht me gurrë sllave; *lakëmḯ,* nga serb., bullg. *lakom* lakëmes, tamahqar; *prak, pragu,* nga serb. bullg. *prag* idem, *mbras* zbraz, një derivat i serb. *prazan* i zbrazët, bullg. *prazen* ibidem, *stap* shkop*,* nga serb., bullg*. stap* idem*, starisvat* krushku i parë nga serb. *stari svat, Gllava,* emër i një fshati afër Tepelenës

[34] Trajta *roe* e gegërishtes na dëfton se *e*-ja e tosk. *rē* është produkti i një kontraksioni.Khs. fjalën *ngē, ngae,* për të cilën u fol më sipër. Një shpjegim do trajta *oroe* që e ka gërqishtja krahas me *roe. o*-ja, është një prefiks dhe afrohet me ind. e vj. *ā* në *viśā,* drejt popullit, gjerm. e vj. e lartë *ā,* nga indoeur. *ē,* në *āwahst* shtesë, *āmād* bkorra e dytë, gr. *ἠ-* në *ἠ-ρέμα* ngadal, mengadal: got. *rimis* qetësi, prehje, lit. *rimti* me pushue, me qenë i qetë (Brugmannn, Alb. Kern 30, I. F. 15, 103; W. Lehmann, Präf. *uz-* 138 f; Prellwitz, E.W. ^{2}177; Walde, E.W. 284, ^{2}363): 30, I. F. 15,103; W. Lehmann, Präfix *uz-* 138 v. Prellwitz, E.W. 2 177 Walde, E.W. 284, E.W. 284, ^{2}363): *oroe,* pra, = të vështruarit nga kjo anë, të këqyrunit.

(Lirija, Nr. 74, f. 2). Te *ruanj* hyn edhe fjala gege *resë* 1. zili, ndezë (me këtë kuptim e ka Fishta, Pika voeset, f. 43), 2. vëndi ku rrinë e presin peshqit, që t'i zënë. Të dy kuptimet i ka Bashkimi 374. Sa për kuptimin e parë khs. lat. *invidia* zili, resë: *video* sllav. e vj. *zavistь* resë: *viděti* me pa. Kuptimin e dytë do ta marrim si "të përgjuar, pritë" (khs. p.sh lit. *láukiu* prej një njeriu, *exspectare*: gr. *λεύσσω* shoh, let. *lūkůt* me shique). Nga ana morfologjike *resë* qëndron ndaj *ruanj* si *gërresë* ndaj gërruanj (sh. më lart). Khs. dhe fjalët *bresë*, *kmesë* që u trajtuan dhe këtu më sipër.

r r a s dënd, mbështjell fus me forcë, ndrydh

Kuptimet sipas Jungg-ut, Fjal. 120 (inzeppare, stivare, calcare) dhe Bashkimit 320, ku është shtuar kuptimi "mettere o enterare per forza". Kjo fjalë që Meyer-i, E.W. 372 sapo e qek, afrohet me rrah, e cila lidhet më tej me sllav. *raziti*, Meyer loc. cit. 371. Baza është **raĝ-ṭi̯ō.* Në mënyrën e formimit i përgjigjet verbi *ngris* (sh. më lart). Sa për raportin kuptimor "*rrah-shkel*" khs. gjerm. e vj. të lartë *berjan* me rrahë, me i ra, me trokitë, me shkelë, me mbrujtë, rus. *mjátь* me mbrujtë, me ngjeshë bukën, me shkelë; e përbri kësaj *mjátka* rrëmujë, kallaballëk, dajak.

r r i, qëndroj, banoj, pushoj

Afrimin që bëri Meyer-i (për këtë fjalë (E.W. 374): ind. e vj. *šrayati* përshtatet, lit. *szlėjù* pështet, gr. *κλίνω*, të cilin vetë Meyer-i e shtroi si me dyshime, Pedersen-i, K.Z. 33, 545 e refuzoi. Pastaj, në A. St. 4, 59 Meyer-i vetë shpjegimin e vet e quajti fort të pasigurt, po të njëjtin gjykim dha edhe për etimologjinë që pat shtruar Bugge: lat. *nidus,* arm. *nist* gjëndje, ndenjë, *nstem* rri, duke admetuar ky një ndrim të *n*-së fillestare në *r,* siç e admetoi edhe për fjalët *rri* dhe *rre* (BB 18, 170). Pra, meqë përpjekjet e gjertanishme, nga sa duket, nuk mjaftojnë, kjo na justifikon të shtrojmë një interpretim të ri: gjerm. e vj. e lartë *ruowa,* gjerm. e mesme e lartë *ruowe,* po gjerm. e vj. e lartë edhe *rāwa,* gjerm. e sotme *Ruhe* prehje, pushim, qetësi anglos. *rōw* prehje, pushim, çlodhje, gr. *ἐρωή* pushim, çlodhje, zmbrapje, ngadalësim, pakësim, të prerët (e një pune), nga një

ἐρωϝα (sh. Fick, K.Z. 22, 375 v.; J. Schmidt, po aty, 32, 335). *ī*-ja e gjatë në *rrī* ka dalë nga një *ū* në mbarim të fjalës ashtu si në *shī* (: gr. *ὗει*), *thī* (lat. *sūs*), *mī* (:lat. *mūs*), *ti* (: *tū*). Për vokalin fundor të këtyre fjalëve sh. Pedersen: K.Z. 36, 282. Kjo *ū* e fjalës së shqipes, që u nxuar kështu me anë të deduktimit, qëndron ndaj indoeur. *ōu, ēu,* të cilën e reflektojnë gr. *ἐρω(ϝ)η*, gjerm. e ndaj indoeur. *ōu, ēu,* të cilën e reflektojnë gr. *ἐρω(ϝ)η*, gjerm. e vj. e lartë *ruowa,* gjerm. e vjetër e lartë *rāwa,* në rrethana të infleksionit (ablautit) sh. Hirt, Ablaut, f. 33 v; Brugmannn, Kl. vgl. Gram. 143). Është e vërtetë që në gegërishtet fjala shqiptohet *rrî,* po do të ishte gabim që këtë fakt ta përdornim kundër interpretimit që dhamë këtu. Sepse gegërisht thonë dhe *mî* sadoqë kjo fjalë lidhet pa asnjë dyshim me *mūs.* Pra, nazali i gegërishtes këtu është sekundar. Në pikëpamje morfologjike *rrī* do ta konsiderojmë më mirë si një prezent të tipit *kthiell, zgjat* etj., të cilin e pamë më lart te *kthiell.*

s h e l i g ë, s h l l i g ë gjarpër, nepërkë

Meyer-i, E.W. 101 e Jungg-u, Fjaluur 127 e shkruajnë *šeľigɛ* (*sheligë),* kurse Bashkimi 429 e 416 ka *šligɛ (shlligë)* dhe *šélige (shëlligë, é = ë).* Forma me *ll* pajtohet më mirë me ato që thotë Pedersen-i, K.Z. 33, 541 v. përmbi *l*-në e shqipes. Kjo fjalë, që gjer më tani ka mbetur e pashpjeguar, afrohet me irland. e vj. *selige* breshkë, island. e re *seilche* kërmill (baza **selikiâ*), lit. *selėti* me ecë vjedhtas, me ecë rrëshqam, gr. *εἰλίποδας* që mezi hiqen, ind. e vj. *t-sárati* hiqet, hiqet zvarë (sh. Osthoff, BB 22, 255 vv.; Walde E.W. 560, 2696). Fjala e shqipes përmban formantin *go-*, që edhe në gjuhët motra përdoret shpesh për të formuar emra shtazësh; khs. ind. e vj. *urágа-ḥ, urága-ḥ* gjarpër, *bhująga-ḥ, bhujaga-ḥ* gjarpër, *patágá-ḥ* fluturak, zog, gr. *ὄρτυξ* shkurtë, *τέττιξ* gjinkallë (Brugmannn, Grundriss 2/12, 508, 510, 511; khs. edhe O. Richter; I. F. 9, 199v.). Në gjuhën shqipe sufiksin *go-* e gjejmë dhe në *plok, plogu* grumbull (sh. më lart). Për afërsinë e sufiksevet *go-* dhe *ko-* në formim të emravet të kësaj kategorie semantike që përmëndmë këtu, fjala e irlandishtes ka sufiks *ko-,* shih Brugmann, loc. cit. 505. Natyrisht që *g*-ja intervokalike në shqipet nuk mund të jetë e lashtë. Me mbaresën e femërores që ka kjo fjalë hyn në ata shembuj që zumë ngojë më sipër, te *djathë;* pra duhet të nisemi nga **sh(ë)llik,* kurse *sh(ë)lligë* është një formë sekundare. Raporti kuptimor që ekziston midis *sh(ë)lligë* e lit. *selėti*

me ecë vjedhtas, me ecë rrshqamë, gjen analogjinë e tij në lat. *serpens, serpere,* e në nord. e vj. *snākr* gjarpër: gjerm. e vj. e lartë *snahhan* irrepere (Kluge, E.W.7 408; Fick 34, 518). Edhe raporti kuptimor që ekziston midis *sh(ë)lligë* gjarpër, nepërkë dhe irland. *seilche* kërmill s'ka ndonjë gjë për t'u çuditur. Edhe në gjuhë të tjera emri i kërmillit dhe i gjarpërit janë ngjitur me të njëjtin brumë: norv. veriore *snōk* kërmilli: nord. e vj. *snākr* gjarpër, sved. *snok* gjarpër njës (Fick, loc. cit.). Fjala e irland. për nga ana e kuptimit qëndron ndaj lit. *selėti* me të vjedhtas, me ecë rrëshqamë, gati njësoj si gjerm. *Schnecke* ndaj zvic. *schnaacken* repere, serpere (sh. për këtë gjë te Kluge loc. cit. 409). Fjalët e irlandishtes që përmëndmë këtu i krahasoi me lit. *selėti,* po pa afruar fjalën e shqipes, Bezzenberger-i, te Fick-u 24, 292, dhe më tej ai i lidhi me lat. *salio.* Kundër këtij afrimi me *salio* u shpreh Walde E.W. 541, 2673 (te *salmo*). Edhe Osthoff-i, BB 22, 257 i ndan fjalët *salio* dhe lit. *selėti.* Po irland. e vj. *selige,* irland. e re *seilche* piqen përkundrazi mjaft bukur me shq. *sh(ë)lligë,* si nga kuptimi si nga mënyra e formimit dhe më anë tjetër të gjitha këto fjalë s'ka si të ndahen nga lit. *selėti:* kështu, pra, nga interpretimi i Bezzenberger-it do hequr vetëm lat. *salio,* kurse shq. *sh(ë)lligë* përbën nga ana e kuptimit një lloj unaze ndërmjet fjalës irlandeze dhe fjalës lituane, pra, është në gjendje ta mbështetë etimologjinë e Bezzenberger-it.

shkel; shkelm, shqelm[35]*, shkelp, shkelbi, shkelm oj, shqelboj; shkal* shitoj

Meyer-i, E.W. 407 supozon një rrënjë **skel-, skol-.* Mirëpo kundër një supozimi të tillë na dalin disa arsye: 1. *sq*-ja ka dhënë në shqipet *h* (cf. *harr* tëharr, qëroj, kij ndaj *sqer, halë*: lit. *skélti* me ça etj. Brugmann, Grundriss 12, 582), kështu që *shkal* shitoj (d. m. th. "shkel", Meyer loc. cit.) nuk pajtohet me këtë rregull; 2. mungon një lidhje e mëtejme për këtë fjalë. Të dyja këto vështirësi zhduken po ta zbërthejmë fjalën në *sh-kal.* Tani, meqënëse grupi *sh-k* në ballë të kësaj fjale nuk është trajtuar ashtu siç trajtohet *sk*-ja origjinale, del që midis *sh*-së dhe *k*-së ka rënë një vocal. *sh-* është refleksi i indoeur. *sem-, sm̥-* (sllav. e vj. *sǫ-,* ind. e vj. *sa-, sam-,* prus. e vj. *sen-,*

[35] Meyer E.W. 407 e shkruan. *shqellm,* po Bashkimi 1.313 ka *shqelm,* dhe kjo, duke pasur para sysh trajtën paralele *shkelm,* do të jetë e vetmja trajta e drejtë.

gr. *ά* etj.). Disa të tjera gjurmë të këtij prefiksi do t'i hetojmë më poshtë. *kal-,* nga një *kol-,* afrohet me lit. *kulnìs* thembër, lat. *calx,* thembër, *calcare* me shkelë (kjo e fundit me gutural në fund të radikalit, sh. Walde, E.W. 87, 2117) gr. *κολετρᾶν* me shkelë. Një trajtim më vete kërkon tani raporti që ekziston midis *shkal* e *shkel* edhe *shqelm.* Pedersen, K.Z. 36, 326 v. e lëfton mendimin që kish shprehur Meyer-i rastësisht (p.sh. E.W. 185) që një *e* e dalë nga një *a* me anë të apofonisë (umlautit) nuk shkaktoka zbutim të *k*-së në *q.* Pedersen-i thotë se në punë të etimologjisë së këtyre fjalëve si *keq, kep* gdhënd, latoj gurë, *gegë*, *kedhe* (geg.) vajzë që akoma s'është për burrë, *shkel, shkep* dhe me të tjera që kanë *k* përpara *e*-së duhet të jemi posaçërisht të matur. Çelësi i kësaj enigma, sipas tij, do kërkuar më të shumtën e herës në një huazim (prej gjuhësh ose prej dialektesh të tjera). Mirëpo, si për *keq* (sh. më lart) ashtu edhe për këtë grup që do të shtjellojmë këtu si dhe për *shkep* që do të vijë pak më poshtë ka dhe një tjetër mundësi shpjegimi: ndërsa *shkal* shitoj ("shkel") na shpie te një bazë **sm̥-kol-nō* (cf. *kulnìs*), format me *shqe-,* siç janë *shqelm, shqelmoj, shqelboj* (Kristoforidhi 395) përkundrejt *shkelp,* na dëshmojnë se në trung të fjalës kemi të bëjmë me një *e,* qoftë që kjo *e* vjen nga një formë që ndaj *kol*-it qëndron në raport të infleksionit, qoftë që u kondicionua nga *i*-ja e silabës që vinte pas, që, pra, u përhap brënda skemës së koningacionit, nga **kolnis *kalnis* etj. (vetja e parë **kolnį̇o *kalnį̇o*). Kështu, pra, në *shkel* do të kemi të bëjmë me një produkt kontamionacioni të të dy kategorive të formave: të tipit *kal-nō* dhe të tipit *kal-nį̇ō,* respektivisht *kel-nō.* Nga këto dy tipe, meqë në gjuhën shqipe verbet më *-no* u shëndruan e u bënë edhe në të tjera rasa verbe në *-nį̇o* (*shtynj,* nga *stūd-nį̇o;* got. *stautan* (Meyer, A. St. 3, 28), *ndynj:* nga **dhūg-nį̇o:* gjerm. e vj. e lartë *tūhhan,* po aty 9), prandaj është më afër menç të pranojmë si bazë një tip **kalnis.* Morfologjikisht koekzistenca e *shkelm*, *shkelp,* krahasohet me çiftin *ngjelmetë, ngjelbëtë* (sh. më lart). *shklep, shkelbi* për nga ana e sufiksit qëndron ndaj *shkel* ashtu si lit. *paliaubà* të prerët e një pune: *liáuti* me pra (Brugmann, Grundriss 2/12, 381).[36]

[36] Helbig, Jahresber d. Inst. f. rum. spr. 10,23 *shkel* e nxjerr nga lat **excalleare* shtëmëngem, mënjanem. Kundër një interpretimi të tillë, përveç punës së kuptimevet të cilat nuk përgjigjen dhe aq mirë, ka dy arsye që flasin kundër: 1. gjer më sot nuk janë dhënë shembuj të sigurtë për një kalim të verbeve latine në koniugacionin jo më *n-* të shqipes (sh. Pedersen, Roman. Jahresber. 9, I, 211, dhe këtu më poshtë, te tund); 2. Ky verb është i pajisur

s h k e p, s h k r e p i përngjaj pakëz

Meyer-i, E.W. 408 shënon vetëm *shkep;* por Kristoforidhi, Fjalori 393 krahas me *shkep* shënon, si trajtë më të drejtë, edhe *shkrep,* dhe na jep dhe një kuptim pakëz më ndryshe: "i përngjaj pakëz" (te Meyer-i "i përngjaj"). Me ekgzistencën e trajtës *shkrep* zgjidhet dhe për këtë verb ajo vështirësia e *k*-së jo të zbutur përpara *e*-së që përmënd Pedersen-i në atë vëndin që cituam (K.Z. 36, 327). Po me këtë na jepet mundësia edhe ta sqarojmë këtë fjalë edhe nga ana e etimologjisë. Kjo fjalë duhet zbërthyer ashtu siç u bë me fjalën *shkal. shkrep = sh-krep,* ku *sh*-ja është edhe këtu refleksi i *sem/ som-, sm̥ -; krep* afrohet me lat. *corpus,* ind. e vj. *kr̥p* – shtat, bukuri (indoeur. *qu̯rep;* sh. për këtë grup fjalësh Walde, E.W. 144, 2194). Kështu, pra, shq. *sh-krep* si nga forma e saj si nga zhvillimi i kuptimit: "i përngjaj pakëz" i përgjigjet gjermanishtes *gleich* barabar, gjerm. e v e lartë *gilīh,* got. *galeiks,* që në të vërtetë duan të thonë "që ka një trup njësoj si" (Kluge, E.W.7, 175). Për të rënët e *r*-së, siç e shohim në *shkep* përkundrejt *shkrep,* kemi dhe paralele të tjera, si p.sh *tendelinë* përbri *trendelinë* (Kristoforidhi, Fjalori 420, Meyer-i, E.W. 436 shënon vetëm *trendelinë,* sipas Hahn-it), *tokë* përveç *trokë* truall dhe (Kristoforidhi 425, 433; Meyer, E.W. 432), geg. *shkepëtīj,* po në gegërishten e Elbasanit *shkrepëtīj* (Kristoforidhi 400, cf. edhe Meyer, E.W. 409), *vangullonj* krahas me *vrangullonj* kapsallit sytë (Kristoforidhi 36), *pa,* pra, përveç kësaj, krahas me *pra* (Kristoforidhi 296, khs. sllav. e vj. *proče*), *përtryp,* e krahas me të *përtyp* (sh. më poshtë te *shtyp*) e të tjera si këto.

s h k o j; s h k u e s (*s h k u s*), *s h k e s* mbles, lajmës krushqar

Meyer-i, E.W. 408 jep për *shkoj* vetëm kuptimet "kaloj andej, kaloj"; po kuptimi bazë është "vete, shkoj", dhe këtë na e dëshmojnë Kristoforidhi,

---

me sufiks vëndi. Pastaj le të marrim e të këqyrim fjalën *shkalloj*, e cila, sipas Helbig-ut, loc. cit. shënim, për punë të *l*-së s'ka sesi të ketë ardhur nga lat. *callis* (siç mendonte Meyer-i E.W. 407). Meyer-i ka vetëm kuptimin "çmëndem, dal mënç". Ky verb, përkundrazi, është një me shkalloj, mbij, mugulloj, dal (për grynjërat), përdorur te Lumo Skëndo, Këndime për shkollat e para, f. 14; kjo na paraqet një kuptim më konkret dhe shihet qartë që hyn te grupi që u shqyrtua më sipër (kuptimi bazë është, pra, si të thuash, "shkel e dal jashtë"). Që këndej mundi e u zhvillua kollaj kuptimi "dal mënç". Për formimin e këtij verbi Pedersen, Roman. Hahresbericht 9, I, 211. *ll*-ja u përftua në pozicion intervokalik.

Fjalori 397, Bashkimi 425, Pekmezi, Gram. 273. Kuptimin "vete" Kristoforidhi, loc. cit., e shënon vetëm për gegërishten, po sipas Pekmezit ky kuptim është i shqipes i mbarë. Që ky shënim i Pekmezit është me vënd, këtë na e vërteton p. sh. të folët e Leskovikut (Lirija, Nr. 93 f. l, shtylla 3, ku *shkoj* përdoret me vështrimin "vete, udhëtoj, bëj udhë"). Meyer-i nuk jep një interpretim të prerë; ai vetëm shënon se një derivim nga lat. *sequor* shkon sa për tingujt, po nuk mjafton për kuptimin e fjalës. Ne do të thomi se lat. *sequor* nuk ka dhënë në asnjë vënd të botës romane kuptimet "shkoj, vete, shkoj andej". Prandaj duhet ndjekur një tjetër rrugë shpjegimi. Kjo fjalë është një denominativ i *shtek, shtegu,* po ashtu siç qe formuar në latinishten vulgare nga *via* udhë rrugë *viare* me shkue, me marrë rrugën, një fjalë që Kuintilani edenjonte. Pra, këtu mund të kemi të bëjmë me një ndikim të "formës së përbrëndëshme" nga ana e latinishtes. *shkoj* ka dalë nga një *sht(ë)goj* nëpërmes të një trajte **shtkoj.* Trajta e sotme *shkoj* ndaj kësaj bazës që supozuam qëndron afërsisht ashtu si geg. e shq. e Italisë (cf. Hanusz, Mém. Soc. Ling. 6, 266) *shpī*: tosk. *shtëpí,* krahaso për anën fonetike p. sh. edhe *kshu* në Leskovik (Lirija, Nr. 93, f. 1, shtylla 4), për *kështu.* Fakti që në bazën **sht(ë)goj g*-ja intervokalike nuk ra, po mbeti, shpjegohet me ato ç'thotë Meyer-i, A. St. 3, 37; cf. *agoj* gdhihet. Sa për vokalizmin në *shteg-,* **sht(ë)goj,* që dha *shtkoj,* khs. lat. *excitare*, që nëpërmes të një **shqtonj* dha në shqipen *çonj* (Meyer, E.W. 448). Se sa ndrohen pastaj nga përdorimi i tyre i shpeshtë ato fjalë që tregojnë të shkuarit, të vajturit, këtë na e shtjellojnë Marchot, Revue des langues romanes 1893, 146 dhe M. Bréal, Mem. soc. Ling. 9 31, me shëmbuj të marrë nga gjuhët romane. Sa për zhvillimin e kuptimit: "shkoj, kaloj andej" mund të krahasojmë frëngj. *passer* me shkue, me kalue aty pari. Këtu hyn edhe *shkues* mbles, lajmës, krushqar (që e ka Kristoforidhi 398 me Bashkimin 427). Jungg-u, Fjaluur 131, ka *shkūs,* ndërsa Meyer-i, përveç *shkūs,* shënon edhe trajtën *shkes* që e ka Hahn-i. Që fjala vjen nga *shkoj,* e vuri re Kristoforidhi, loc. cit, kruse Bugge, BB 18,184, e konsideron një huazim nga lat. (te Plauti) *cotio* senkser (cf. frëngj. e vj. *cosson* senkser, it. *cozzone* senkser, kodosh). Fakti që format *shkues* e *shkes* ekzistojnë që të dyja, na tregon qartë se kemi të bëjmë me një derivat nga një verb më *-onj;* khs. geg. *knnues* (Jungg, Fjaluur 58): tosk. *këndés,* nga *këndonj.* Po etimologjia e Bugge-s nuk ecën as nga ana fonetike, dhe ja sepse: ose *cotio* hyri në shqipet më një kohë më përpara se të ngjante ndrimi i *o*-së

në *e* (si në *ndēr* nga lat. *honōrem*), po atëherë duhej të kishim një formë **kes,* po jo *shkues, shkūs* ku *ue, ū* pasqyrojnë një *ō;* ose huazimi ndodhi pas kësaj kohe, po atëherë nuk kuptohet natyra e vokalit te trajta *shkes* që na jep Hahn-i. Edhe konsonanti inicial nuk pajtohet me etimologjinë e Bugge-s. Veçse interpretimi që shtroi së pari Kristoforidhi dhe që e shtjelluam dhe ne këtu do një mbështesë nga ana semantike. Një paralele nga kjo pikëpanje na jep sll. kisht. *chodataj* i dërguar, ndërmjetës, mestar, në rusishtet (nga sll. kisht.) gojtar, fjalëmirë, përfaqësues37, ndërmjetës; *chodátaja* mbleskë, krushqare: *chodiți* me shkue. Si një tjetër paralele semantike po përmendim shprehjen e latinishtes së mesme *tu inter illum et nos medius discurristi,* të cilën e ka Miklosich-i, Lexicon palaeslovenicum s.v. *chodataj* (f. 1093).

s h q e s, s h k a s, rrëshqas

Të tjerë misa të këtij grupi i gjen te Meyer-i, E.W. 411. Meyer-i nuk jep shpjegim, po shënon vetëm këtë, që *shkies* dhe *shkas* qëndrojnë ndaj tyre në raport të infleksionit dhe na shpien te një *skes.* Mirëpo kundër kësaj **skes* - **skos* flasin të njëjtat arsye fonetike, të cilat më sipër (te *shkel*) i përmëndmë si instanca kundër bazës **skel, *skol-.* Prandaj kjo fjalë do zbërthyer në *sh-qes. qes,* si një **ketįo,* afrohet me çek. (*pře-*)*kotiti* me përmysë, me rrëzue, *káceti* me përmysë, rus. *качáть* me përkundë refl. me u lëkundë. Raporti kuptimor që shkon në mes të fjalës sllave dhe të fjalës shqipe është po ai që ekziston midis lat. *labor* shkas, rrëshqas e *labo* lëkundem. *sh*-ja do të jetë lat. *ex;* -*kas* s'ka nevojë të qëndrojë doemos në raport infleksioni me *qes,* po mund të jetë formuar sipas analogjisë së gjithë atyre verbave që mbarojnë më -*as.*

s h p i e çoj; *s h p u r ë* përcjellë

Meyer-i (E.W. 35) nga sa duket, *shpie* e bashkon me *bie* sjell, kurse preteritin *pruva, prura,* participin *prurë* i lidhmë të drejtë dhe te rrënja *per-* që ka dhënë dhe ind. e vj. *píparmi* shpie, shtie matanë, përcjell, gr. *πόρος* va, *περαω* kalo; lat. *portare* me sjellë. Mirëpo po të af-

[37] *kshu* e përdorur edhe Naim Be Frashëri, Fletore e Bektashinjet[3], f. 9.

rojmë *shpie* me *bie,* tingulli inicial mbetet i pashpjeguar; nuk kuptohet në *shpie* as natyra e *sh-së* as *p*-ja. Ky verb duhet të zbërthehet në *sh-pie;* elementi radikal lidhet me aoristin *pruva,* participin *prunë,* forma këto që Meyer-i i shpjegoi drejt. Kështu, pra, s'është nevoja që të ndahet prezenti nga preteriti, siç bëri Meyer-i. *sh*-ja është refleks i indoeur. *sem-/som- sm̥-* (sh. më lart te *shkep, shkrep, shkel).* Si sll. *sъ*[38], ashtu edhe *sh*-ja e shqipes te ky verb ka një kuptim perfektiv. *sh-purë* i përgjigjet gjermanishtes *Ge-leit* përcjellë, shpurë, si *sh-krep, sh-kep* që i përgjigjet gjerm. së vjetër të lartë *gi-līh.* Format e preteritit që ka Meyer-i dhe që i qekmë më lart, janë të reja dhe kanë dalë me anë të analogjisë (cf. Meyer, loc. cit). Një trajtë më e moçme gjëndet te Bogdani, Cunens proph. I, 66, 16: *ſcpuu,* që duhet kënduar *shpū.* Ky aorist e ka analogjinë fonetike të tijnë te fjala *shpurë,* përcjellë, kjo nga një *pr̥ˢā.* Këto fjalë paraqesin që të dyja një *r̥ˢ* dhe në *shpu* ka rënë *r*-ja ashtu si dhe në *bie.* Për reflektimin e *r̥ˢ* -së pas labialesh khs. Pedersen-i, K.Z. 36, 319, së bashku me Brugmann-in, Grundriss 1, ^{2}465. Në gradën e infleksionit aoristi *shpū* i përgjigjet p. sh. aoristit *grisha.* Kjo tregon se preteriti i shqipes përveç reflekseve të perfektit indoeur. (Pedersen, Festskrift V. Thomsen, 253 v.) përmban në vetvete edhe disa mbeturina nga të aoristit. Khs., përveç këtyre, edhe ato që thuhen te fjala *shtie.*

shpall, përpāll

Meyer-i, E.W. 320 ka vetëm *shpal* me *l* të butë, dhe këtë e bashkon me *palë* rrudhë, pra, niset kështu nga një kuptim bazë "shtjell, shtëllis". Konceptin e të shpallunit, të nxjerrët në shesh një gjë të fshehur, e përmban, prepozicioni *sh = ç,* që afrohet me lat. *dis* (Pedersen, K.Z. 36, 321). Këtë etimologji e hedh poshtë forma *përpāll* shpall, botoj, bëj të njohur, formë që Meyer-i s'e ka, po që e përdor Bogdani, Cuneus proph. I, 73, 9, II, 2, 6; një verb ky, i cili, ndonëse i pajisur me një prepozicion që ka një funksion fare ndryshe, ka megjithëkëtë një kuptim pothuajse të njëjtë me atë. Nga kjo del që kuptimi thelb i kësaj familje fjalësh qëndron në verbin, jo në prepozicionin. Lat. *palam* haptas, sheshit, në sy të botës, rus. *pólyj* haptas, lirisht,

[38] [Për etimologjinë sh. sidomos Brugmannn, Grundriss 2/2^{2} 852. Shënim i korrekturës].

zbuluar, na paraqesin këtë kuptim dhe janë, pra, të afërmit e kësaj fjale të shqipes nga lëmi i gjuhëvet motra. Fjala jonë bashkë me ato hyn te rrënja indoeur. **pelā* ndej, hap (gjerm. e vj. e lartë *fẽld,* sll. e vj. *polje,* fushë, etj. sh. Walde E.W. 443, ^{2}554). *Përpāll* është "përhap, leçit", ndërsa *shpall* paraqet si të thuash një "nxjerr jasht e në shesh, shpërhap". Grafinë *shpall* me *ll* e *ka*, në kundërshtim me Meyer-in, Kristoforidhi, Fjalori 408; atë na e vërteton dhe trajta *përpāll* (shkruar *pèrpaaλ*) që e pamë te Bogdani.

s h p o r r, ç p o r r dëboj, largoj, heq qafe; *ç p o r r e m* largohem

Këto kuptime pas Kristoforidhit, Fjalori 409, kurse Meyer-i, E.W. 414 ka vetëm vështrimin "dëboj, përzë". Kjo fjalë, që ka mbetur pa shpjeguar te Meyer-i, do zbërthyer në *ç-porr, sh-porr; -porr,* nga një **pēr-n,* lidhet indirekt me got. *fairra* larg, larg prej, gjerm. e vj. e lartë *fẽrro* larg; ind. e vj. *pára-ḥ* më larg. Fonetikisht asaj më mirë nga të gjitha i përgjigjet lit. *pérnai* vjet, vitin e kaluar (e cila edhe kjo është e afërt me got. *fairra* etj.; rrënja është *per-;* Walde, E.W. 461, ^{2}575; Feist, 74 v.). Lituan *-ér-* me intonacion të shtyrë i përgjigjet shqipes *-or-* nga *-ér,* po ashtu sikundër lit. *-ár-* në *szárka* i përgjigjet shq. *-or* nga *-ār* në *sorrë* (Pedersen, K.Z. 36, 337). Nga fusha e shqipes hyn këtu natyrisht edhe *para, par* etj. (cf. Meyer, E.W. 321).

s h t i e, geg. *s h t ī, s h t î j* shtrij, hedh, vërvit, qëlloj, shtie pushkë, dështoj (pjellën)

Meyer-i këtë fjalë në E.W. 416 e përfshin në një artikull me *shtjell,* dhe këtë afrim e mbajti dhe në A. St. 3, 73 e 78. Sipas tij baza e përbashkët e këtyre ishte **stel-* (gr. *στέλλω*, sllav. e vj. *steljǫ,* gjerm. e vj. e lartë *stellan*). Ai pranon vërtet që *shtie,* ashtu si *bie* nga **bier* (*φέρω*), ka dalë direkt nga *shtier,* po kjo, sipas tij, rrjedhka nga një *stel-* me ndrim të *l*-së në *r.* Këtu edhe duke lënë mënjanë faktin që ajo rregulla që vendosi Meyer-i në lidhje me reflektimin e *l*-së indoeur. me një *r* në shqipet (A. St. 3, 78) nuk mund të qëndrojë (Pedersen, K. Z. 33, 551) në rasën tonë të posaçmen një indefikim të *shtie* me *shtjell* faktet nuk e justifikojnë. Sepse, siç del nga

Pekmezi, Gram. f. 275, ne këtu kemi të bëjmë me dy verbe krejt të ndryshme, të ndryshme si nga kuptimi si nga forma. *shtiell* do të thotë "shtëllis, shpalos", *shtie* ka ato kuptimet që dhamë më sipër. Pastaj *shtiell* në aorist bën *shtolla, shtie* në tosk. bën *shtira, shtiva, shtura* (Pedersen, Alb. Texte, 195), në geg. *shtiva, shtina.* Te Bogdani, Cuneus proph. I, 92, 23, 24 gjejmë: *shtiu ndë det* deiecit in mare, *shtiu ndata ujë* gettò in quelle acque. Atëherë vetvetiut na paraqitet një krahasim me lat. *sterno* shtrij përdhe, hap, shtrij, ind. e vj. *stṛ̥ṇ́ti* hap, rrëzoj, shq. *shtrinj* etj., grup ky që pajtohet fort mirë me të gjitha kuptimet që u dhanë më lart. *shtie* vjen nga një **ster-,* siç na mëson dhe Meyer-i vetë. Pra, derisa *shtrinj* nga pikëpamja morfologjike piqet me lat. *Sterno,* ind. e vj. *stṛ̥ṇ́ti, shtie(r)* afrohet morfologjikisht me sllav. e vj. *stьrǫ*, *strěti,* nga një **sterti,* rus. -*stértь.* Tani është puna të dimë sesi nga një bazë e tillë kanë dalë të tjerat forma që kemi. Trajta *shtiu* e vetes së tretë singular të aoristit (Bogdani, loc. cit., Pedersen-i, Alb. Texte 195), na çon te një *shti-,* meqë -*u* në vetën e tretë singular të aoristit nuk mund të jetë origjinale siç e shohim nga forma mediale; po kjo *shti-* me zhdukje të *r*-së, siç konstatohet dhe në tjera rasa, ka dalë nga një **shtir,* e cila prapë ka ardhur nga një *stṛ̥*- (Brugmann, Grundriss 1^2, 465). Pra, në shkallën e alternacionit vokalik (ablautit) *grisha* mund të krahasohet me trajtën *shpū* të Bogdanit që e përmëndmë më sipër. Aoristi që ekziston sot u sajua pastaj si një produkt kompromisesh të ndryshme; *ṛ̥*, respektivisht -*ir-,* mundi e u zhvillua vetëm në pozicion para sonatit, *r*-ja mundi e ra vetëm duke u gjendur në fund të fjalës. Duke u përgjithësuar një formë dhe duke influencuar format e ndryshme njera-tjetrën, nga forma *shti-* dolli pastaj me *v* zhdukëse të hiatit - *shtiva* (cf. Pedersen, Festskr. t. Thomsen 253 v.). Aoristi *shtura* u formua pas modelit të trajtave siç është p. sh. *vura.* Aoristi *shtira* i toskërishtes mund të jetë një formë origjinale po ka mundësi që u krijua rishtas, prej një participi *shti-rë* (që pranë tij ka geg. *shtīm).*[39] Në geg. prezenti është *shtī, shtî; shtī* na paraqitet me kontraksionin *ie >ī,* që ka geg. Në këtë mënyrë ky verb hyri nën ndikimin e verbave me *î,* dhe efekti i kësaj qe që u formua një aorist i ri *shtina,* te Bogdani përkundrazi gjejmë akoma aoristin e moçëm të vetës së tretë njëjës *shtiu.*

[39] Megjithatë, koniunktivi *shterë* (Pedersen, A. T. 195), *shtjerë* (Lirija, nr. 101, f. 1, 1) me *r*-në e tij e bën më të besueshme vërejtjen e parë. Pedersen-i, A. T. 196, do ta sqarojë ndryshe formën *shtirë*, që për shkak të ndikimit të *shtij* u bë *shtiu.*

s h t i p, s h t y p; p ë r t y p; p ë r t r y p; s h t r i p, z d r y p zbres

Kuptimet e të parit nga këto folje shtyp, ndrydh i kemi nga Kristoforidhi e nga Bashkimi. Te Kristoforidhi, Fjalori 414 kësaj fjale i përgjigjen nga gërqishtja e re *κοπανίζω, τσαλαπατῶ, καταπλακώνω* (pra, bluaj, thërmoj, shkel me këmbë, shtyp, kaplloj); Bashkimi 442 e përkthen me pestare, schiacciare (pra, thërmoj, shtyp). Me këto shpjegime pëson një lloj modifikimi përkthimi që jep Meyer-i për *shtip*: "thërmoj, grimcoj". Trajtën *përtryp*, të cilën Meyer-i, në E.W. 416 s'e ka, e përdor Kavalioti dhe këndej e merr e e shënon dhe Meyer-i në A. St. 4 (f. 83), vepër që u botua më vonë. Kavalioti e shkruan *παρτρούπ* dhe Meyer-i këtë e transkribon me *përtryp,* po nuk dëftohet i sigurt. Mirëpo, po të marrim e ta krahasojmë këtë fjalë me *përtyp*, që ka po atë kuptim dhe të kemi parasysh që në shqipet konstatojmë shpeshherë një zhdukje të *r*-së në një pozicion analog me këtë (sh. më lart të *shkep*), s'ka pikë dyshimi që te Kavalioti nën *α* ra subskripti¸ për një gabim shtypi (Kavalioti me *ᾳ* shënon *ë*-në e shqipes). Por forma *përtryp* nuk do lidhur me kuptimin që jep Meyer-i në E.W., l. c. të familjes së fjalëve (: lat. *stīpare*). Koekzistenca e *përtryp, përtyp, shtyp shtip,* na jep si verb rrënjë një *-tryp,* e cila na del e përngjitur me prepozicione të ndryshme. *-t(r)ip, tryp,* kuptimi bazë i së cilës, siç na e vërtetojnë përkthimet e Kristoforidhit e të Bashkimit që dhamë më sipër, është "shkel, shtyp, ndrydh", është e afër me gr. *τραπέω* shkel, shtyp, rrushin, anglos. *þrafian* me shtypë, me shty, me rrasë, me qortue, me ndëshkue, lit. *trepstu* shkapet këmbët, *trypiù* shkel e përsh me këmbë, shtyp, prus. *trapt* me shkelë, rus. *tropá* gjurmë, fërkem etj. Baza e fjalës së shqipes është **tr̥pō*, e cila dha rregullisht *trip.* y-ja do të ketë dalë nga shkaku i labialit që vinte pas, siç ngjan zakonisht. Për shkallën e alternancës vokalike (ablautit) khs. sidomos fjalën e gërqishtes si dhe lit. *trypiù.* Te *sh-ja* në *sh-t(r)yp, sh-t(r)ip* kemi të bëjmë më fort me prefiksin *sh-* të shqipes që e trajtuam më lart te *shk(r)ep,* sesa me lat. *ex.* Raporti semantik "përtyp" (*përtryp* te Kavalioti): shkel, shtyp (që e gjejmë te fjala *shtyp*) është njësoj me atë që shohim në rus. *mjatь* me shkelë, me ngjeshë (bukën), me përtypë.

Një kompozit i -*trip* është edhe *shtrip* zbres, një fjalë që na del që në më të vjetrin përkthim shqip të biblës (Mbretërit 3, 17, 23 botuar te Tomorri, nr. 12. f. 3), te Dom Gjon Buzuku i vitit 1555. Është e qartë se ky verb është një me *tryp shtryp,* geg. *zdryp,* sic. *zdrip* (Meyer, E.W. 439). Bugge në BB 18, 186 ato format që shënon Meyer-i u përpoq t'i nxirrte nga një lat. *derūpo* rrëzoj. Me këtë shpjegim mbetet pa shpjeguar tingulli fillestar i trajtës më të vjetër d.m.th. *shtrip,* e cila na dolli rishmë në dritë, gjithashtu nuk shpjegohen trajtat *stryp, zdryp, zdrip e tryp,*[40] sepse tek ato format e para duhej të admetonim një gurrë me trajtë të përngjitur, të themi një **disderupo,* fjalë që s'do të kish asnjë kuptim (ose shumë–shumë kuptimin e përkundërt, kurse me interpretimin që jep Bugge grupi *tr-* në ballë të fjalës vështirë të shpjegohet nga ana fonetike. Në të vërtetë, ne këtu kemi të bëjmë me një kompozit **dsh-trip,* dhe me këtë sqarohen të gjitha format. Për raportin semantik khs. gjerm. e sotme (në të vërtetë gjerm. e ulët) *Treppe* shkallë: *trappen* eci rëndë e *trampeln* përpjek këmbët (Kluge, E.W. [7]464, 462), cek. *vystuopiti* me zhdrypë: *stoupiti* me shkelë. Për formën e ballit të fjalës khs. *zbonj* pranë *dëbonj, tbonj, xbonj.*

s h t i r, s h t i j, s h t y r "kaloj një lumë, nxit, ngas, kall"

Meyer-i, E.W. 419 ka vetëm trajtën *shtyr.* Po kjo formë pas Kristoforidhit f. 413, 414 është vetëm e gegërishtes, edhe këtu, siç do ta shohim sakaq, nuk është e gegërishtes mbarë. Për toskërishten Kristoforidhi na dëshmon trajtat *shtir* (Berat) dhe *shtij* (Përmet). Meyer-i trajtën *shtyr* dhe kuptimet e kësaj i mori nga Hahn-i Alb. Studien 3, 127, po ai radhën e kuptimeve e ndroi. Te Hahn-i kuptimi "kaloj një lumë" ka vëndin e parë, kuptimet e tjera ndjekin me atë rradhë siç e dhamë më lart. Meyer-i ka "nxit, ngas, kaloj një lumë". Kristoforidhi në vëndin e cituar na jep vetëm domethënien "kaloj një lumë". Edhe Pedersen-i në Alb. Texte 195 te fjala *shtij* "shtyj", ka dhe një *shtij* "kaloj një lumë", fjalë që nga pikëpamja e formës është një me atë të parën. Kështu, pra, ky verbi që na jep Pedersen-i

[40] *t*-ja fillestare në *tryp* na dëfton që s'është i drejtë as mendimi i Jarnik-ut (cf. Pedersen; K.Z. 36, 287) që kjo fjalë rrjedhka nga rum. *rîpă,* shq. *ripë.*

koincidon me atë që dëshmon Kristoforidhi për Përmet. Pedersen-i me atë rast bën disa vërejtje rreth shkrirjes së fjalës *shtie* "hedh" me *shtij* (sh. më lart te *shtie*). Me këto të dhëna të Pedersen-it afrohet dhe Bashkimi f. 439, i cili *shtī* "kaloj" një lumë nuk e ndan aspak nga *shtī* "hedh, dështoj". Së fundi edhe Jungg-u, Fjaluur 136 (i cili ka dialektin e Shkodrës) ka vetëm *shtīr* "kaloj një lumë". Nga këto të gjitha mund të themi se del me siguri: 1. që kuptimi i parë, ashtu siç e ka dhe Hahn-i, është me të vërtetë "kaloj një lumë", kurse domethëniet e tjera janë sekundare; 2. që trajta *shtir* (shtij) është ajo më e përhapura, *shtyr* është trajtë thjesht dialektore. Zhdukja e *r*-së në *shtij* shpjegohet me atë mënyrën që shtjelluam më sipër për *shtie* dhe për aoristin e saj *shti(u). y*-ja në *shtyr* do të jetë shkaktuar nga *shtynj* (sh. edhe Pekmezin Gram. f. 55). Po t'i vështrojmë gjithë këto fakte së bashku, na del edhe lidhja etimologjike e kësaj fjale. *shtir* duhet zbërthyer në *sh-tir,* ku *sh-* është prepozicion (= indoeur. *shm-, sm̥-*) që kemi parë shpesh herë; *-tir* afrohet me ind. e vj. *tiráti* "depërton", *tárati* "kalon matanë, kalon kapërcen", *tiráḥ* "nëpër, përtej", lat. *trans,* got. *þairh* (Thumb, K.Z. 36, 198 v; Walde, E.W. 623, ^{2}774). Te fjalët e indishtes së vjetër *-ir-* duhet kuptuar si refleks i një *ḷ̥ʳ*-je (Brugmannn, Grundriss 12, 460). Po kështu qëndron puna me gradën e infleksionit që ka verbi i shqipes (khs. Brugmann, Grundriss 1, ^{2}465). Përdorimi i *sh*-së do të jetë analog me përdorimin e sllav. *sъ* nga **sm̥-,* qoftë që shërben për perfektivin (sh. më lart te *shpie*), qoftë që shënon pikënisjen në kuptim të hapësirës. Kuptimi tjetër që jep Hahn-i: "nxit, ngas" është sekundar, dhe kjo nuk duhet të na çuditë te një verb i lëvizjes, siç është ky (khs. lat. *incitare, citare* "vë në lëvizje"; gr. *κίω* "shkoj"). Njëkohësisht, shtysën mund ta ketë dhënë verbi *shtynj* dhe ndikimi që ushtroi ky në pikëpamje fonetike.

s h t o r a s ë "shtuara, në këmbë"

Meyer-i këtë fjalë në E.W. e shënon pas Kavaliotit, po pa shtuar ndonjë shënim, kurse në Alb. Studien 3, 91 thotë se është e errët. Sido që të jetë, kjo fjalë i përket rrënjës **stā-* "rri, qëndroj". Burimi nga e mori ai fjalën është toskërishtja, prandaj *r*-në lejohemi ta nxjerrim nga një *n* intervokalike. Kështu arrijmë te një bazë **stā-n,* në të cilën *n*-ja do të ketë dalë nga një participi më *-n* (khs. *Shtuarë* "në këmbë", Pedersen,

Alb. Texte 196, *shtuara* "in piede", Rada, Raps. f. 50). Sa për sufiksin do krahasuar geg. *rishtasi* "përsëri, rishmë, tash së fundi" (Kristoforidhi 351) pranë geg. *rishtas, rishtazi, rishtazë.* Kështu, pra, *s*-ja, siç del dhe nga format që në trup të fjalës kanë një *z*, është me vënd vetëm në fund të fjalës, dhe që këtej u përhap dhe më tej. geg. *rishtasi* me *i*-në fundore të saj-në qëndron ndaj *shtorasë* ashtu si geg. *qi* ndaj tosk *që.* Kështu dalim te një trajtë **shtorazë;* kjo nga ana e sufiksit afrohet me gr. -*δον*, -*δην*, -*δα: ἀποσταδόν* "që rri më larg", *σταδην* "që rri në këmbë", *μεταδρομάδην* që ndjek, i gjirmon mbrapa, *μίγδα* përzier etj. (Brugmannn, Grundriss 2/1[2], 471), në krahasim me të cilat fjala e shqipes paraqet një zgjerim me -*i̯o*-. Kështu, pra, baza do të jetë një **stā-n-odi̯o, * stā-n-adi̯o.*

s h t r u n g ë "pjesa e vathit ku mjelin dhitë"[41]

Për shtektimin e kësaj fjale te sllavët e te grekët, të cilët e muarnë drejtpërdrejt nga gjuha e barinjve vlleh, khs. Meyer-in në E.W. 418. Gurra e kësaj fjale pas Meyer-it është e errët. Mendimin që pat Miklosich-i me Schuchardt-in që kjo rrjedhka nga shq. *shtrëngonj*, e cila edhe kjo ka dalë nga lat. *stringo,* Meyer-i loc. cit. nuk e pranon. Mirëpo, ka mundësi patjetër që fjala të jetë afër me lat. *stringo,* nga **strengo* "nduk fort, shtrëngoj, bëj nyjë", gr. *στραγγός* "i dredhur", *στραγγεύω* "dredh", *στρογγύλος* "rrumbullak" (për këtë bark fjalësh khs. Walde E.W. 601, [2]745). Baza është **strn̥g-* me një zhvillim të *n̥*-së siç e gjejmë në *grundë, mund* (sh. më lart) dhe *tund* (sh. më poshtë). Zhvillimi i kuptimit është si në lat. *crātis* "thurime, vath", gr. *κυρτία*, gjerm. *Hürde* "vath i dhënët": sllav. e vj. *krę(t)nǫti* "me dredhë"[42].

---

[41] *Për shq.* shtrungë *dhe farefisin e saj khs. tani Vasmer, Roczn. slaw. 2, 27, i cili thotë: "unë mendoj që rum.* strungă *ka dalë nga sllav. e vj. *strǫga "shtrungë"... Po kjo mund të ketë dalë nga gr.* στράγγα *të shtrydhur, një deverbativ i* στράγγίζω *"shtrydhë, mjel". Në një pozicion të sandhit që ka qenë i favorshëm për ndrrimin e kuptimit ky ndrim kuptimi mund t'u ketë kryer në greqishten vetë. Veçse për ta dokumentaur s'e dokumentoj dot". Mirëpo, siç thekson dhe Vasmer-i vetë me sa ka një gr. të re* στράγγα *me kuptimin "shtrungë", aq është e dokumentaur një sllav. e vj. *strǫga.*

[42] Me mendimin e Weigand-it (Jahresber. des Inst. f. rum. Spr. 16, 228, 229) që fjala ishte me origjinë sllave e se ekzistonte një bullg. e vj. *strǫga* nuk mund të pajtohem. Miklosich e ka bërë të besueshme se fjala në sll. është e huaj, Wander. d. Rum. f. 8, 19, 24 (Denkschr. d. Wien. Ak. phil. hirt. Kl., vol. 30; pos ukr. *strunka* khs. edhe sllovak. *strunga*) dhe sll. Elem in Magyar 2f. 115 v) (= Nr.792). Një formë e lashtë bullg. *strǫga* nuk është shënuar.

shurr "përmjer" shurrë

Meyer-i në E.W. 420 substantivin e bashkon me gjerm. e vj. të lartë *sūr* "i hartë", sllav. e vj. *syrъ* "djathë", po në Alb. Studien 3, 45 – për arsye fonetike – heq dorë nga kjo etimologji, duke e quajtur të pasigurt. Pedersen-i KZ 36, 281 na vërteton se ajo nuk pajtohet me rregullën që vihet re në gjuhën shqipe që në fjalë thjesht shqip *sh* përpara një vokali të mbrapmë (velar) nuk ka. Pedersen-i mendon për një origjinë latine, dhe pikërisht nga **ex-urinari,* po vetë ai bën këtë vërejtje që kjo do kish dhënë vetëm një verb **shurronj,* po jo *shurr* (të cilën na e dëshmon Jungg-u, Fjaluur 138). Po s'ka dyshim që Pedersen-i ka të drejtë, kur vështirësitë që paraqet *sh*-ja përpara *u*-së kërkon t'i mënjanojë me këtë supozim që këtu kemi të bëjmë me një kompozit më *sh-.* Për një mendim të tillë kemi një paralele të mirë në gr. e re *κάτουρον* "shurrë" (: gr. e vj. *οὖρον* idem, *οὐρέω* "përmjerr". *sh*-ja mund të jetë lat. *ex,* po pak së paku po aq të ngjarë ka që kjo të jetë identike me atë *sh* = indoeur. *sm̥-,* për të cilën kemi folë shpeshherë. Në këtë rasë do të kishim të bënim me një element që shënon pikënisjen e një lëvizjeje, po ashtu siç është *sъ*-ja në gjuhët sllave (sllav. e vj. *sъ nebese* nga qielli, çek. *spadati* "me ra përposh". Në këtë mënyrë do të kishim një konkordancë semantike të plotë me gr. e re *κάτουρον. -urr* nga një **ur-n,* hyn në grupin lat. *ūrīna,* nord. e vj. *ūr* "shi i hollë", lit. *júrės* "det", gr. *οὐρέω* "përmjerr" etj. (khs. Walde, E.W. 601, ^{2}860; Fick 3, ^{4}32), fjalë këto, me të cilat ajo qëndron në raportin e infleksionit. Te *shurr* nga *s-ur-n,* kemi përpara nesh një formacion verbal, i cili i përgjigjet atij të verbit *marr.* Femërorja *shurrë* qëndron ndaj *shurr* si *lidhë* "lidhkë, shirit" ndaj *lith,* si *qartë* "grindje, zënkë" ndaj *qërtonj.* Kemi, pra, një formacion postverbal (deverbativ).

tartallis "përpëlitem"

Këtë fjalë, që mungon nëpër fjalorë, e ka Pedersen-i, Alb. Texte f.74. Ka të bëjë me ind. e vj. *tar-alá-ḥ* "që lëkundet, që dridhet". Për formën e fjalës së indishtes khs. Persson, Wurzelerweiter. f. 51; Brugmann, Grundriss 2/1^{2}, 356 v, f 1, 502. *tartallis* është një formë me reduplikacion dhe na paraqet një **tar-tar-ís,* ku *r*-ja e dytë u disimilua. Mënyra e formimit të këtij verbi i përgjigjet asaj të *γαργαίρω* "guloj, bujis" (*γάρ-γαρα*, ind. e vj. *Gal-*

galīti ‘me pikue, me gjerbë”, sllav. e vj. *glagoljǫ* “flas” nga një **golgoljǫ* etj.; khs. Brugmann, Kruze vgl. Gram. 482 v.). Të tjera fjalë të afërta me këtë i gjen te Persson, loc. cit. e te Walde, E.W. 635, [2]789. Verbi i shqipes dhe verbi i indishtes së vjetër që sollmë për krahasim piqen posaçërisht në këtë pikën që këtyre u mungon determinativi konsonantik i pjesëtarëvet të tjerë të kësaj familje fjalësh.

geg. *ç â s h t j e*, *ç a s h t j e*, *ç â s h t ë*, tosk. *ç ë s h t j e*.

Formën *çâshtje* të gegërishtes na e dëshmon për Elbasan Tomorri, nr. 4, f. 1 sht. 2, f. 2 sht. 4, kurse në broshurën Fe-rɛfejɛs a mɛsime myslimane pɛrmbledun prej J. H. M., Elbasan 1909, në kapak si edhe në f. 1 dhe në pasqyrën e fjalëvet në fund fjala është shkruar *çashtje* (tšaštje). Bashkimi f. 72 ka formën *çâshtë* (tšąšte). Trajtën *çështjë* e gjejmë në revistën Lirija nr. 74, J. 2, në një korrespondencë prej Gjirokastre. Po këtë trajtë e ka dhe vepra e kompiluar *Valët e detit* e Spiro Risto Dines, Sofia 1908, f. 851 (pa shënuar proveniencën, po sigurisht prej toskërie). Koekzistenca e geg. *â* dhe e tosk. *ë* na shpie më në fund te një vokal nazal. Kjo fjalë ka dalë nga një afrim, një rrasje e fjalisë geg. *ç’âsht,* tosk. *ç’është?* Këndej dolli *çâsht, çështë,* së cilës iu ngjit pastaj sufiksi *-ëlë* që formon nomina actionis. Forma *çâshtë* (Bashk.) duhet gjykuar ashtu si *mbledhë* pranë *mbëjedhijë* (Meyer, E.W. 265), *mbëldhëlë* (Pedersen, Alb. Texte 157).

ç e m “hetoj, zbuloj”, *ç e m e t ë* “del në shesh”

Vetëm këtë formën e fundit ka Meyer-i në E.W. 446, dhe e ka pa ndonjë shpjegim. Trajtën aktive e gjejmë te Kristoforidhi, Fjalori 446, dhe te Bashkimi 73. Mendojmë se fjala duhet marrë si *ç-ap-nj̣o,* ku *ç-*ja është ai prefiksi që dimë (: lat. *dis*) kurse elementi radikal hyn te lat. **apio* “lidh, pështjell”, *cōpula* “lidhë”. Si kuptim bazë na del, pra, “zgjidh”.

t u n d

Pas Meyer-it, E.W. 452, me të cilin bashkohet dhe Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss 1^2 1056, kjo fjalë ka dalë nga lat. *tundo*. Po Pedersen-i në Roman. Jahresber. 9, I 211 shfaq dyshime ndaj një mendimi të tillë, meqë ata të pakë shëmbuj që sillen për të vërtetuar kalimin e verbeve latine në koniugacionin pa *-n-* në shqipet janë krejt të dyshimtë. Objeksioni i Pedersen-it në këtë rast është aq më shumë me vend, ngaqë mund ta zgjidhim çështjen mirëfilli pa admetuar ndonjë huazim nga lat.: ky verb i shqipes puthitet në punë të kuptimit krejtësisht me ind. e vj. *tąsáyati* "tund, shkund", e cila së bashku me lit. *tąsýti* "nduk andej e këtej", got. *at-þinsan* "me tërhekë për këtej" etj., paraqet një zgjerim më *s*-të rrënjës *ten-*. Tek e njëjta rrënjë hyn dhe shq. *tund,* veçse këtu kemi një prezent më *-d(h)-* (ose zgjerim). Baza është **tn̥d-*, me atë trajtim të *n̥*-së përpara konsonantit që pamë më lart edhe te *grundë, mund, shtrungë*. *mund* afrohet me *tund* edhe nga ana morfologjike; edhe lat. *tendo* mund ta krahasojmë morfologjikisht me këtë fjalë.

u i k t h "bashkë (lesh)"

Këtë fjalë, që e ka Kavalioti, Meyer-i (E.W. 457 dhe Alb. Studien 4, 09) e merr për një deminutiv të fjalës *ujk, ulk*, veçse një interpretim i tillë nga ana semantike nuk ta mbush mënden. Po një afëri rrënje më e largët është e mundur, siç do ta shohim. Në pikëpamje formale shpjegimi i Meyer-it, i cili këtë fjalë e konsideron një deminutiv, është me vënd. Me këtë rrugë arrijmë tek *uik-*, e kjo nga një *ulk-*. Kjo afrohet vetvetiu me familjen e fjalëvet lat. *vellus* "bashkë (lesh)", *vellere* "me ndukë" (Walde, E.W. 654; 2813 v.), fjalë këto ndaj së cilave fjala jonë qëndron në raportin e infleksionit. Në pikëpamje morfologjike kjo është një formacion me sufiks *-k* si ato fjalët që pamë më lart: *byk, penk,* pastaj si sllav. e vj. *znakъ* "shënjë": *znati,* gjerm. e vj. e lartë *luog* "shpellë, shtrofkë", lat. *lateo* etj. (Brugmann, Grundriss 2/12 477).[43] Në qoftë se shq. *ujk*, *ulk* me lat. *lupus*, gr. *λύκος* etj. ka dalë

[43] uikth. *Endzelin-i K.Z. 44, 61 mendon që shq.* ulk *të ketë ardhur nga sllav. *vъlkъ; pas mendimit të tij shqipja neksin* vu-*, nga sa duket, e ka vetëm në disa huazime më të reja. Mirëpo sesi trajtohet* v-*ja ante vokalike në ballë të fjalës në huazimet e vjetra marrë prej sllavishtes, këtë na e tregon fjala* thëngjill, fëngjill*, që u trajtua këtu.*

nga një *u̯l̥-qu̯-* („bishë që të çan, të shqyen"), zgjerim i rrënjës *u̯el-* (ku hyn edhe lat. *vellere*, sh. Walde, E.W. 355 2448), mund të pranohet prapë një lidhje më e largët midis *ujkth* "bashkë (lesh)" dhe *ujk.*

u r ë (e lumit)

Kjo fjalë, që gjer më sot ka mbetur e pashpjeguar, ka të bëjë me *udhë* ("udhëtim"), pra, me grupin e lat. *veho*, dhe rrjedh pikësëpari nga një **udh-rā*, **ud-rā*. Raporti kuptimor që ekziston midis *urë* dhe *udhë* "rrugë, udhëtim" është po ai që kanë lat. *pons* "urë, vig" dhe sllav. e vj. *pǫtь* "udhë", ind. e vj. *pánthā-ḥ* "rrugë dhish, udhë rrugë" në mes të tyre. khs. edhe kuptimet e avest. *pərətuš* "kalim, va, urë". Emrat e urës kanë dalë nga emrat e vaut, sepse të kaluarit e lumenjve me ura është një gjë më e vonë, se më përpara i binin më va (Schrader, Real-Lex. 114)44. Sufiksi *-rā* është identik me sufiksin që konstatuam më lart te fjala *dor-bë-r-í*; khs. gr. *ἕδ-ρα* "seli" (: *ἕζομαι*), sll. e vj. kisht. *pirъ* "convivium" (: *piti*), gjerm. e vj. e lartë *būr* "ba-nesë" (: *būan)* etj. (Brugmann, Grundriss: 2/1, 2354 v.). Pra, ura na del kështu si "kalim, va", shq. *-dhr-*, *-dr-* dha një *r*, ashtu si në *dirsë*, *djersë*, nga një **svidrot* -: gr. *ἴδρως* (Pedersen K.Z. 36, 288; khs. dhe Pedersen K.Z. 40, 212). Po ashtu edhe *-tr-* ka dhënë *-r-*: plur. *të tjerë*: *tjetër* (Pekmezi, Gram. 149, mendimi i të cilit që plurali u formuaka ndryshe, me këtë rast *do* modifikuar). Te *të tjerë,* pra, artikulli është ngjitur përpara dy herë (*tjetër* pranë *jatër).*

i u r t ë "i mënçëm, me mënd, modest; guximtar, trim"

Shpjegimin që jep Meyer-i: e afërt me *unj* "përul", *unjem* "ulem", *ul* idem (E.W. 458) e refuzoi me të drejtë Pedersen-i K.Z. 33, 551, meqë një ndrim fonetik *l:r* që presupozohet këtu nuk vërtetohet gjetiu dhe meqë kuptimi bazë i fjalës është "i mënçëm, me mënd" e jo "i përulur, i përvutë", siç kujtonte Meyer-i. Dhe me të vërtetë, mendimi i Pedersen-it vërtetohet me kuptimin "guximtar, trim" që do ta dëshmojmë menjëherë. Në qoftë se domethënia e parë është "i mënçëm, me mënd", kjo fjalë, duke dalë nga një **urëtë*, lidhet me got. *war* "i matur, që di e ruhet", saks. e vj. *war*, gjer. e vj. e

[44] Sh. dhe ato që thotë Meringer-i, Wörter und Sachen I. 187, 192 v.

lartë *War*, *giwar* "i matur", gr. *ἐπὶ ὄρονται* "ata ruajnë, mbikëqyrin", *ὁράω* "shoh", lat. *vereor* "shikoj me drojtje, e druaj me nderim" (Feist, E.W. *309*. Walde, E.W. 659, 2820), dhe na paraqet një zhvillim kuptimi që e shohim dhe në lat. *prūdens* "i urtë", nga **pro-u̯idens* ("që e sheh që përpara"), gjerm. e vj. e lartë *spāhi* "i urtë"; gjerm. e vj. e lartë *spḗhōn* "me ruejtë, me vëzhgue", lat. *specio* (Brugmann I.F. 16, 500). Te Marchiano, Canti popolari alban. delle colonie d'Italia (Foggia 108) f. 74, 30 gjejmë frazën: *trimθi, si i ùrti c'isc* (trimthi, si i urti ç'ish), që Machianoi e përkthen: il giovine, baldo come era (shënim për 30: *ùrti* "virtuoso, prudente ma qui potrebbe interpetarsi (!) valoroso, come il latino virtus"). Dhe me të vërtetë, një kuptim i tillë (d.m.th "trim, guximtar") vërtetohet që te Bogdani, në Cuneus prophetarum I. 28, 44 për djaloshin që ka lerë në shenjë të Venusit thuhet: *deſceron … me ù baam i urtè* desidera attendere alla virtù. Nga një kuptim i parë "i matur, që di e ruhet" u zhvilluan dy kuptimet që duket sikur t'ishin gati të pakundërta: më një anë "me mend, kokëulët" (khs. frëngj. *sage*, siç e përkthen dhe Dozon-i, Vocab. f. 6, fjalën e shqipes), më anën tjetër "guximtar, trim". Sa për zhvillimin e këtij kuptimit të fundit khs. gjerm. e vj. të lartë *kuoni* "guximtar, qejfli lufte" gjerm. e re *kühn* "guximtar" përkundrejt nord. së vj. *kœnn* "i urtë, i vuar" (që të dyja i përkasin rrënjës gjermanike *kan - kun*, gjerm. e re *können* "me mujtë, me ditë", Kluge, E.W.[7], 270). Siç po na del, pra, qartë nga fjala e gjermanishtes së sotme, fjala i *urtë* arrin në domethënien "trim, guximtar" nëpërmes një elipse; pikënisja është "i urtë, i matur në luftë".

v a t h ë "vëndi i rrethuar për bagëti, thurimë, oborri i shtëpisë"

Meyer E.W. 463 tosk. *vëth* "vathi i veshit" = geg. *vâth* e ve një me *vathin* e bagëtisë; në këtë ai ndjek Hahn-in Alb. St. Fash. III f. 5, veçse ky shënon vetëm trajtën gege. Mirëpo nga fjalorët e rinj të gegërishtes, nga Jungg-u me Bashkimin, del që kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme. Vathi i veshit gegërisht (në geg. e veriut) është mashkullore *vâth*, sh. Jungg 169, Bashkimi 485; si mashkullore na e jep dhe Meyer-i. Përkundrazi, rrethaku i bagëtisë, thurima etj. në Veri është femërore, *vathë,* pra, ndryshon nga ajo e para si nga vokalizmi si nga gjinia gramatikore. Prandaj s'ka sesi që *vatha* e bagëtisë të afrohet me fjalën *vank* "pjesa e rrotës",

siç mendon Meyer-i në vëndin e cituar. Kjo duhet refuzuar për shkak se *vatha* në gegërishtet nuk ka nazal *vathë* "vëndi i rrethuar për bagëti, thurimë, oborri i shtëpisë" rrjedh nga një **vor-tā* dhe lidhet me ags. *worþ* m. n. oborr, gjerm. e mesme e ulët *wort, wurt* f. muri, sll. kisht.-rus. *vora* "saepimentum", fjalë këto që në kuptim puqen plotësisht me fjalën e shqipes, e më tej me sllav. e vj. *въrǫ, vrěti* "mbryll", rus. *zavórъ"* lit. *ùžveriu* "mbyll, mëshel", ind. e vj. *api-vṛṇōti* "mbyll, ndryn, mulon", lat. *aperio* etj. (khs. Walde E.W. 36 v., 250, Fick 2, 4 395); *-t-*ja në bazën që u admetua më sipër, pas *r*-së, u bë *th*, dhe pastaj *r*-ja përpara spirantit ra; khs. *këthenj* nga lat. *convertere* (Meyer E.W. 185), pastaj *buzë, gjizë* (sh. më lart). Në punë të sufiksit *vathë* nga *v*or-tā* konkordon me *botë*, *latë*, *ndjetë* (sh. më lart). Në gjuhën shqipe kjo familje fjalësh që u trajtua këtu përfaqësohet edhe me fjalën *varr*, geg. *vorr* (për geg. *o* khs. Pekmezi, Gram. 55); edhe Meyer-i në Alb. Studien V 104, duke tërhequr mendimin e tij të parin (me fjalën *birë*, E.W. 37) e lidhi te rrënja *ver-* "mbështjell, mëshel, mbroj". Baza është **vor-n* "e mbyllura nga të gjitha anët e mbrojtura". Khs. rus. *choronítь* "me vorrue", përkundrejt sllav. së vj. *chraniti* "me mbrojtë, me i dalë zot".

v ë r r i "hulli, brazdë"

Meyer-i E.W. 37 këtë fjalë e shkruan *vërŕ* (sipas Hahn-it), dhe kjo grafi e shtyn atë ta afrojë me *vrë* e me *birë*. Edhe po të lemë mënjanë dyshimet që shpreh Meyer-i vetë rreth pikës që fjalët që nisin me *v* e me *b* të jenë të afërta në mes të tyre, grafia që ai përdor për këtë fjalë, siç po del tani, nuk është e saktë: Kristoforidhi (Fjalori 22) e shkruan *vërrŕ (vɛr̄ŕ)* dhe si kuptim jep "hulli (e vogël)". Kjo fjalë lidhet me lat. *versus* "hulli, vijë, vizë rruvje, radhë, varg" (: me *verro)*, nord. e vj. *vǫrr* "të rrahurit e lugatave". Megjithatë nuk kemi këtu një konkordancë të plotë nga pikëpamja fonetike, sepse *rr*-ja e shqipes nuk del nga një *rs*. Duhet nisur përkundrazi nga kjo që lat. *verro* do zbërthyer në **ver-so* khs. gr. *ἀπό-ϝερ-σε* "mori me vete, rrëmbeu" (Meyer, Gr. Gram. 3164; Persson, Wurzelerw. 129). Pra baza e fjalës së shqipes mund të jetë **ver-n-ija*, d.m.th. një formë e rrënjës pa zgjerim me *s-* dhe pikërisht në një trajtë participale që paraqet sufiksin *-n*.[45]

[45] Tosk. *verë*, çam., shkodr. *virë* (Kristoforidhi, fjalori 22), ashtu si *vathë*, *përkund-*

v i g j e peshqesh në të ngrëna që shpien në një dasmë, në një llindje, kur ndërtohet një shtëpi e re

Meyer-i këtë fjalë në E.W. 472 e shënon sipas Mitkos dhe e lë pa shpjeguar. Meqë kjo fjalë, nga sa di unë gjer më sot, nuk është dëshmuar për çamërishten dhe shqipen e Greqisë, për natyrën e *gj*-së nuk japim dot një gjykim të sigurt; prandaj shpjegimin që po japim këtu e japim me rezervë. Në qoftë se *gj*-ja ka dalë nga një *gl*, këtë fjalë mund ta afrojmë me gr. *ἕδνον* "peshqesh që i jep dhëndri nuses", gjerm. e vj. e lartë *widamo* dhuratë e të fejuarit për nusen, gjerm. e lartë e ver. *Wittum*, angls. *weotuma* "mergjur", sllav. e vj. *věno* "pajë" (khs. Vondrák, Vgl. slaw. Gram. I 414; Walde E.W. 2818; Boisacq, Diction. étym. 215). Si bazë e fjalës e shqipes na rezulton në radhë të parë *ved-l-*, *dl*-ja u bë *gl* e pastaj *gj*, si te fjala *gjatë* nga *dlang-të*; gr. *δόλιχος* "pistë e gjatë, hipordom i gjatë", *δολιχός* "i gjatë", ind. e vj. *dīrghá-ḥ* i gjatë", sllav. e vj. kisht. *dlъgъ* njësoj, etj. (Pedersen, K.Z. 33, 545; Bugge, BB. 18, 167; Meyer, Alb. Studien IV 81, për lat.*longus* khs. van Wijk, I.F. 23, 375; Walde E.W.2 440). Sufiksi *-l* si në *ζεύγλη* "rrypi a kapistra e zgjedhës", *ἑλλά* "ndejë, seli" sllav. e vj. *osla* "grijë" (; gr. *ἀκόνη*) etj. (Brugmann, Grundriss II/12 362 vv.). *e*-ja e bazës që supozuam këtu përpara konsonantit në origjinë të dyfishtë u bë *i.*

v i k, *v i g u* kalim që përbëhet nga një tra, shkalë, shtiqë a parmëndë

Këto kuptime po i japim pas Kristoforidhit 30, Bashkimit 493, Jungg-ut 172; nga këta Bashkimi jep jep të gjitha kuptimet që u thanë, Kristoforidhi vetëm të parin, Jungg-u vetëm të dytin. Duhet shënuar që Dokë Sula në përkthimin e Piros së Plutark-ut, kap. 17 (Tomorri, Nr. 12, F.3) *vik* e përdor drejtpërdrejt për gr. *φορεῖον*. Meyer-i E.W.

---

razi, do të hyjnë në grupin indoeuropian *ver-* (slll. e vj. kisht. *vьrǫ*, *vrěti* „mbyll", lit. *užveriu* „mbyll, mëshel" etj., me një zhvillim të kuptimit siç e gjejmë edhe në gjerm. e vj. të lartë *loh*, gen. *Lohhes* „dry, bravë", angls. *loc*: got. *-lūkan*, gjerm. e vj. e lartë *lūhhan*, anglos. *lūcan* „me mbyllë". Për punën e kuptimit krahaso sidomos (cf. Johansson, I.F. 25, 216) lit. *veriù*, *vérti* „me çelë ose me mbyllë", refl. *vẽrias* „me u çelë", fjalë e afërt me fjalën e shqipes. *i*-ja në *virë* do gjykuar ashtu si në fjalën *vit* (përbri: *vjet*: lat. *vetus*). *vërë ë*-në e silabës së parë e mori nga *vërima* që është sinonime edhe etimologjikisht e afërt.

472 për këtë fjalë thotë: "*vik* m. "kalim". Nga lat. *vīcus* "lagje, rrugë". *vik* "tabut i të vdekurvet" Bla(nchus), Ro(ssi) për mua s'është i qartë". Të dhënat e mësipërme tregojnë që shpjegimi që jep Meyer-i nuk mund të qendrojë. Sepse këtu s'kemi të bëjmë me kuptimin "udhë", po me një urë nevoje a kalim gatitur me një tra. Përveç kësaj kjo fjalë mbaron me *g* jo me *k;* kjo *k* u përftua vetëm në fund të fjalës; le pastaj që po ta nxjerrim fjalën nga latinishtja, kuptimet e tjera mbeten të paqarta. Po të kemi parasysh raportin semantik në frëngj. *Branche* "degë, dyrek" si dhe të *brancard* "vig, shkalë, mashkull, bigë e qerres", pl. "dyrekë", na del që për këtë fjalë të shqipes duhet nisur nga një kuptim i parë "degë, gem". Dega ku vihet përmbi një rrjedhë uji të vogël, shërben si vig kalimi dhe mund të përdoret edhe si shkalc dhe si mashkull (frëngj. *brancard*). Atëherë kjo fjalë na del afër me ind. e vj. *vayā́* "degë, gemi", irland. *fē* "thupër", sllav. e vj. *vetvь* "degë, gem". Shpjegimi më i tejmë i këtij grup fjalësh nuk bëhet dot me siguri (Khs. Walde E.W.2 841; autorin, Arch. f. slav. Phil. 29, 441). Sa për sufiksin khs. shq. *plok, plogu* "grumbull, tok" (sh. më lart); po ka mundësi që të kemi të bëjmë në themel me një sufiks *gh*, dhe në këtë rasë duhet krahasuar fjala shq. *degë*, gjerm. e vj. e lartë *zwīg*, gjerm. e sotme *Zweig* "degë" (Brugmann, Grundriss 2/12 513; Meyer, Alb. Studien III 9).

v o r b ë "kuth, kuç i baltë"

Këtë fjalë, që na del që te Bogdani (p.sh. Cun. Proph. I. 27, 37, 92, 24), Meyer-i e ka, po shpjegim nuk jep. Ajo lidhet me sllav. e vj. *vьrěti* "me zie, me vlue", *variti* "me zie, me vlue", *varъ* "vapë, zhegë", lit. *vìrti* "me zie" etj. Sa për kuptimin khs. çek. *hrnec,* pol. *garniec* "kuth, vorbë, poç" ind. e vj. *ghr̥ṇá-ḥ* "vapë, valë e nxehtë", lat. *fornax* (Walde E.W. 238, 2309; Berneker E.W. 271). Sufiksi është ai që gjejmë në lit. *garba* "ndër": *giriù* "lëvdoj, mburr", *dárbas* "punë": *darýti* "me ba" (Brugmann, Grundriss 2/12 389), shq. *shkelp*, *shkelbi* (sh. më lart). Meqë kjo fjalë është e gegërishtes, nuk mund të thuhet me siguri nëse *o*-ja reflekton një vokal që në fillim të ketë qënë i gjatë apo nëse ajo u përftua ashtu si dhe në *votër* për tosk. *vatrë*; *vorr* = tosk. *varr*; pra, me një labializim përmes *v*-së që është specifik për gegërishten (khs. Pekmezi, Gram. 55).

v r ë n d ë "një shi i hollë"

Afrohet me sllav. e vj. *ūr* "një shi i hollë", *ȳra* "me ra shi i hollë", avest *vār* "shi", lat. *ūrīna* "shurrë" (shih Walde, E.W. 691, [2]860), shq. *shurrë* etj. Me formën që ka, kjo fjalë e shqipes është mbeturina e një participi indoeuropian me -*ent* -, -*ont*-, ashtu si fjala *rëndë* që u trajtua më sipër. Edhe për *ë*-në fundore vlejnë po ato që u thanë për *rëndë*. Grafia *vrenne* (Bashkimi 500) na paraqet fonetikën e gegërishtes veriperëndimore.

z â n ë, muzë, perëndeshë

Nga fjalorët këtë fjalë e ka vetëm Bashkimi 511, ku jepet dhe përkthimi që vumë në krye. Kuptimin e fjalës e sqarojnë më mirë këto dëshmi që janë nxjerrë prej tekstesh: te Lahuta e malcís *I* f. 12 (autori i këtyre këngëve të botuara si anonime është Atë Gjergj Fishta) thuhet:

Prênnoj dielli, n'qiell duel hâna
N'Véleçik po pingron Xâna.[46]

Në librin me vjersha "Pika voëset" të Fishtës, f. 37, strofa 1, vargu 3:

Ka t'kërmojmë, oj Zâna e malit?

Po aty strofa 5:

Djergu, Zânë, praa m'çeste *t'ême*
Edhè kângës m' i' a ênn ti fillet.

Zâna, pra, është me të vërtetë një hyjneshë e kumbimit, e këngës. Asaj i veshin dhe forcë e trimëri: *Burrë i fort'e trim si Xâna* (Lahuta e Maltsiis I, f. 5). Për arsye të cilësisë kryesore të saj si hyjneshë e kumbimit dhe e këngës emri i saj do afruar me geg. *zâ*, tosk. *zë* "zëri" (: sllav. e vj. *zvonъ* 'kumbim", sll. kisht. *zvъněti* "me kumbue, me tingëllue", Meyer E.W. 483).47 Si "zâ,

[46] *x* në ortografinë e Bashkimit = *z.*

[47] Në krye mendova se rrjedh nga lat. *Diana,* po këtë etimologji e lashë, për arsye fonetike (khs.*djall*, nga lat.*diabolus* [Pedersen-i, Roman. Jahresber. IX I 216, e pak më ndryshe Thumb-i I.F. 26, 12] dhe për punë të kuptimit. Po z. Hofrat Meyer-Lübke më tërhoqi

zë' e shpjegon këtë fjalë edhe Hahn-i, Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar f. 69 (Denkschriften der Wiener Ak., Phil-hist. Kl. 16), i cili na jep kumt për nuset e malit të quajtura *Zana* dhe i quan këto si orë a perri shqiptare. Duhet shënuar që Hahn-i flet për shumë *Zana*, kurse ato vise tekstesh që cituam ne më lart si dhe informuesit e mi shqiptarë (p.sh. Zef Harapi e Rrok Prennushi prej Shkodre) dinë të flasim për *Zanën* (në singular).

Tosk. *z g j e d h e*, geg. *z g j e d h e, z g e d h e*

Këto trajta i shënon Pekmezi në Gramatikën e tij f. 283; Kristoforidhi në Fjalor f. 369 ka *sgjedhë*; Bashkimi 397 ka *sgjedhë* dhe *sgiedhe* (=*sgiedhe* f. 518, trajtë që puqet krejt me *zgjedhë*- të Pekmezit, meqë Bashkimi *je*-në e shkruan *ie*); Jungg-u në fjalorin e tij f. 150 e shkruan *zgjedh*, *zgiell* (grafi, për të cilën vlen po ajo që u tha për Bashkimin). Sadoqë kjo fjalë, nga sa di unë, për çamërishten dhe për shqipen e Greqisë gjer më sot nuk na është dëshmuar,[48] edhe vetë nga ky material dialektor që u paraqit këtu mund të jepet të paktën një gjykim probabël rreth formës primitive të konsonantit fillestar të saj. Koekzistenca e trajtavet *zgjedhe* e *zgedhe* të gegërishtes, nga të cilat ajo e para, sipas dëshmisë që na japin fjalorët shkodranë të Bashkimit e të Jungg-ut, është e Shkodrës, dhe e trajtës *zgjedhe* të toskërishtes shpjegohet kështu që të admetojmë një *gl* origjinale. Sepse në të folmet e gegërishtes në grupet *kl*, *gl j*-ja bie, ose më mirë të themi, bie palatalizimi i guturalit: Pekmezi gramatika 64; prandaj kemi *zgedhe*. Kështu si formë bazë kemi **zgledhe*. Meqë -*gl*- ja mund të rrjedhë nga një -*dl*-, ne arrijmë në *zdledhe* = *zd-ledhe*. Pra kjo fjalë hyn në grupin shq. *lith*, *lidhe*, *lidhë* "lidhcë, hekura", lat.

---

vëmendjen përmbi faktin që reflektimi i tingullit inicial nuk e qit këtë çështje, meqë *diabolus* si një term kristian që është i përket një shtrese më të pastajme, dhe shton se *Diana* ekziston në një trevë të madhe të gjuhëvet romane dhe sidomos në gjuhën rumune (*zînă* arum. *dzînă*; Puşcariu, E.W. d. rum. Spr. f. 181, Nr. 1942), dhe se kuptimi disi më i largët që ka fjala në gjuhën shqipe shpjegohet po të pranojmë një kryqëzim të etimologjisë popullore me geg. *zâ*, tosk. *zë*.

[48] Forma *zevlë* e shqiptarëve të Greqisë ka dalë nga gr. e re *ζεῦλα* për *ζεῦγλα* dhe që Meyer-i E.W. 484 e lidhi me *zgjedhë* etj., siç do ta shohim më poshtë, për arsye fonetike nuk mund të bashkohet me *zgjedhë.*

ligo "lidh", ku me tjetër gutural hyn dhe lit. *laigonas* "vëllai i gruas" (Wiedemann, Bezz. Beitr. XXVII 212; Brugmann II 21, 319; Walde E.V. 338 v., [2]429). Me këtë fjalën e fundit *zgjedhe* përkon në vokalizëm, ngaqë *e*-ja len nga një *ai.* Për tingujt inicialë khs. *zgjith* që vjen nga një *zd-lith*, *dz-lith* Meyer E.W. 245. Në disa dialekte (Berat, Gjinokastër) thonë edhe *zgjedhë*, *xjedhë*, sh. për këtë gjë Pekmezin, gramatika f. 67 (ndrim i s*q*-së, *zgj*-së në *sj*, *oj*, *zj*, *xj*). Po që në këtë grup edhe *gj*-ja që ka dalë nga një *gl* po ashtu trajtohet, këtë na e tregon forma zgjith = *sgjith* (:*lidh)* që ka Kristoforidhi në Fjalor f. 121 e mjerisht pa dhënë ubikacionin, një trajtë e cila, pra, në punë të tingujvet inicialë përkon me tosk. dialektore *zjedhë* = *zgjedhe*. Tani del pyetja se si duhet shpjeguar -*zd*-ja; domethënia e fjalës nuk na lejon ta vëmë në një vijë me prefiksin e rëndomtë të shqipes *zd-, dz-*, *dsh-*: lat. *dis*. Më e drejtë është që në *zd*-në e kësaj fjale të kërkojmë korespondentin e lat. *bis*, lat. e vj. *duis*, gr. *δίς*, ind. e vj. *dvíḥ*, gjerm. e mesme e lartë *zwis* "dy herë", ku *dṷ*-ja iniciale u reflektua me *d*, ashtu si në fjalën *degë,* që hyri edhe kjo etimologjikisht në këtë grup, dhe në fjalën *dorbërī́,* që u trajtua më lart. Kështu, pra, pas kësaj analize del se fjala ka kuptimin "çift, pendë, bigë", që pajtohet fort mirë me kuptimin që dimë. Meyer-i E.W. 484 do ta nxjerrë këtë fjalë nga gr. e re *ζεῦλα* për *ζεῦγλα,* duke e përshkuar nëpër shkallët **zegla*, *zgjella*, *zgjedha*. Mirëpo ky shpjegim nuk ka marrë parasysh faktet dialektore. Sepse shkëmbimi i *ll*-së me *dh* është punë dialektesh p.sh. në Shkodër, (Pekmezi, Gram. f. 61) dhe në Gjirokastër (Erveheja e M. Çamit, botuar prej J. Vretos, [2] f. XV dhe shënim). Përkundrazi te fjala jonë, siç na tregojnë dëshmitë e mësipërme, *dh*-ja në trup të fjalës është e shqipes mbarë (gegërisht e toskërisht), kurse forma *zgiell,* që ka Jungg-u, është vetëm e Shkodrës. Pas Meyer-it duhej të niseshim nga një trajtë e përbashkët **zgjella*, e cila të kish dhënë më tej *zgjedha* në gjithë shqipen. Kaq sa për bazën **zgjella*, *zgjedha*. Po edhe paraforma më e vjetër **zegla*, **zgjella,* që supozon Meyer-i, është gabim, meqë grupi *gl* trajtohet fare ndryshe, të tjerë shëmbuj për një metatezë të tillë mungojnë dhe së fundi edhe tingujt *l* në *zgjella* dhe në **zegla* dallohen në kualitetin e tyre.

z ī, fem. *z e z ë* "i zi, i mjerë, i keq", *z ī* f. "jaz, zi bukë", *z e z ë* f. "bojë e zezë"

Meyer-i EW 484 në adjektivin fem. *zezë* do të kërkojë një deminutiv. Mendimin e tij e ndjek p.sh. dhe Densusianu, Baust. z. rom. Philologie 472. Po, duke lënë mënjanë faktin që një adjektiv femëror i sajuar në këtë mënyrë del krejt jashtë nga skema e zakonshme e adjektivavet femërore në gjuhën shqipe, kundër një kuptimi të tillë të kësaj forme, kuptim që do të kishte pasoja të rënda për etimologjinë dhe për fonetikën, flasin këto dy fakte: 1. kemi dhe një abstraktim *zezë* "hije e zezë", dhe këtu, s'ka sesi të kemi përpara nesh një deminutiv, 2. plurali i mashkullores bën *të zes* dhe *zezë*, i femërores *të zeza* (Pekmezi, Gram. 106). Pra z-ja e dytë është e rrënjës së fjalës dhe ka dalë evidentisht nga një -*dį̑*-, ndërsa trajtat *zī* (adjekt. mashk.) dhe *zī* (subst. fem.), që duken sikur largohen shumë, shpjegohen duke admetuar zhdukjen e rregullt të *d*-së në pozicion intervokalik. Po me këtë bie atëherë edhe interpretimi etimologjik që jep Meyer-i (Alb. Studien IV 83), po me rezervë: lit. *žìilas* "i përhimë", let. *fîls* "i kaltërt". Mendimi që sapo shfaqmë përreth karakterit të *z*-së së dytë gjen vërtetimin e tij në etimologjinë e këtij grupi fjalësh të shqipes; ky afrohet me lit. *gedù* "mbaj zi" (khs. *zī* "jaz"), *gẽda* "turp, dhunë" (khs. shq. *t'u nxiftë faqeja*, që Kristoforidhi, Fjalori 288 e përkthen me *αἰσχύνη εἰς σέ*), prus. e vj. *gīdan* "turp, mbarrë", rus. *gádkij* "i ndjetë, i shëmtuar, i ndyrë", *gážu*, *gádtь* "ndyj, fëlliq, prish, shkatërroj", gjerm. e mesme e lartë *quāt kōt*, gjerm. e sotme *kat*, *kot* "ndyrësi, lerë", gjerm. e mesme adjektivi *quāt*, holand. *kwaad* "i keq, i shëmtuar, i zvetnuem", angl. e mesme *cwēd* "i keq, i lig" (për këtë grup fjalësh khs. Zubatý, Arch. f. slav. Phil. 16, 422; Brugmann IF 5, 375 v.; Wiedemann, Bezz. Beitr. XXX 212). Kuptimin që kanë adjektivet e gjuhëvet gjarmanike që sapo cituam, d.m.th "i keq, i lig", e gjejmë dhe në zinë e shqipes. Kështu e përdor Meyer-i në Alb. Studien VI 12, Proverbi 93. Afërimë e koncepteve "i zi – i ndyrë" (khs. gjerm. e mesme *quāt*, *kōt* etj.) na e dërfton mirë gjerm. e vj. e lartë *salo* "i ndyrë i zi", ind. e vj. *maliná-ḥ* "i ndyrë, me njolla, me ngjyrë të mbyllët si të veshur, i përhimë, i përhimë i mbyllët, i zi" (Böhtlingk, Sankskrit-Wörterbuch in kürzerer Fass. 5, 38): *mála-m* "ndyrësi, lerë",

pastaj gjerm. *schwarz*, got. *swarts*, që nga sa duket afrohen me let. *sordes* "ndyrësi" (Feist E.W. 257; Kluge E.W. ^{7}419; Fick 3,^{4} 550; Walde E.W. 585, ^{2}726). Me ind. e vj. *maliná-ḥ*, *mála-m* më të shumtët e etimologëvet (Khs. p.sh. Hirt, Ablaut 90; Schrader, Reallexikon 744; Brugmann IF 9, 367; Solmsen KZ 38, 443; Prellwitz, E.W.^{2} 287; Walde E.W. 398, ^{2}500) bashkojnë dhe gr. *μέλας* "i zi", let. *melns* "i zi", dyshime shfaq van Wijk IF 20, 344 shënim. Sido qoftë puna e këtyne fjalëvet, ndrimi semantik që u presupozua këtu për shq. *zī* mjaftojnë shëmbujt e mësipërm për ta vërtetuar. Për rrënjë bazë të grupit të mësipërm (rus. *gádkij*, gjerm. e mesme e lartë *quāt* etj.) Berneker E.W. 289 mendon një **g(u̯)ōdh-*, **g(ōu̯)ēdh-*.[49] Me këtë na vërtetohet dhe një herë rregulla e Pedersen-it për reflektimin e labiavelarevet, respektivisht të velarevet me një *u̯* të mëpasme përpara një vokali të qartë në gjuhën shqipe (KZ 36, 30 j. vv.). Tani le të kthehemi te shpjegimi morfologjik. Ne kemi këtu dy çifte formash që fonetikisht puqen, po nga ana funksionale ndryshojnë: *zezë* (femërorja e adjektivit) "e zezë", *zezë* (substantivi femëror) "boja e zezë, e zeza", *të zezë* (norminativi mashk. i adjektivit), "të zez"; *zī* (substantivi fem.) "zi, jaz, zi buke." 1. *zezë*, femërorja e adjektivit dhe substantivi femëror nga **gu̯edhi̯ā* (adjektivet më *i̯o* kanë edhe në të tjera fjalë abstrakte adjektivore pranë tyre), *të zezë* nominativi pl. mashk., afërsisht nga një **gu̯edhi̯oi* (khs. *njerëzitë* pl. i shquar nga një **neridi̯oi*, Pedersen, Roman. Jahresber. 9, [1905], I, 209). 2. fem. abstrakte *zī* nga * *gu̯edhíjā, *gu̯edhíi̯a.* Kjo dha së pari – cf. *thëní* nga **k̂ēnīdā* (Meyer, Alb. Studien III 13), **zëí* dhe nga kjo me kontraksion *zī.*. Kontrakcione krejt analoge vrejmë edhe në huazimet latine të shqipes, si p.sh në fjalën *pyll,* nga **padūlem* për *palūdem* (Meyer EW. 360); forma e ndërmjeme midis bazës dhe trajtës së sotme të shqipes duket qartë që është **pëyll*; khs. edhe *lirë*, nga lat. *līber*, që kaloi nëpër trajtën **liër*, pastaj, nga fjalët vetiake të shqipes, *keq* nga *këeq*, formë që e gjejmë te Kavalioti. Ashtu si *zī* (subtrantivi fem.) shpjegohet edhe *zī,* "i zi" (adjektivi mashk.), pra nga **gu̯edhíjo-*, **gu̯edhíi̯o-* me një theksim siç e ka dhe

[49] *Në kundërshtim me bazën *g(u)ōodh-, *g(u)ēdh-* të Berneker-it, *v. Osten-Sacken K.Z. 44, f. 56 vendos një tingull inicial *g^{u}, pra, gadën e infleksionit *g^{u}ē(u̯)dh-, *g^{u}ō(u)dh-. Po për punë të shqipes kjo natyrisht nuk ndryshon gjë.*

ind. e vj. *kšatríyaḥ* "zotnues", *ajríya-ḥ* "i egër", *usríya-ḥ* "i kuqremë.50 Nga gjithë këto që thamë këtu na dalin këto përfundime. Në fem. abstrakte shohim koekzistencën e **-íi̯ā* dhe **-i̯ā* (*zī*, *zezë)*, e cila i përgjigjet raportit gr. μανία "tërbim", *πενία* "varfëri", lit. *gìrìa* "pije" ind. e vj. *vidyā́* "dije" (sh. Brugmann, Grundriss II/12 184 v., I 2 264). Të njëjtën koekzistencë të *-i̯o-* dhe *-i̯o-* e ndeshim dhe në skemën e nocionit të adjektivit duk meqënë që krahas me mashk. *zī* nga **gu̯edhíi̯o-* kemi fem. *zezë* nga **gu̯edhíi̯ā*. Ky është një raport që të kujton disa rrethana të fleksionit të lituanishtes, ku temat më **i̯o*, me përjashtim të nominativit singular të mashkullores e të femërores dhe të akuzativit singular të mashkullores e të femërores, kalojnë analogjikisht në temat me *jo*: mashk. *dìdis*, fem. *dìdė*, akuz. mashk. *dìdį*, fem. *dìdę*, po gjenitivi singular mashk. *dìdžo*, fem. *didžõs* (Wiedemann, Hand. D. Lit. Spr. 84). Ndryshimi është ky që në gjuhën shqipe forma me *jo* u përhap më shumë. Ekzistenca e një abstrakti adjektivor *zī* pranë një adjektivi mashkullor *zī*, që në gjuhët romane nuk ka analogji, dhe pranë një abstrakti femëror *zezë*, na vërteton që te *-íjā* kemi të bëjmë me një sufiks vëndas (kështu mendon dhe Pedersen-i, Roman. Jahresber. 9, I, 208); këtij erdhi e iu shtua pastaj sufiksi roman *-ía*. Mashk. *zí* do gjykuar ashtu si fjalët *njëri (nɛrí)*51, *kallí* (khs. ind. e vj. *nárya-, nárya-* "burrnor", në kundërshtim me këtë, shqipja na shpie te një theksim **neríi̯o*). Gjithashtu edhe abstrakti femëror *zī* ka analogjitë e veta në punë të formës ndër disa nga fjalët që u trajtuan më sipër: *avarí́* "bashkë" ("bashkim, radhitje"), një formacion si p.sh. lit. *su-mania* "consilium", gr. *μανία* "tërbim", *dorbërí́* "tufë, kopé" (derivat me *-i̯o-* nga një substantiv, të cilin e gjejmë të gjallë në lit. *buris* "tok, tufë", let. *būra* "tokë, shumicë"). Po *-i-*ja nga një *-i̯ā* erdhi e iu ngjit më vonë edhe sufikseve së tjera. Këtë e shohim qartë në forma si këto: *njerëz-í́* pranë pl. *njerëz*, e shquar *njerëzitë* (sh. më lart), geg. *vllazní́* pranë pl. *vllazën*. Siç iu shtua këtu *–í-*ja nga një **-i̯ā* sufiksit *-idi̯-*, respektivisht një konglutinati të sufiksit *di̯* dhe të sufiksit *n-* kështu *í-*ja iu ngjit edhe sufiksit *-eti̯-* në fjalët *parësí́*, *malësí́.* Sufiksi *-ës-* në *parësí́* i përgjigjet sufiksit në lit. *pirmatis* "principatus": *pírmas* "i parë", *pilnatis* "plotni", mashk. (temë më *-i̯o*) "hënë e plotë": *pílnas* "i plotë, plot", *aklatis* "të qënët i verbër": *ãklas* "i verbër", *vënatis* "njësi" *vẽnas* "një", sll. kisht.

[50] Për vjetërsinë e theksimit të ind. së vj. Shih Hirt, I.F. 16, 78.
[51] Kështu shkruan Pekmezi, gram. 264; Meyer E.W. 313 e ka *njeri.*

lichotъ, ἀνωμαλία inaequalitas": *lichъ περιττός* "redundans", *lǫkotъ* "çengel": *lokъ* "i kthyer", i shtrembët" (Brugmann, Grundriss II/12 438). Konglutinata që i përngjajnë shiqpes -*ës-í* janë lat. *servitium*, *pueritia* serbokr. *čistòća*, *gluhòća* (Brugmann, 1oc. cit. 194). Një sufiks i afërm me atë është ai që gjejmë te fjala *dosë.* Si sufiks sekundar e gjejmë -*í*-në edhe në *lapër-dh-í* (sufiksi *d* i së cilës i afrohet sufiksit të fjalës *njerëz)*, *madhështí,* nga **maĝis-t-*, siç na del nga krahasimi me *madhështuer* (Bogdani, Cun. prophetarum I, 7, 4) me *madhësht-í, limon-t-í* (sh. më lart), *maz-í*, te kjo fjala e fundit, siç duket ka kuptim kolektiv.

Sufiksi -*z i*, -*z ë*, -*z i t*

Këtë sufiks e ndeshim p.sh. në tosk. *prapazë*, *prapazi, prapazit* ("nga prapa" (Kristoforidhi, Fjalori 340), geg. *prapaz* (Bashkimi 361) "*prapa; përparazi* "nga përpara" (Kristoforidhi 318), tosk. *poshtazi, poshtazë* "nga poshtë" (Pekmezi, Gramatika 269; Kristoforidhi, Fjalori 335). Këtu kemi të bëjmë me refleksin shqiptar të formantëve indoeuropianë më -*dh-*, khs. *πόθι* "ku", *αὐτόθι* "këtu", ind. e vj. *ádhi* "më, mbi" (Brugmann, Kl. vgl. Gram. 454). -*zë, -zi* shpjegohet duke admetuar një zgjerim të tillë të -*dhi-* siç e gjejmë në gr. *ἐνταυθοῖ*, lat. ubĭ, *ubei* (Brugmann IF 15, 80 shën. E); pra, pak a shumë nga një *-*dh̥i* a -*dh̥iei,* pas lokativit. -*zit* është një konglutinat i formantit që trajtuam këtu me indoeur. -*tos*: ind. e vj.: *i-táḥh* "që këtej", lat. *intus*, gr. *ἐντός*, lokr. *ἐχθός*, at. *ἐκτός*.

II. HUAZIME

a f ë r

